

E gjetëm zgjidhjen... *... është Qeveria e Nxënësve! 2*



*Libër pune për mësuesit koordinatorë
të Qeverisë së Nxënësve*



Save the Children
Programi për Shqipërinë



Save the Children

Programi për Shqipërinë

E gjetëm zgjidhjen... ... është Qeveria e Nxënësve!

2

Libër pune për mësuesit koordinatorë
të Qeverisë së Nxënësve

Qershor, 2005

**Botim i organizatës “Save the Children”, Programi për Shqipërinë
Përgatitur në kuadrin e Programit të Edukimit**

Grupi i punës:

Majlinda Keta, Drejtoreshë e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë

Brikena Zogaj, “Save the Children”, Programi për Shqipërinë

Blerina Kashari, “Save the Children”, Programi për Shqipërinë

Rodika Goci, “Save the Children”, Programi për Shqipërinë

Grupi i punës u drejtua nga:

Blerina Kashari, “Save the Children”, Programi për Shqipërinë

Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi

HYRJE

Përse ky libër?!

Ky libër është konceptuar si një ndihmës në procesin e “prodhimit të qeveritarëve”, bazuar në filozofinë se fëmijët mund ta mësojnë demokracinë duke e ushtruar atë. Qeverisja e tyre nuk mund të jetë një ishull i dëshirës feminare, angazhimit individual të edukatorëve apo mikut mbështetës për të lehtësuar procesin. Shkolla është një organizëm i gjallë që merr jetë nga demokracia e ndërtuar në çdo moment e nga çdo kontribues, administrator shtetëror, mësues, kontribues komunitar apo mik nga Shoqëria Civile. Të gjithë duhet ta kuptojmë se ky “ishull” mund të mos konceptohet si i tillë nëse jeta e brendshme në shkollë çënon të drejtat e fëmijëve, apo kur rezultatet e shkollimit nuk i bazon te demokracia përmes mësimdhënies aktive për të gjithë në klasë.

Detyrimi për realizimin dhe funksionimin rezultativ të kësaj qeverisje është ligjor, brenda kontekstit ndërkombëtar dhe kombëtar të normave e ligjeve për të drejtat e njeriut, fëmijëve, misionet e edukimit apo dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet e aktorëve në një edukim kombëtar e global njëkohësisht. Përmbi të gjitha, kjo qeverisje është tregues i demokracisë në shkollë e cila në vetvete është oksigjeni i nevojshëm për mushkëritë e një kombi. Ky tregues është dhe duhet të jetë i njëjtë për të gjithë sistemet arsimore që përgatisin qytetarin me shtetësi të përcaktuar, por global në mendim e veprim njëkohësisht. Kjo qeverisje na lejon që detyrime madhore të shteteve nga deklaratat ndërkombëtare të ratifikuara prej tyre, t’i zbresim tek qeverisja e mirë e institucionit më të rëndësishëm të formimit të qytetarit – SHKOLLA. Ajo na lejon që detyrimin ta kthejmë në një proces ku përfshihemi të gjithë me role nga rezultati i së cilës përfitojmë të gjithë, për sot dhe nesër.

Ky libër është për të gjithë ata drejtorë e mësues që dëshirojnë të punojnë me nxënësit e klasave të tyre për të edukuar të fëmijët ndjenjën e pjesëmarrjes, duke krijuar kështu shkolla me qendër nxënësin. Ai është menduar në formën e një pakete në ndihmë të mësuesit koordinator të qeverisë së nxënësve, dhe shumica e kapitujve janë konsideruar si seanca trainimi për mësuesit dhe nxënësit, të përbërë nga tre pjesë: planifikimi i seancës, material për prezantim nëpërmjet një projektori si dhe materiale shpërndarës me informacion të detajuar e të plotë. Në përmbajtje të tyre mësuesit do të gjejnë modele pune për një funksionim të mirë të qeverisë së nxënësve, të cilat jo domosdoshmërisht mund të përputhen me situatën në çdo shkollë 9 vjeçare. Mësuesit janë të inkurajuar të përdorin nga ky libër atë pjesë të informacionit që ata e konsiderojnë të përshtatshme me situatën në shkollën e tyre.

Sikurse shprehet edhe në kapitujt e këtij libri, mbështetja e plotë e stafit të shkollës konsiderohet mjaft thelbësore, prandaj dhe ngritja e funksionimi i qeverisë së nxënësve duhet të jetë një iniciativë

e gjithë shkollës. Drejtorja e shkollës duhet të zgjedhë një mësues koordinator, i cili do të luajë rolin kryesor në mbështetjen dhe promovimin e qeverisë së nxënësve. Përvoja ka treguar se ky rol ka funksionuar mjaft mirë kur si mësues koordinator është zgjedhur mësuesi përgjegjës për aktivitetet jashtëshkollore apo një mësues me normë jo të plotë mësimore. Të rëndësishme në zgjedhjen e tij janë marrëdhëniet dhe komunikimi i mirë që ky mësues ka me nxënësit, prandaj në procesin e zgjedhjes së mësuesit koordinator, nxënësit duhet të shprehin mendimin e tyre.

Mësuesit duhet të kuptojnë, se ndonëse mbështetja e mësuesve kujdestarë është mjaft domethënëse në suksesin e qeverisë së nxënësve, roli i tyre nuk kërkon shpenzim të madh në kohë. Përveç mësuesit koordinator, mësuesve të tjerë nuk do t'u duhet të kushtojnë kohë individuale ekstra për qeverinë e nxënësve, përveçse orëve të kujdestarisë.

Shpesh në shkolla të cilat nuk kanë patur përvojë pune me qeverinë e nxënësve, mësuesit mund të ndihen të rrezikuar se ndoshta autoriteti i tyre mund të lëkundet. Por në fakt, kur qeveria e nxënësve është ngritur dhe funksionon ashtu siç duhet, nuk kalon shumë kohë dhe janë vetë mësuesit ata që shohin përfitimet. Në një shkollë ku nxënësit janë vetë të përfshirë në zgjidhjen e problemeve e konflikteve, mësuesit kanë vënë re se ajo pak kohë që u kanë kushtuar qeverisë së nxënësve, ka dhënë rezultate në përmirësimin cilësor të mësimdhënies, duke krijuar kështu një mjedis shkollor të qetë e të këndshëm, si për mësuesit ashtu dhe për nxënësit. Ne shpresojmë dhe besojmë se duke kontribuar që sot në formimin qytetar të nxënësve, mundësojmë një edukim të mirë të fëmijëve bazuar në të drejtat që atyre u takojnë.

Grupi i punës.

I Baza institucionale dhe ligjore

Situata shkollore që kërkojnë zgjidhje bazuar në detyrimin ligjor:

- Ngritja dhe funksionimi i Qeverisë së Nxënësve është dëshirë apo detyrim institucional për administratorët në shkollë?
- Qeveria e Nxënësve emërohet nga administratorët apo zgjidhet nga nxënësit votues?
- “Ligji” detyron përmbajtjen, kompetencat dhe procedurat e zgjedhjes. Si ta lexojmë atë?

Baza ligjore që mbështet Demokracinë, Të Drejtat e Fëmijëve në shkollë, ligjshmërinë e Qeverisë së Nxënësve në institucionin shkollos:

Konteksti Ndërkombëtar. Të drejtat e Njeriut, detyrimet ndërkombëtare për realizimin e tyre në shoqëri.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e aprovuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1948 njih dhe shpreh rolin e zgjedhjeve të ndershme dhe transparente si realizim praktik i të drejtës themelore të njeriut, pjesmarrjes dhe përfaqësimit demokratik në qeverisje.

Roli i zgjedhjeve periodike, të ndershme shprehet edhe në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të tij, Kartën e të Drejtave Themelore të Europës së Bashkuar, si dhe në Dokumentin e Kopenhagenit të Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin Europian (OSBE - 1990). Bazuar në këto dokumente, të drejtat e fëmijëve shprehen dhe sigurohen me anë të detyrimit që kanë shtetet që kanë ratifikuar Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 1989.

Konteksti Kombëtar dhe institucioni shkollos

Kushtetuta e Shqipërisë (Tetor 1998),

Ligji për Arsimin Parauniversitar, nr 7952, datë 21.06.1995 së bashku me ndryshimet e bëra në Ligjin nr 8381, datë 30.07.1998

Dispozitat Normative të MASH (2002) shprehin detyrimin e çdo institucioni shtetëror për realizimin dhe mbrojtjen e :

- Të Drejtave Themelore të Njeriut (Deklarata Universale, neni 21: Kushtetuta e Shqipërisë, neni 15)
- Të Drejtave Themelore të Fëmijëve (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, LAPU, Dispozitat Normative të MASH, 2002)
- Të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet qeverisëse të shtetit. (Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve, neni 12: Dispozitat Normative të MASH, 2002, neni 37, neni 52)

Në se do të qartësonim edhe një herë faktet se:

- Shkolla është institucion shtetëror që ka për mision “formimin e qytetarit...” dhe si i tillë nxënësit - qytetar duhet t’i sigurohen të drejtat e tij dhe ushtrimi i tyre në institucion,
- Në qeverisjen e institucionit qytetari ka detyrën e përgjegjësinë për të zgjedhur qeveritarët apo për t’u zgjedhur si qeveritar. Në këtë mënyrë do të kuptonim rëndësinë që kanë vota, zgjedhjet dhe Qeveria e Nxënësve për mirëqeverisjen e shkollës.

Si ta lexojmë Ligjin apo Dispozitën?

Në demokraci, është dhe duhet të jetë bindje për të gjithë, se shkolla është një institucion i hapur që siguron për qytetarët shërbimin “arsim”. Edukimi i fëmijëve dhe nëpërmjet tyre edhe i komunitetit përreth saj, kërkon ndërtimin e një sistemi që në përmbajtje dhe në process realizimi të edukojë, në njohuri e shprehë të ushtruar:

- të drejtat themelore të fëmijëve dhe njeriut
- procese zgjedhore që i shërbejnë cilësisë së qeverisjes së shkollës.

Kështu tashmë NE duhet të bashkëqeverisim shkollat tona me:

- administratorët (drejtuesit shtetërorë - drejtor, nëndrejtor)
- bordin e Shkollës
- qeverinë e Nxënësve.

Ndërsa për të parët vendosin procedurat shtetërore, për 2 të fundit, Bordi dhe Qeveria e Nxënësve, nevojitet siguri i kushteve nga administratorët për:

- njohjen e të drejtave të fëmijëve dhe komunitetit për mirëqeverisjen në institucionin shkollor
- ushtrimin e të drejtës për t’u zgjedhur dhe për të zgjedhur nëpërmjet votës dhe një procesi zgjedhor të ndershmë e transparent përfaqësuesit e tyre në këto **struktura e institucione** që **na detyron ligji shkollor**.

Ja si shprehet Neni 37(1) i Dispozitave Normativave të MASH, 2002 për **përmbajtjen** e konceptit “Qeveri e Nxënësve”:

*“Qeveria e Nxënësve” është një **strukturë organizative e pavarur** e nxënësve në shkollë. Ajo përfaqëson mendimin e masës së nxënësve për çështjet e shkollës, mësimi dhe edukimit. Nëpërmjet saj sigurohet pjesmarrja aktive e tyre në proceset e ndryshme demokratike në shkollë e komunitet”.*

Ndërsa për Bordin e Shkollës Neni 52(1) shprehet:

*“Bordi i Shkollës **është institucion** që përfaqëson interesat e komunitetit ku vepron shkolla dhe funksionon si organ vendmarrës, që kontribuon në mënyrë konstruktive në drejtimin demokratik të problemeve administrative e financiare të shkollës dhe të menaxhimit të saj.
Pjesë e këtij Bordi janë edhe Presidenti dhe Kryetari i Qeverisë së Nxënësve”.*

Pra, fëmijët apo të rinjtë, në jetën e tyre shkollore **kanë të drejtë të kenë strukturën** (Qeverinë e Nxënësve) por dhe të **bëjnë pjesë në institucionin** (Bordi i Shkollës) e qeverisjes së shkollës së tyre.

Si ta lexojmë Nenin 37 për ta zbatuar!

1. Qeveria e Nxënësve del nga procesi zgjedhor – pika 4.
2. Në zgjedhje duhet të marrin pjesë gjithë nxënësit e shkollës – pika 2.
3. Parimet e zgjedhjes përcaktohen në Rregulloren për Qeverinë e Nxënësve dhe kjo e fundit nuk duhet të bjerë ndesh me Ligjin Arsimin Para Universitar, Dispozitat normative dhe Rregulloren e Brendshme të shkollës. – pika 5
4. Kompetencat e Qeverisë së Nxënësve përcaktohen në pikën 6 të Nenit 37.
5. Procedurat e grumbullimit të fondeve – pika 7, 8.
6. Mësuesi/ja kordinatore dhe përgjegjësitë e të drejtat e saj – pika 9
7. Cilësimi i titullarëve të organeve qeverisëse - pika 11
8. Raportet me strukturën e Bordit – pika 11.
9. Ambjenti zyrtar – pika 10
10. Raportet e përfaqësishë së Qeverisë së Nxënësve me mbledhjet e Këshillit të Mësuesve - pika 12

Rekomandime për ndryshime në politikat arsimore qendrore e lokale

- Rishikimi i Dispozitave Normative të MASH (2002) me konsultimin e fëmijëve për të përcaktuar më qartë detyrimin e shkollës ndaj krijimit dhe funksionimit të Qeverisë së Nxënësve.
- Përfshirja në Udhëzimin e fillimvitit të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të rubrikës “Demokracia në shkollë” dhe në mënyrë të veçantë standarti i procesit zgjedhor e qeverisë në shkollë
- Pasqyrimi në Matricat e Veprimit Qendror e Lokal, të çdo institucioni të Qeverisë së Nxënësve dhe procesit zgjedhor në shkollë.
- Përfshirja në Standartin e Inspektimit të MASH, nivel lokal apo të shkollës të vlerësimit të cilësisë së angazhimit të drejtuesve, kordinatorit, mësuesve të shkollës në Procesin Zgjedhor apo qeverisjen nga nxënësit në shkollë.

Si duhet t'i lexojmë termat:

Ligj- normë a rregull që miratohet nga organi më i lartë i pushtetit ligjvënës dhe që është i detyrueshëm për të gjitha organet shtetërore e shtetasit.


Dispozitë- ... secila prej pikave të një ligji, urdhërese, vendimi etj

Institucion- organizëm shtetëror a shoqëror i dukurive; ndërtim i brendshëm që e zhvillon veprimtarinë e vet në një fushë të caktuar.

II Mesazh për mësuesit që drejtojnë qeverinë e nxënësve:

Të shprehësh mendimin dhe të të dëgjohet mendimi është një e drejtë që i takon të gjithë fëmijëve të botës, pra edhe të Shqipërisë. Nuk ka rëndësi nëse këta fëmijë janë nga një fshat minoritar i Jugut, apo nga ish - blloku i Tiranës. Nuk ka rëndësi nëse këta fëmijë janë me origjinë të huaj, apo jetojnë në malësitë e Veriut e nuk ka rëndësi nëse këta fëmijë janë më të mirët e klasës, apo ata që e kanë braktisur shkollën. Të gjithë fëmijët shqiptarë kanë të drejtën e shprehjes së lirë të mendimit. Bashkë me këtë të drejtë shkon dhe e drejta për të thënë lirshëm mendimin teksa merren vendime në shkollë. **Nëse kjo e drejtë nuk ushtrohet sot në shkollat tona, do të thotë që të rriturit në shkollë “nuk e lëshojnë” pushtetin e vendimmarrjes. Të rriturit në këtë rast po kontribuojnë pa dashje në shkeljen e të drejtave të nxënësve në shkollë.**

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve përcakton qartë të drejtën e fëmijëve për pjesëmarrje. Katër parimet që e përshkojnë këtë konventë janë:



Parimi i mbijetesës dhe i zhvillimit adreson të gjitha të drejtat e fëmijëve që kanë të bëjnë me mbijetesën dhe zhvillimin, si psh: e drejta për të jetuar, për të patur një emër, për të patur kujdesin e të dy prindërve, për të patur kujdes shëndetësor dhe mbrojtje, për t'u argëtuar, për t'u arsimuar.

Parimi i interesit më të lartë të fëmijës synon që të orientojë të gjitha veprimet përkundrejt interesit më të lartë të fëmijës. Kështu në ato çështje ku ndeshen interesa të grupeve të ndryshme merr prioritet interesi më i lartë i fëmijës.

Parimi i mosdiskriminimit orienton për të zbatuar të drejtat e të gjithë fëmijëve, pavarësisht aftësive të tyre individuale, prejardhjeve sociale dhe ekonomike, racës, ngjyrës, besimit apo moshës.

Parimi i pjesëmarrjes ka të bëjë me të drejtën e fëmijëve për t'u shprehur lirshëm individualisht dhe në grup, për t'u dëgjuar nga vendimmarrësit, për të qenë pjesë e vendimmarrjes në jetën e shkollës.

● **A marrin pjesë aktivisht nxënësit e shkollës suaj në jetën shkollore?**

Sigurisht që nxënësit e shkollës marrin pjesë në aktivitete të ndryshme të shkollës. Po në ç'shallë marrin pjesë ata? Janë thjesht një dekoracion në aktivitete të ideuara nga mësuesit, apo ata vetë organizojnë aktivitete gjithëpërfshirëse? Më poshtë është paraqitur shkalla e pjesëmarrjes e Roger Hart. Përshkrimi i shkallës shoqërohet edhe me shembuj nga zbatimi i kësaj të drejte në shkollat tona.

Shkalla e Manipulimit – Kur të rriturit vendosin se çfarë të bëhet dhe pyesin fëmijët nëse bien dakort me vendimin e tyre apo jo. Në fakt, ata e bëjnë këtë në një mënyrë të tillë që fëmijët të mos kenë rrugë tjetër, po veçse të bien dakort.

Shembuj: Klasa V^J e shkollës sonë organizoi një koncert për festën e Vitit të Ri. Mësuesja e muzikës e shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike, përgatiti skenarin, zgjodhi nxënësit që do të drejtonin koncertin e që do këndonin, ata që do recitonin si dhe kërcimtarët. Nxënësit u lajmëruan vetëm në momentin e fundit dhe askush nuk foli (ose të gjithë folën me mendje). Ata bënë atë që kishte projektuar mësuesja.

Shkalla e Dekoracionit – Kur të rriturit vendosin se çfarë të bëhet. Fëmijët marrin pjesë në aktivitete nëpërmjet këngës, valleve apo funksione të tjera ceremoniale, si psh. përshëndetje në një konferencë.

Shembuj: Klasa V^J e shkollës sonë organizoi një koncert për festën e Vitit të Ri. Mësuesja e muzikës e shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike, përgatiti skenarin, zgjodhi nxënësit që do të drejtonin koncertin, që do këndonin, ata që do recitonin si dhe kërcimtarët. Nxënësit morën pjesë në koncertin e organizuar, por ata bënë vetëm atë që kishte projektuar mësuesja.

Shkalla e Tokenizmit – Kur të rriturit vendosin se çfarë të bëhet ndërsa fëmijët janë të lejuar të bëjnë disa ndryshime të vogla.

Shembuj: Klasa V^J e shkollës sonë organizoi një koncert për festën e Vitit të Ri. Mësuesja e muzikës e shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike përgatiti skenarin, zgjodhi nxënësit që do të drejtonin koncertin, që do këndonin, ata që do recitonin si dhe kërcimtarët. Nxënësit u lejuan që të ndryshonin rendin e këngëve në shfaqje, me qëllim që të kishin kohë të mjaftueshme për të ndërruar kostumet ata që kërcenin.

Shkalla e Ftesës (Percaktimi nga të rriturit) – Kur të rriturit ftojnë fëmijët të japin idetë e tyre, por marrin vendime sipas dëshirës së tyre.

Shembuj: Klasa V^J e shkollës sonë organizoi një koncert për festën e Vitit të Ri. Mësuesja e muzikës e shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike ftoi nxënësit në një takim ku do të diskutohej mbi përgatitjen e skenarit, zgjedhjen e nxënësve që do të drejtonin koncertin, ata që do këndonin, ata që do recitonin si dhe kërcimtarët. Nxënësit propozuan që në vend të koncertit ata të vinin në skenë një pjesë teatrale të shkurtër të shkruar prej një nxënëseje të klasës. Mësuesja i falenderoi nxënësit për propozimin, por ajo vendosi që të mos ndryshohej lloji i shfaqes. Ajo u prezantoi nxënësve skenarin e koncertit të përgatitur prej asaj vetë. Nxënësit ranë dakort me të gjitha përveçse me llojin e këngëve. Ata propozuan që të këndoheshin dhe këngë Rep. Mësuesja nuk ra dakort me këtë.

Për herë të parë nxënësit u ftuan që të diskutojnë për festën, ata dhanë mendime, po asnjë prej mendimeve të tyre nuk u mor parasysh.

Shkalla e Konsultimit – Kur të rriturit konsultojnë fëmijët dhe konsiderojnë me kujdes mendimin e tyre, marrin parasysh gjithë opinionet e dhëna

Shembuj: Klasa V^I e shkollës sonë organizoi një koncert për festën e Vitit të Ri. Mësuesja e muzikës e shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike ftoi nxënësit në një takim ku do të diskutohesh mbi përgatitjen e skenarit, zgjedhjen e nxënësve që do të drejtonin koncertin, ata që do këndonin, ata që do recitonin si dhe kërcimtarët. Nxënësit propozuan që në vend të koncertit ata të vinin në skenë një pjesë teatrale të shkurtër të shkruar prej një nxënëseje të klasës. Mësuesja u kërkoi nxënësve që të tregonin shkurt se për çfarë pjesë bëhej fjalë. Pasi mësuesja u njoh me përmbajtjen e pjesës ajo ra dakort për ndryshimin e aktivitetit nga koncert në teatër. Mësuesja diskutoi mbi aktorët e pjesës dhe nxënësit propozuan nxënësit më të mirë të klasës. Mësuesja shqyrtoi këtë propozim, po ajo sugjeroi se duhet të konsideronin edhe shokët e tyre të klasës që kishin recituar më mirë gjatë vitit apo që kishin shfaqur aftësi të mira imitimi dhe humori. Kështu që ajo u kërkoi nxënësve të zgjidhnin edhe nxënës që mund të mos ishin të mirë me mësim, po që kishin shfaqur talent aktorik gjatë viteve. Pas kësaj, mësuesja diskutoi me nxënësit mbi dekorin dhe ata propozuan palestrën e shkollës. Mësuesja u tregoi atyre se palestra do të rikonstrutohej, kështu që ata propozuan që t'i bëjnë një kërkesë drejtorisë të shtyjë kohën e konstruktimit. Mësuesja u kërkoi nxënësve që të mendonin edhe për një zgjidhje rezervë, në rast se shtyrja e punimeve ishte fare e pamundur. Nxënësit sugjeruan ta jepnin shfaqjen në klasën më të madhe të shkollës. Mësuesja vendosi që të përdornin klasën e nxënësve të të V^F, po ajo u kërkoi atyre që më parë të komunikonin me klasën V^F, që kishte hapësirën më të madhe të shkollës, nëse ata do ta kishin të lirë klasën ditën e fundit të shkollës.

Shkalla e Vendimit të përbashkët – Kur të rriturit marrin iniciativën për një aktivitet, por vendimet merren bashkarisht me fëmijët

Shembuj: Klasa V^I e shkollës sonë organizoi një koncert për festën e Vitit të Ri. Mësuesja e muzikës e shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike, ftoi nxënësit në një takim ku i prezantoi idenë e saj për një koncert artistik. Nxënësit propozuan që në vend të koncertit ata të vinin në skenë një pjesë teatrale të shkurtër të shkruar prej një nxënëseje të klasës. Mësuesja u kërkoi nxënësve që të tregonin shkurt se për çfarë pjesë bëhej fjalë. Mësuesja i lindi ideja se mund të bënin një shfaqje ku edhe koncerti edhe shfaqja teatrale të ishin pjesë të saj. Nxënësit diskutuan se sa e mundur ishte kjo, në lidhje me kohën në dispozicion dhe përgatitjet që kërkoheshin. Të dy palët ranë dakort që të organizojnë një shfaqje e cila të hapej dhe të mbyllej me një këngë dhe kërcim, dhe në mes të zhvillohej teatri. Për teatrin, nxënësit e njohën mësuesen me përmbajtjen dhe ajo ra dakort me pjesën. Mësuesja u propozoi nxënësve që teatri të shoqërohej me muzikë në sfond dhe të gjithë ranë dakort për këtë. Nxënësit nuk ishin dakort me llojin e muzikës që mësuesja propozoi dhe ata propozuan një këngë nga një grup të rinjsh. Mësuesja ra dakort për ndryshimin e grupit, po ajo propozoi që kënga duhej të zgjidhej në përshtatje me mesazhin e teatrit. Nxënësit ranë dakort për këtë.

Shkalla e Drejtimit nga fëmijët/ Të rriturit ndihmojnë – Kur fëmijët marrin iniciativën për një aktivitet dhe të rriturit ndihmojnë

Shembuj: Klasa V^I e shkollës sonë organizoi një shfaqje për festën e Vitit të Ri. Ata kërkuan ndihmën e mësueses së muzikës së shkollës e cila ndjek aktivitetet artistike. Ata e ftuan atë në një takim ku i prezantuan idenë e tyre për të vënë në skenë një pjesë teatrale të shkurtër të shkruar prej një nxënëseje të klasës. Mësuesja

u kërkoi nëse mund të ndihmonte me regjizurën, si dhe me kostumet. Nxënësit vlerësuan faktin që mësuesja ishte e gatshme për të ndihmuar, po ata do të donin më tepër ndihmën e saj në mësimin e këngëve që kishte pjesa. Mësuesja pranoi me kënaqësi. Ata i treguan mësueses shkurt mbi përmbajtjen e pjesës dhe se si ata kishin menduar të bënin provat. Mësuesja propozoi t'i kërkonte leje prindërve të tyre që nxënësit të bënin prova një orë çdo ditë pas mësimin. Nxënësit ranë dakort për këtë.

Shkalla e kalimit të gjithë përgjegjësisë te fëmijët – Kur fëmijët marrin iniciativën dhe vendosin se çfarë do të bëjnë në një aktivitet. Të rriturit përfshihen vetëm kur fëmijët kërkojnë ndihmë prej tyre¹.

Shembuji: *Klasa V^J e shkollës sonë organizoi një shfaqje për festën e Vitit të Ri. Atyre u lindi ideja që me këtë shfaqje të përshëndesnin njëri – tjetrin, mësuesit, qeverinë e nxënësve të shkollës, si dhe prindërit. Ata u mbledhën dhe vendosën se çfarë do të përmbante shfaqja dhe se çfarë duhet të bënte secili prej tyre. Në fund ata panë që kishte disa gjëra të cilat ata nuk mund t'i bënin dot. Psh, sigurimi i energjisë elektrike në shkollë në kohën e shfaqjes, apo marrja e kostumeve nga qendra e kulturës. Për këtë, fëmijët kërkuar ndihmën e mësueses kujdestare, të mësueses që drejton veprimtaritë e qeverisë së nxënësve, mësueses që drejton aktivitetet artistike në shkollë, si dhe prindërve të tyre. Të rriturit ranë dakort për këtë dhe ata i propozuan nxënësve që gjithashtu ata mund të ndihmonin në marrjen përsipër të roleve të caktuara në shfaqje. Nxënësit falenderuan prindërit dhe mësuesit, por ata vendosën se nëse do të kishin nevojë për këtë, do t'i lajmëronin vetë.*

Nga teoricienët dhe prakticienët e pjesëmarrjes aktive të nxënësve, mësojmë se pjesëmarrja e vërtetë fillon me **shkallën e konsultimit**. Të gjitha shkallët e përmendura para kësaj kanë të bëjnë me mospjesëmarrje. Që të zbatohet e drejta e fëmijëve për pjesëmarrje aktive, duhet të largohemi nga shkallët e para dhe të synojmë konsultimin dhe marrjen e vendimeve të përbashkëta. Nëse ju arrini të “ngjisni” nxënësit tuaj në shkallën e fundit ku fëmijët marrin iniciativën dhe vendosin se çfarë do të bëjnë në një aktivitet dhe të rriturit përfshihen vetëm kur fëmijët kërkojnë ndihmë prej tyre, atëherë me kënaqësi ju themi se ju nuk keni më nevojë për këtë libër. Ju mund të shkruani librin tuaj se si mësuesit e tjerë në Shqipëri të besojnë, nxisin dhe krijojnë një klimë të tillë në shkollë ku fëmijët të marrin iniciativa dhe të minimizojnë shkeljen e të drejtave të tyre në shkollë.

¹ Hart, R.A. “Children’s participation, the theory and practice of involving young citizens in community development and environment care”. Taken from Alderson, P. “Young Children’s Rights, Exploring believes, principles and practice” 2001, page 92.

III Cilat janë parimet që duhet të na udhëheqin në një proces demokratik zgjedhor në institucionet shkollore?

Situata që kërkojnë zgjidhje:

Cili është peridiociteti i zgjedhjeve në shkolla? Po procesi? A ka nevojë për financa?

Cilat janë parimet e një procesi zgjedhor?

- DENI ishte senator i klasës së VI^A të shkollës 9 vjeçare “Avni Rustemi”. Largësia e shkollës nga shtëpia e re e detyroi të rregjistrohet pranë shkollës “Bajram Curri”, klasa VI^B. A mund të jetë DENI senator i klasës VI^B?
- Blerta e shqetësuar paraqitet pranë Komisionit të Zgjedhjeve 2005-2006 në shkollën “Fan Noli” me pretendimin se nuk kishte emrin në listen e zgjedhësve senatorë për “Presidentin” e shkollës. Si e vlerësoni veprimin e Blertës?
- Mësuesja kujdestare i propozon klasës që “senatore” të jetë Majlinda. A ka të drejtë të propozojë apo emërojë senatorët mësuesja kujdestare?
- Qeveria e Nxënësve të shkollës “Naim Frashëri” është shumë e shqetësuar për nivelin e ulët të pjesmarrjes në votime të nxënësve për senatorët e klasës. A përbën për ju shqetësim ky fakt? Çfarë shprehin statistikatat tuaja në tre vitet e fundit për pjesmarrjen në zgjedhjet për Qeverinë e Nxënësve? Si mendoni, cilat janë shkaqet e rënies apo të rritjes së pjesmarrjes në votime?
- Joni, kandidat për “senator” i klasës së V. Ai nuk pranon rezultatin e votimit në favor të Entelës. Ai kërkon rinumërim. A ka të drejtë? Kush mund të ketë gabuar?
- Qeveria e Nxënësve paraqiti para drejtorit të shkollës “Koston e zgjedhjeve 2005-2006 për Qeverinë e Nxënësve”. Drejtori u shpreh se nuk është detyrë e tij. Referojuni “Dispozitave Normative të MASH, 2002” dhe përcaktoni ligjërisht rrugën që duhet të ndiqet në këtë rast
- Merita, kandidate për senatore e klasës së VII^D vazhdonte fushatën për ta mbështetur atë gjatë kohës kur po zhvillohej votimi në klasë. Mendoni se ka të drejtë ta bëjë këtë? Cili rregull në Rregulloren e Brendshme të Qeverisë së Nxënësve do ta normonte ligjërisht këtë situatë?

Janë këto disa nga situatat me të cilat shpesh mësuesit ndeshen gjatë një procesi shkollor, veprimtaritë jashtë kurrikulare të të cilit fillojnë me zgjedhjet për Qeverinë e Nxënësve. Këto zgjedhje në shkolla janë të detyrueshme për t'u zhvilluar çdo vit për arsye se shkolla është një institucion ku generohen kontigjente nxënësish të rinj çdo vit. Si e tillë ajo e ka të detyrueshme të realizojë zgjedhje çdo fillim viti shkollor.

A ka datime të kushtëzuara?

Sigurisht që janë disa procedura që kushtëzojnë datime të zgjedhjeve brenda shkollës, në nivel qyteti apo vendi. Kështu, fillimi i vitit shkollor në të hënën e tretë të shtatorit na detyron që të ndjekim një procedurë të mëposhtme:

Java e parë e fillimit të shkollës – analizë e punës 1 vjeçare e Qeverisë së Nxënësve bazuar në objektivat e vëna një vit më parë. Në të njëjtën mbledhje Qeveria e Nxënësve ekzistuese dhe mësuesi kordinator bëjnë kalendarin e veprimit dhe të përgjegjësisve për organizimin e muajit elektoral. Çdo gjë nga kjo mbledhje bëhet e ditur për Drejtorinë e shkollës, bordin dhe vendoset në këndin e njoftimeve të Qeverisë së Nxënësve. Theksojmë “muajit” pasi duhet kjo kohë e nevojshme për të realizuar dy nivele të organizimit të zgjedhjeve: **1.** zgjedhjet për senatorët e klasave, **2.** zgjedhjet për “Presidentin”, “Kryetarin” dhe funksionet e tjera. Bazuar në këtë logjikë mund të vazhdojmë të ndërtojmë kalendarin e mëposhtëm:

Java e dytë – shpallja e zgjedhjeve për “senator” në klasa. Gjatë këtij procesi, Qeveria e Nxënësve në fuqi, mësuesi kordinator bëjnë kujdes për çështjet e mëposhtme:

- Informimin e shumëllojshëm për nxënësit dhe komunitetin shkollor mbi Fushatën e Zgjedhjeve. **Informimi** është baza e suksesit për pjesëmarrje aktive të nxënësve-zgjedhës në ushtrimin e të drejtës për të qenë i pasqyruar në listat zgjedhore të klasës apo Qeverisë së Nxënësve si zgjedhës, për të ushtruar të drejtën për të kandiduar si senator apo për “President”. Me këtë informim janë të lidhura dhe aftësitë e zgjedhësve apo kandidatëve për të marrë pjesë në takimet e kandidatëve apo për të menaxhuar drejtë fushatën elektorale. Ky informim është i nevojshëm edhe për të gjithë mbështetësit komunitarë apo administratorë që kanë role nga ligji shkollor apo që janë të zgjedhur komunitarë (Bordi) që të ndjekin procesin elektoral shkollor. Përdorimi i të drejtës për të informuar apo për t'u informuar është një e drejtë dhe përgjegjësi e institucionit shkollor dhe e çdo aktori të tij (nxënës, mësues, administrator, komunitar i zgjedhur, komunitar mbështetës, OJF e interesuar drejt shkollës, forumi lokal apo rrjeti kombëtar e më gjërë).
- Pas informimit krijimi i mundësive të barabarta për fushatë të kandidatëve është detyrimi i administratorëve të këtyre zgjedhjeve. Asnjë dhe nga askush nuk mund të privohen kandidatët që plotësojnë kriteret e miratuara me konsensus në Rregulloren e Brendshme të Qeverisë së Nxënësve. Këto kandidatë gëzojnë “barazi” për të deklaruar veten si të tillë kur plotësojnë kriteret, për të shfrytëzuar të gjitha format e reklamës elektorale në vende dhe në kohë që nuk cënojnë Ligjin Shkollor. Ky akses i barabartë duhet të jetë i deklaruar në mundësitë që i ofrohen nga institucioni shkollor kandidatëve si kualifikim, në ruajtjen e “të mos bërit fushatë” kur po

votohet, në përfaqësues të kandidatëve kur numërohen votat, në mundësitë për të rinumëruar votat kur nuk binden për rezultatin.

- Plotësimi dhe komunikimi dinamik Qeveri e Nxënësve - Nxënës - Komunitet në këndin e Qeverisë së Nxënësve me materiale elektorale (afate, kalendar veprimesh, persona përgjegjës për elementë të ndryshëm si listat, informacion, lehtësim për ambjente shkollore të kërkuara nga “kandidat senatorët”, oraret e veprimeve në klasa, postera, adresarë etj). Themi plotësim se në rrugë e sipër (gjatë procesit zgjedhor) mund të lindë nevoja e plotësimit të shumë elementëve si psh. ndryshimi i Qendrave të Votimit (klasave të përshtatshme për të tilla), afrimi i donatorit ekonomik për zgjedhje që çon në “sofistikimin” e çdo elementi të përdorur nga kandidatët në konkurim apo administratorëve për të lehtësuar procesin, dorëheqje të kandidatëve konkurues dhe zëvendësimi i tyre etj.
- Referuar këtij elementi të fundit duhet që sigurimi jo më pak se dy i kandidaturave konkurente për “senator” në çdo klasë është rregulli minimal i konkurimit duke qenë një detyrim që duhet realizuar nga administratorët e zgjedhjeve (Drejtoria, qeveria ekzistuese e nxënësve, mësuesi kordinator). Vetëm kështu ne mund të krijojmë standartin minimal të “zgjedhjes” për çdo votues apo bashkësi votuesish-klasa.
- Në këtë garë të konkurentëve administratorët e zgjedhjeve duhet të lehtësojnë, këshillojnë ose ofrojnë kualifikime që kërkohen nga kandidatët por mbi të gjitha të jenë të planifikuara e të deklaruara nga administratorët për të interesuarit. Kujdes, mos harroni se të tillë mund të jenë edhe prindër që gëzojnë aftësi të tilla dhe që ushtrojnë përgjegjësinë e tyre në shkollë, punonjës të pushtetit vendor që merren me probleme të tilla apo OJF në mbështetje të inisiativave të tilla.
- Pas listave të votimit dhe gatishmërisë së kandidatëve për të konkuruar, përgatitja e fletës model të votimit me standart është një angazhim serioz. Në përgatitjen e standartit duhet kompromisi i të gjithë administratorëve dhe informimi për plotësimin korrekt të saj është detyrim po i administratorëve. Një fletë e tillë dhe mënyra e plotësimit të saj duhet të jetë e paraqitur në Këndin e Zgjedhjeve në shkollë apo klasë. Mos harroni se numri fletëve të votimit për çdo Qendër Votimi-klasë duhet të jetë i barabartë me numrin e nxënësve të klasës. Këto fletë i dorëzohen klasës nga grupi i punës për organizimin e zgjedhjeve me një procesverbal ku konfirmohet numri i tyre. Këtu merr fund administrimi i procesit parazgjedhor – standarti i fletës së votimit. Marrja në dorëzim e tyre është 1 orë përpara se të hapet procesi zgjedhor (me orë të përcaktuar nga administratorët dhe të njohur nga të gjithë votuesit).
- Kështu nis administrimi i procesit zgjedhor tashmë në bazë klase. Ky proces kërkon rregull dhe pjesmarrje të lartë të votuesve-nxënës. Gjatë këtij procesi zgjedhor **vëzhguesit** e caktuar nga Qeveria e Nxënësve ekzistuese për çdo klasë janë një standart që tregojnë rregullsinë e zgjedhjeve dhe pranimin nga konkurentët të rezultatit. Këto vëzhgues mund të jenë edhe nga Forumi Lokal por gjithmonë të pranuar e deklaruar nga Grupi i punës për klasat përkatëse.

Informacionet e vëzhguesve për rregullsinë e procesit zgjedhor në Qendrat e Votimit – klasa janë shumë të rëndësishme. Kujdes, nuk duhet harruar se vëzhguesit janë njerëz të paanshëm ndaj kandidatëve konkurrentë.

- Komunikimi dhe shpallja zyrtare është përgjegjësi e Grupit të punës me bazë klase dhe shkolle. Administratorët kanë detyrën e të bërit publik për të gjithë të interesuarit dhe në forma e në vende të planifikuara më parë. Kjo ndodh menjëherë sapo mbyllet procesi i numërimit të votave për të dy nivelet e të zgjedhurve si për “Senator i klasës” ashtu edhe për të gjitha pozicionet kur formëzohet Qeveria e Nxënësve dhe Presidenti i saj. Përpunimi i rezultateve me elementë tillë si niveli i pjesmarrjes në zgjedhje, numri i kandidatëve konkurrentë, raporti vajza-djem, të mandatuar për herë të dytë apo të zgjedhur rrishtas, senatorë të grupeve të caktura etnike apo minoritare (kur kemi të tillë), klasat me treguesit më të lartë etj duhet të jenë pjesë përbërëse e cilësisë së zgjedhjeve të siguruara dhe e cilësisë së përfaqësuesve në to.
- Realizimi i procesit zgjedhor të ligjshëm dhe përpunimi i rezultateve është një objekt i bukur i gazetës së shkollës apo në mënyrë specifike të gazetës elektorale kur një mundësi e tillë ekziston. Kjo është një fuqi, është një pushtet që duhet përdorur nga administratorët.

-
- **Mos harroni!** Procesverbal i zgjedhjeve nën firmë të Grupit të Punës dhe Vëzhguesit, në nivel klase e shkolle duhet të bëhet publik në klasë apo shkollë edhe në Këndet Zgjedhore.
 - Mandatimi i “Senatorit” për çdo Qendër Votimi-klasë vjen pas publikimit të rezultatit. Ai standartizohet në rregulloren e Brendshme të Qeverisë së Nxënësve dhe mban firmën e presidentit të Qeverisë së Nxënësve ekzistuese.
-

Java e tretë – mund ta quajmë Java e Organizimit të Qeverisë së re të Nxënësve. Kordinatori dhe ish Presidenti verifikojnë mandatet e “Senatorëve” me bazë klase. Nën drejtimin e kordinatorit, kjo Qeveri e re e Nxënësve ndërton objektivat e punës për Planin e Punës dhe krijon brenda vetes mundësinë e **kandidaturave alternative** për President, Kryetar, Financier (cilësia dhe numri i të cilave përcaktohet nga kushtet e shkollës). Me rëndësi është edhe përcaktimi i strukturës së Komisionëve të Qeverisë. Këto sigurisht varen nga një model që është zgjedhur në vite, por edhe nga problematika të mprehta që karakterizojnë problemet shkollore apo komunitetin ku vepron Qeveria e Nxënësve (komunitet me minoritete, komunitet me nxënës të ngjuar, komunitet me një varfëri ekstreme, komunitet me një numër të konsiderueshëm të fëmijëve me aftësi të kufizuara, etj. problematika që detyrojnë emërtime konkrete dhe objektiva specifike të aktivitetit të Qeverisë së Nxënësve). Në këtë garim të dytë zgjedhor vlen të çmohet vullneti i kandidatëve konkurues bazuar në Objektivat dhe Planin e Punës së Qeverisë së Nxënësve për të gjitha pozicionet që priten të finalizojnë ndërtimin strukturor të Qeverisë. Kështu fundjava e tretë qysh nga fillimi i shkollës, vjen me përfundimin e këtyre zgjedhjeve brenda Qeverisë. Emrat e fituesve bëhen të ditur për gjithë komunitetin shkollor. Qeveria e Nxënësve përcakton Ditën e Celebrimit të saj në javën e katërt.

Java e katërt – Celebrimi i Qeverisë së Nxënësve.

Kjo ditë duhet të jetë e ditur dhe e vlerësuar nga të gjithë sikurse drejtorja merr masat e një Celebrimi zyrtar. Kjo kërkon që mësuesi kordinator dhe Qeveria e Nxënësve duhet të jenë të kujdesshëm për ftesat ndaj figurave publike komunitare si Deputeti i Zonës, Kryetarët e Bashkive, Drejtorët e Policisë, Shëndetësisë, OJF të interesuara, përfaqësues të biznesit mbështetës ndaj shkollës, prindër, media, etj. Partnerët e një procesi mësimor edukativ duhet të jenë pjesëmarrësit e një ngjarjeje të tillë ku:

- zyrtarizohet Qeveria e Nxënësve në emërtimet përfaqësuese të cdo klase duke verifikuar mandatet e secilit
- shpallet programi i Qeverisë së Re
- shpallen Presidenti, Kryetari, Kryetarët e Komisioneve
- realizohet betimi i tyre
- mandatohen nga Drejtori i Shkollës gjithë pjestarët e Qeverisë së Nxënësve të zgjedhur.

Kujdes! Mos harroni që çdo momentt i procesit zgjedhor duhet të pasqyrohet në gazetën e shkollës nëse ajo funksionon apo fletëpalosje të përgatitura për këtë ngjarje me rëndësi për shkollën e komunitetin. Mos neglizhoni median elektronike. Mos harroni të shkruani edhe për gazeta komunitare. Në çdo hap konsultohuni e mbështetuni tek Kryetari i Bordit të Shkollës i cili mund të lehtësojë “financat zgjedhore” nga aktivizime të biznesit komunitar. Këto “financa” duhet të jenë pjesë e Projekt Buxhetit që Drejtorja e Shkollës paraqet për Bordin qysh në javën e parë të shkollës pas bashkëhartimit të Objektivave Vjetorë. Të ndjeshme për mbështetje të institucioneve dhe praktikave të tilla demokratike në shkolla janë edhe Organozatat Jo Fitimprurëse. Proveni të kontaktoni me to kur ekzistojnë këto aktivitete në lokalitetin tuaj!

Në nivel lokal është mirë që Dita e Celebrimit të Qeverisë së Nxënësve të jetë e njëjtë për të gjithë institucionet shkollore. Qyteti, lokaliteti atë ditë duhet të ndjejë që ka një qeverisje më shumë me bazë shkollën por edhe për komunitetin. Kjo është një nga mënyrat me të cilat shteti, institucionet qendrore të tij, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtorja Arsimore Rajonale apo Zyrtar e Arsimit shprehin dhe marrin angazhimin zyrtar të :

- pranimit të Qeverisë së Nxënësve si pjesë e qeverisjes shkollore
- lehtësojnë e mbështesin procesin demokratik të zgjedhjes dhe aktivitetin qeverisës
- pranojnë e organizojnë një shkollë e cila ka si pjesë të edukimit të saj edhe hulumtimin, **edukimin e përsosjen e liderit të ri** në aktivitet për qeverisjen shkollore dhe ndryshimin demokratik në komunitete.

Cilat janë parimet që nuk duhen harruar nga Grupi i Punës për procesin Zgjedhor pranë Senatit por edhe i vëzhguesve të caktuar në çdo klasë nga senati në këto procese:

1. realizimi i zgjedhjeve vjetore të Qeverisë së Nxënësve
2. sigurimi i mjedisit zgjedhor në të gjithë elementët. Këtu nuk duhen harruar: procedurat ligjore, administrimi nga përgjegjësit në mënyrë jopartizane (jo tifozë), transparente dhe të lexueshme për të gjithë
3. hartimi i standarteve për kandidatët, procesin etj
4. respektimi rigoroz i pjesmarrjes pa përjashtuar askënd
5. edukimi i zgjedhësve për të drejtën: përgjegjësi, ushtrimin e votës dhe në Qendrën e votimit
6. ushtrimi për zbatim i parimit demokratik zgjedhor “Një anëtar, një votë”
7. votimi i fshehtë
8. shprehja e lirë e votuesve dhe të interesuarve mbi korrektësinë ose jo të procesit zgjedhor në tërësi.
9. pranimi i rezultatit nga të gjithë.

Qëllimet:

Të prezantoje konceptin e qeverisë së nxënësve duke:

- Diskutuar filozofinë që qëndron në krijimin e qeverisë së nxënësve
- Treguar si kontribuon qeveria e nxënësve në edukimin qytetar dhe iniciativat shkollore
- Reflektuar mënyrën e përfitimit të shkollës nga qeveria e nxënësve

Rezultate:

Të kemi:

- Qartësuar adresimin e udhëzimeve kombëtare nëpërmjet zbatimit të një programi me qeverinë e nxënësve në shkollë
- Qartësuar si qeveria e nxënësve do të ndihmojë në arritjen e qëllimeve specifike për një shkollë të shëndetshme.
- Hartuar një listë mënyrash me anë të të cilave një qeveri nxënësish mund të sjellë përfitime për shkollën

Burime

- 4 materiale për prezantim
- 1 material shpërndarës

Lexime:

- Dispozita Normative për shkollat publike

*I gjithë grupi***1 Koncepti i qeverisë së nxënësve**
(15 minuta)

- Qeveria e nxënësve ndihmon nxënësit të kuptojnë aftësitë e tyre për të arritur ndryshime pozitive duke:
 - përfshirë nxënësit në vendimmarrje për çështje që kanë të bëjnë me ta
 - respektuar nxënësit si partnerë në vetë edukimin e tyre
 - përfshirë tërë komunitetin e shkollës në zhvillimin dhe ruajtjen e standarteve të përbashkëta të sjelljes
- Brenda shkollës ka nevojë për funksionimin e disa strukturave efektive komunikuese si psh: bashkëbisedimet në rreth, mbledhje me klasën, qeveria e nxënësve.
- Secila prej këtyre strukturave prezantohet në materialet shoqëruese dhe shpjegohet në detaje në sesionet pasardhëse.

Material prezantues 1***struktura e qeverisë së nxënësve***

Diagrama tregon se si:

- Bisedimet në rreth, ndërmjetësimi mes moshatarëve dhe mbledhjet e klasës aftësojnë nxënësit për të zhvilluar aftësi personale dhe sociale.
- Struktura e qeverisë së nxënësve aftëson nxënësit, mësuesit, drejtuesit dhe prindërit për të qenë pjesëmarrës në vendimet e shkollës.

Material prezantues 2***Arsye për krijimin e qeverisë së nxënësve*****2 Diskutime**

(15 minuta)

- Diskutoni mbi mënyrat se si shkolla i adreson dhe i mbulon udhëzimet kombëtare mbi kurrikulën.
- Hidhni ide dhe shkruani në tabakë letre mundësitë momentale të nxënësve për të fituar aftësitë e shprehura në udhëzim si pjesë e përvojës së tyre shkollore.


3 Plani

(15 minuta)

- Nënvizoni faktin se qeveria e nxënësve nuk kërkon shumë kohë nga koha e mësuesve. Ata u sigurojnë nxënësve struktura të tilla me anë të të cilave ata mund të zgjidhin probleme për veten e tyre pa angazhuar anëtarë të stafit të shkollës.
- Jepini çdo personi një mundësi për të shprehur atë që ata mendojnë se mund të përfitojë shkolla nga funksionimi i qeverisë së nxënësve dhe se si mund të përshtatet kjo brenda strukturave ekzistuese në shkollë.
- Merrni në konsideratë çështjet apo problemet e shkollës të cilat mund të zgjidheshin nëse nxënësit do të ishin përfshirë më aktivisht.
- Shënoni të gjitha idetë në tabakë letre dhe ruajini ato – do të jenë të vlefshme kur të punohet mbi planin e veprimit të qeverisë së nxënësve

Material prezantimi 1

Strukturat e qeverisë së nxënësve



Material prezantimi 2

Arsye për krijimin e qeverisë së nxënësve

- Fëmijët kanë të drejtë të shprehin lirshëm mendimin e tyre në çështje që lidhen me ta – Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Neni 12
- Shkolla është një komunitet
- Qeveria e nxënësve ndihmon për ta bërë këtë komunitet më harmonioz dhe të mirë për të jetuar në të.
- Nxënësit bëhen partnerë në vetë arsimimin e tyre, duke dhënë një kontribut pozitiv ndaj mjedisit shkollor.
- Nxënësit mësojnë të dëgjojnë të tjerët dhe ta njohin vetveten si individë të vlefshëm me të drejtën për t'u dëgjuar.
- Nxënësit fitojnë vetëbesim, aftësi sociale dhe sjellje morale të përgjegjshme kundrejt njëri-tjetrit dhe kundrejt mësuesve të tyre.
- Qeveria e nxënësve rrit influencën e një udhëheqje positive në grup.
- Nxënësve u rritet vetëvlerësimi duke dhënë kontribut për klasën dhe komunitetin e shkollës së tyre.
- Çdo nxënës mëson nga përvoja personale se si të kontribuojë në shoqëri në tërësi si dhe çdo të thotë të jesh një qytetar aktiv.

MATERIAL SHPËRNDARËS

Prezantimi me qeverinë e nxënësve

1 Si përfitojnë shkollat nga përfshirja e nxënësve

Klima tërësore e një shkolle ndryshon kur nxënësit ushtrojnë influencë pozitive tek njëri - tjetri nëpërmjet strukturave që u japin përgjegjësi për vendimarrje

- Sjelljet jo sociale bëhen përgjegjësi e klasës dhe rrjedhimisht zvogëlohet autoriteti i grupeve anti sociale.
- Mësuesit mund të shpenzojnë më pak kohë duke u marrë më çështje të tilla si: fyerjet apo sharjet, sjelljet shqetësuese, mosfrekuentimin, vandalizmat dhe përgjashtimet.
- Mësuesit kanë më shumë kohë për të dhënë mësim, reduktohet niveli i stresit, përmirësohen marrëdhëniet midis mësuesve dhe nxënësve dhe ambienti mësimor bëhet më efektiv.
- Nxënësit ndihen përgjegjës si partnerë në vetë arsimimin e tyre dhe janë në gjendje t'ia dalin me shumicën e mundësive mësimore që u ofron shkollla.
- Nxënësit e kuptojnë më mire gjuhën e njëri – tjetrit, ata ndihen më të lirshëm e shkolla kthehet në një mjedis më miqësor.

Qeveria e nxënësve dhe edukimi qytetar

Programi i qeverisë së nxënësve i mundëson fëmijët të zhvillohen si individë që mund të japin kontribut pozitiv për shkollën dhe komunitetin e tyre. Qeveria e nxënësve u krijon atyre mundësinë për të krijuar përvojën vetjake mbi qytetarinë aktive, duke u ndërgjegjësuar për rolin që mund të kenë në komunitet.

Qeveria e nxënësve i ndihmon fëmijët të:

- Kuptojnë vlerën e tyre, të punojnë mirë me

të tjerët dhe të bëhen të përgjegjshëm për vetë mësimin e tyre

- Reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe kuptojnë si po zhvillohen personalisht dhe shoqërisht, duke prekur shumë çështje morale, shpirtërore dhe kulturore të cilat janë pjesë e rritjes së tyre.
- Zbulojnë institucionet kyçe politike dhe sociale që afektojnë jetën e tyre si dhe mbi përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet e tyre si individë dhe anëtarë të komunitetit.
- Ushtrojnë të drejtën e tyre të pjesëmarrjes

Njohuritë, aftësitë dhe kuptimi

Qeveria e nxënësve i mëson nxënësit të përgatiten për të luajtur një rol aktiv si qytetarë duke mësuar:

- të bëjnë kërkime, diskutojnë dhe debatojnë mbi çështje kyçe, probleme apo dhe ngjarje
- arsyet e formimit të rregullave dhe ligjeve, përse nevojiten rregulla të ndryshme në situata të ndryshme dhe si të marrin pjesë në bërjen dhe ndryshimin e rregullave
- të kuptojnë rrjedhojat e sjelljes antisociale dhe agresive
- se ka lloje të ndryshme përgjegjësish, të drejtash dhe detyrimesh në shtëpi, shkollë dhe shoqëri
- të zgjidhin dallimet duke parë alternativat, marrë vendime dhe duke shpjeguar zgjedhjet
- çfarë është demokracia dhe cilat janë institucionet që e mbështesin atë në nivel lokal dhe kombëtar.

Qeveria e nxënësve zhvillon te nxënësit ndjenjën e besimit dhe përgjegjësisë duke u dhënë atyre aftësi të shumta që të:

- flasin dhe shkruajnë mbi mendimin e tyre, dhe

të shpjegojnë pikëpamjet e tyre në çështje që i afektojnë

- njohin vlerën e tyre si individë nëpërmjet identifikimit të gjërave pozitive për veten dhe arritjet e tyre, duke parë gabimet, duke bërë ndryshime dhe dukë i vënë vetes qëllime
- përballen pozitivisht me sfida të reja duke mbledhur informacion, duke kërkuar ndihmë, dukë bërë zgjedhje të përgjegjësme, duke ndërmjetësuar dhe duke ndërmarrë veprime.

Qeveria e nxënësve i mëson nxënësit si të zhvillojnë marrëdhënie të mira dhe si të respektojnë dallimet mes njerëzve, duke u treguar atyre se si:

- veprimet e tyre afektojnë veten e tyre dhe të tjerët,
- të kujdesen për ndjenjat e njerëzve të tjerë dhe të përpiqen t'i shohin ata nga pikëpamjet e tyre,
- të ndërgjegjësohen mbi llojet e ndryshme të marrëdhënieve dhe të zhvillojnë aftësi për të qenë efektivë,
- të kuptojnë natyrën dhe rrjedhojat e racizmit, ngacmimit, fyerjeve dhe sjelljeve agresive, si t'u përgjigjen dhe si të kërkojnë ndihmë.

Gama e mundësive

Qeveria e nxënësve i pajis nxënësit me njohuri dhe kuptim duke u dhënë mundësi të:

- marrin përgjegjësi (p.sh. për planifikim dhe kujdes ndaj mjedisit të shkollës ose për të ndihmuar të tjerët, duke qenë në rolin e mbështetësve për moshatarët e tyre apo si ndërmjetësues për nxënës më të rinj),
- ndihen pozitivisht për vetveten (p.sh. duke patur mundësi të tregojnë atë që mund të bëjnë dhe se sa shumë përgjegjësi mund të marrin mbi vete),
- jenë pjesëmarrës (p.sh. në procesin vendim-marrës të shkollës, duke lidhur atë me strukturat dhe proceset demokratike si këshillat, parlamentin, qeverinë dhe votimin),

- zhvillojnë raporte nëpërmjet punës dhe lojës,
- marrin në konsideratë dilemat sociale dhe morale me të cilat do të përballen në jetë.
- përgatiten për të qenë drejtues e pjesëmarrës në një shoqëri demokratike

Qeveria e nxënësve dhe të drejtat e fëmijëve

Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës 1989, deklaroi se fëmijëve u duhet dhënë mundësia për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me çështje që kanë lidhje me ta dhe të cilat duhen marrë në konsideratë (artikulli 12). Qeveria e nxënësve është një hap i rëndësishëm në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve në shkollë dhe në përgatitjen e tyre për të kërkuar të drejtat e tyre në komunitet e më gjerë.

2 Si përfitojnë nxënësit nga qeveria e nxënësve

Qeveria e nxënësve jep kontributin e saj për ndryshime pozitive në jetën e çdo nxënësi në shkollë. Përfshirja e nxënësve në çështje reale i ndihmon ata të zhvillojnë aftësi jetësore të rëndësishme të cilat nxisin shëndetin mendor dhe social-të folurin, mendimin kritik, vetëvlerësimin, vetëndërgjegjësimin, aftësitë komunikuese dhe sigurinë.

3 Strukturat e qeverisë së nxënësve

Qeveritë e nxënësve kërkojnë struktura për komunikim dhe përfshirje në çdo nivel brenda shkollës. Ato mund të organizohen në format e mëposhtme:

Bashkëbisedim në rreth

Ky është themeli bazë mbi të cilin duhet ngritur shtruktura për qeverinë e nxënësve.

Ky lloj bashkëbisedimi mund të përdoret edhe me fëmijët më të vegjël në mënyrë që ata të mësohen me këtë formë ndërkohë që kalojnë nga njëri vit në tjetrin.

Nëpërmjet bashkëbisedimeve në rreth fëmijët mësojnë të:

- flasin me rradhë
- dëgjojnë të tjerët,
- respektojnë mendimin e të tjerëve i cili është ndryshe nga mendimi i tyre,
- shprehin pikëpamjet e tyre

Ky lloj bisedimi siguron gjithashtu një mjedis të sigurtë ku nxënësit mund të flasin për çështje personale dhe të shprehin ndjenjat e tyre për të tjerët në mënyrë të përshtatshme. Me zhvillimin e këtij fenomeni, ata mund të adresojnë çështje të vështira si fyerjet, dhe të fitojnë aftësi ndërmjetësimi.

Mbledhjet e klasës

Mbledhjet me klasën u mundësojnë nxënësve rregullisht çdo javë të zgjidhin problemet e tyre të përditshme në shkollë. Këtu mund të përfshihen vështirësi praktike, si p.sh. mos të paturit e një hapësire të mjaftueshme për të vënë xhupat dhe çantat, çështje mbi uniformat, apo problemet

me sjelljen në klasë apo oborr.

Çështjet e ngritura në mbledhjet e klasës mund të jenë nxitje për senatorët e klasës që t'i adresojnë këto probleme gjatë mbledhjes së Qeverisë së Nxënësve.

Qeveria e nxënësve

Qeveria e nxënësve e cila takohet rregullisht, përbëhet nga nxënës të zgjedhur në mënyrë demokratike nga çdo klasë. Qeveria e nxënësve mundëson që të gjitha klasat e shkollës të ndërgjigjohen për problemet e njëri-tjetrit. Qeveria e nxënësve diskuton çështje dhe ide të cilat vijnë shqetësojnë apo propozohen nga të gjithë nxënësit e shkollës. Nxënësit e zgjedhur përfaqësojnë mendimet e shokëve të klasës në takimet e qeverisë së nxënësve, dhe është mjaft e rëndësishme që ata më pas të raportojnë në klasën e tyre për arritjet. Kjo i ndihmon përfaqësuesit të fitojnë besimin e shokëve të klasës, por gjithashtu mundëson shpërndarjen e informacionit të gjithë nxënësit.

▶ Përmbledhje e arsyeve për krijimin e qeverisë së nxënësve

- Fëmijët kanë të drejtë të shprehin lirshëm mendimin e tyre në çështje që lidhen me ta – Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Neni 12
- Shkolla është një komunitet. Komuniteti ka nevojë për mendimet e gjithë grupeve që t'u përgjigjet interesave të të gjithëve.
- Qeveria e nxënësve ndihmon që ky komunitet të jetë më harmonioz dhe më i mirë për të jetuar në të.
- Nxënësit bëhen partnerë në vetë edukimin e tyre, duke dhënë një kontribut pozitiv në ambientin dhe frymën shkollore.
- Nxënësit mësojnë të dëgjojnë të tjerët dhe të konsiderojnë veten e tyre si individë të vlefshëm me të drejtën për t'u dëgjuar.
- Nxënësit mësojnë vetëbesimin, aftësi sociale dhe sjellje morale të përgjegjshme në drejtëm të njëri-tjetrit dhe mësuesve e asistentëve.
- Qeveria e nxënësve rrit influencën positive të lidershit mes moshatarëve.
- Kontributi në klasën e tyre dhe komunitetin e shkollës i lejon nxënësit të rrisin vetëvlerësimin.
- Çdo nxënës mëson nga përvoja vetjake se si të kontribuojë në mbarë shoqërinë dhe çdo të thotë të jesh qytetar aktiv.

Qëllimet:

Të sigurojë që mësuesit janë të ndërgjegjshëm për:

- kohën dhe përkushtimin që nevojitet nga stafi i mësuesve
- modele rekomanduese për koordinimin e qeverisë së nxënësve.

Rezultate:

- të zhvillohet një plan veprimi për hapa të menjëhershëm që mund të ndërmarrin mësuesit për të koordinuar krijimin e qeverisë së nxënësve.

Burime

- 3 materiale prezantuese
- 1 material shpërndarës

1 Mësuesi kujdestar*20 minuta*

- lexoni seksionin 1 të materialeve – Mësuesi kujdestar

Material prezantues 1**Mësuesi kujdestar***Në çift*

- diskutoni duke i kushtuar vëmendje të veçantë pyetjes se si të inkurajojmë dhe të mbështesim diskutimin midis nxënësve në klasë

I gjithë grupi

- diskutim i përgjithshëm

2 I gjithë stafi*20 minuta**I gjithë grupi*

- lexoni seksionin e dytë dhe të tretë të materialit

Material prezantues 2**I gjithë stafi****Material prezantues 3****Mësuesi koordinator***Në çift*

- Diskutoni duke patur ndër mend pyetjet në vazhdim:

Si mund të siguroheni se i gjithë stafi e kupton dhe përfiton nga qeveria e nxënësve?

Si do t'i menaxhoni ndjenjat e nxënësve kur ata të kuptojnë se ka kufizime në gjërat që mund të arrijnë?

Përse është e rëndësishme për mësuesin koordinator të mos i dominojë mbledhjet?

3 Shkolla juaj*20 minuta*

- Listoni çështjet kryesore që janë ngritur për avantazhet dhe vështirësitë aktuale në lidhje me përfshirjen e stafit në qeverinë e nxënësve.
- Hartoni një plan veprimi në një tabak letre duke përdorur një format të ngjashëm me atë që vijon.

Roli i mësuesve në qeverinë tonë të nxënësve**Situata në favorin tonë**

Psh: të gjithë ramë dakort për rëndësinë e kohës së diskutimit

Vështirësi të mundshme

Psh: kemi një mësues të ri për semestrin e dytë për klasën e 4, dhe një mësues i klasës së 5 do të shkojë me leje lindje

Hapa të menjëhershëm

Psh: zgjedhja e mësuesit koordinator dhe fillimi i punës me nxënësit.

Material prezantimi 1

Mësuesi kujdestar

Roli i mësuesit kujdestar është mjaft i rëndësishëm, por nuk kërkon shumë shpenzim kohe. Ai siguron mbështetje efektive:

- për nxënësit që të zgjedhin përfaqësuesit e tyre të klasës për në qeverinë e nxënësve
- për të ndihmuar nxënësit të vendosin se si të organizojnë diskutimet e tyre
- duke u krijuar nxënësve mundësi të organizojnë mbledhje me klasën çdo javë*
- duke inkurajuar dhe mbështetur diskutimet në mënyrë të tillë që ato të drejtohen nga vetë nxënësit

I ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësi drejtuese duke:

- siguruar se gjatë mbledhjes së klasës janë mbajtur shënime
- vazhduar të përforcojë aftësitë drejtuese

Mbështet përfaqësuesit e klasës duke:

- inkurajuar ata të ndjekin mbledhjet e qeverisë së nxënësve
- siguruar se përfaqësuesit e klasës janë të përgatitur për mbledhjet e qeverisë së nxënësve dhe dinë se çfarë të marrin me vete
- t'u japë leje nga koha e mësimi për të raportuar mbrapsht te shokët e klasës pas mbledhjes me qeverinë e nxënësve.

* Mësuesit janë të inkurajuar që për mbledhjen e klasës të përdorin orët javore të kujdestarisë

Material prezantimi 2

Stafi i shkollës

Stafi i shkollës duhet të jetë entuziast dhe të mbajë qëndrim pozitiv ndaj mbledhjeve të klasës dhe të qeverisë së nxënësve.

Jepini stafit të shkollës mundësi për të diskutuar mbi çdo lloj shqetësimi duke:

- përfshirë qeverinë e nxënësve në programin e mbledhjeve të stafit të shkollës
- ftuar herë pas here kryetarin e qeverisë së nxënësve së bashku me një anëtar tjetër që të marrë pjesë në mbledhjen e stafit të shkollës

I gjithë stafi i shkollës mund t'i njoftojë prindërit mbi ecurinë e qeverisë së nxënësve duke:

- u treguar atyre mbi diskutimet në klasë dhe mënyrën si marrin pjesë fëmijët e tyre,
- folur në takimet me prindër mbi aktivitetet dhe arritjet e qeverisë së nxënësve.

Stafi i shkollës mund të kërkojë mbështetjen e kujdestarëve të tjerë të shkollës apo dhe stafit jo mësimdhënës duke:

- u treguar atyre mbi shqetësimet dhe aktivitetin e qeverisë së nxënësve,
- u siguruar që kushdo e njeh sistemin për ngritjen dhe vazhdimin e problemeve

Mësuesve të rinj apo atyre zëvendësues mund t'u tregohet mbi qeverinë e nxënësve nëpërmjet prezantimit të tyre në strukturat e shkollës.

Material prezantimi 3

Mësuesi koordinator

Në mënyrë që qeveria e nxënësve të merret seriozisht, mësuesi koordinator duhet të ketë një status në sy të nxënësve, mësuesve, drejtuesve dhe prindërve.

Mësuesi koordinator duhet të jetë:

- i përkushtuar ndaj qeverisë së nxënësve, në gjendje t'i kushtojë kohën e duhur dhe krijues në nxitjen e interesave të qeverisë së nxënësve.
- i aftë të lehtësojë pa dominuar,
- me vullnet për të dëgjuar dhe i aftë për të komunikuar.

Mësuesi koordinator është përgjegjës për:

- sigurimin e një procesi zgjedhësh te ndershëm dhe gjithëpërfshirës
- trainimin e nxënësve të zgjedhur si përfaqësues
- pjesëmarrjen në të gjitha mbledhjet e qeverisë së nxënësve (nëse i kërkohet një gjë e tillë) për të ndihmuar nxënësit të shkruajnë programet dhe të mbajnë shënime
- udhëzuar, këshilluar dhe dhënë informacion (nëse pyetet)
- të siguruar se çështjet e qeverisë së nxënësve diskutohen në mbledhjet e stafit të shkollës dhe të kujtojnë kolegët se përfaqësuesit e klasave kanë nevojë të raportojnë te shokët e tyre të klasës.
- të informuar stafin e shkollës, drejtuesit dhe prindërit mbi aktivitetin e qeverisë së nxënësve.
- të ndihmuar rritjen e profilit të qeverisë së nxënësve.

Mësuesi koordinator duhet të reflektojë mbi progresin e qeverisë së nxënësve dhe të vlerësojë zhvillimin e saj.

MATERIAL SHPËRNDARËS

Roli i mësuesve në qeverinë e nxënësve

1 Mësuesi kujdestar

Mësuesi kujdestar luan një rol thelbësor – që nuk kërkon shpenzim të madh kohe – duke i siguruar qeverisë së nxënësve një mbështetje efektive.

Mbledhjet e klasës

Nxënësit kanë nevojë për kohën e tyre për diskutimet në klasë – e preferueshme do të ishte 20 minuta çdo javë. Kjo është koha kur ata flasin për çështje që i shqetësojnë në klasën e tyre dhe përpiqen t'i trajtojnë ato, si dhe të identifikojnë çështjet të cilat do të ngrenë përfaqësuesit e klasës së tyre në mbledhjen e qeverisë së nxënësve. Së pari, mësuesit kujdestar do t'i duhet të ndihmojnë nxënësit të organizojnë diskutimet në klasë. Roli i tij është të inkurajojë dhe mbështesë – me raste dhe të marrë pjesë – diskutimet, por jo t'i udhëheqë ato.

Përfaqësuesit e klasës

Mësuesi kujdestar duhet ta dijë kur organizohen mbledhjet e qeverisë së nxënësve dhe t'i japë leje përfaqësuesit të klasës t'i ndjekë këto mbledhje. Mbas mbledhjes, sa më shpejt që të jetë e mundur, përfaqësuesit kanë nevojë për dy tre minuta për të raportuar dhe për t'ju përgjigjur pyetjeve të klasës mbi atë çka ndodh në mbledhjen e qeverisë së nxënësve. Qëndrimi pozitiv i mësuesit ndaj këtij fenomeni u tregon nxënësve se qeveria e tyre është e rëndësishme dhe merret seriozisht nga çdo person në shkollë.

2 I gjithë stafi i shkollës

Stafi në tërësi duhet të jetë i përkushtuar ndaj principeve që qëndrojnë në themel të ekzistencës së qeverive demokratike të nxënësve. Një përkushtim i tillë mund të demonstrohet duke:

- patur rregullisht një moment në mbledhjet e stafit pedagogjik ku të jepet informacion mbi çështjet e qeverisë së nxënësve.
- ftuar herë pas here kryetarin e qeverisë së nxënësve të ndjekë pjesë të mbledhjes së stafit, së bashku me nën kryetarin apo një anëtar tjetër të qeverisë së nxënësve,
- informuar prindërit mbi disa prej çështjeve që diskutohen nga nxënësit në klasë dhe përfshirjes së tyre në diskutime,
- folur mbi aktivitetet dhe arritjet e qeverisë së nxënësve në takimet me prindër
- u siguruar se mësuesit e rinj apo ata zëvendësues janë informuar mbi qeverinë e nxënësve nëpërmjet prezantimit të tyre në strukturat e shkollës.

3 Mësuesi kordinator

Ky është i vetmi rol i cili kërkon që mësuesi të shpenzojë një sasi të konsiderueshme të kohës së tij. Për mësuesin kordinator mund të jetë e nevojshme të jetë i pranishëm në mbledhjet e qeverisë, të jetë i përgatitur të ndjekë çështjet e ngritura në mbledhje, dhe të ketë një informacion të përgjithshëm të ecurisë dhe drejtimit të qeverisë. Në zgjedhjen e mësuesit kordinator duhen marrë në konsideratë cilësitë dhe aftësitë e duhura, koha në dispozicion si dhe mendimi i nxënësve. Në këtë proces një rol të rëndësishëm luan drejtori i shkollës.

Statusi

Personi që merr përsipër rolin e mësuesit kordinator duhet të ketë një status të caktuar në sytë e të gjithë nxënësve, pasi kjo u tregon atyre në mënyrë të menjëhershme se qeveria e nxënësve po merret në konsideratë seriozisht.

Zakonisht një rol i tillë ndërmerret nga ata mësues që janë të angazhuar vazhdimisht në shkollë të cilët gjenden pranë fëmijëve dhe njohin dëshirat dhe nevojat e tyre.

Mësuesi koordinator vepron si një lehtësues; ai duhet të aftësojë nxënësit të udhëheqin mbledhjet e qeverisë dhe të zhvillojnë diskutime – dhe jo t'i drejtojnë diskutimet vetë. Duke u trajnuar në aftësi drejtuese në fillim të vitit dhe duke u mbështetur për t'i praktikuar këto aftësi, nxënësve u jepen mundësi mjaft të rëndësishme për të mësuar. Ata do të mësojnë më shumë nga gabimet e tyre se sa po t'u merren përgjegjësitë nga duart. Kështu që mësuesi koordinator nuk duhet t'i dominojë mbledhjet, pavarësisht shpejtësisë për t'i dhënë zgjidhje.

Përkushtimi:

Është e rëndësishme që qeveria e nxënësve të gëzojë një reputacion të mirë në mjedisin përreth dhe për këtë ndihma e mësuesit koordinator është mjaft e çmuar. Vazhdimisht ai duhet të shprehë përshtypjet e tij në mbledhjet e stafit të shkollës duke e patur qeverinë e nxënësve në fokus të programeve shkollore si dhe duhet të mbajë prindërit të informuar mbi aktivitetin e qeverisë së nxënësve. Nëse mësuesi koordinator punon mirë në fazën fillestare, me kalimin e kohës puna e tij do të lehtësohet, pasi sa më efektive të bëhet qeveria e nxënësve, aq më shumë detyra do të marrin përsipër anëtarët e saj.

Në mënyrë që të gjitha kërkesat dhe idetë të jenë të përshtatshme dhe me vend, mësuesi koordinator duhet ta informojë qeverinë e nxënësve në lidhje me vendimet e shkollës që ata mund të influencojnë si dhe me kufizimet e mundshme.

Komunikimi

Shpesh mësuesi koordinator do të duhet të sillet si arbitër midis nxënësve dhe stafit të mësuesve. Aftësitë e të dëgjuarit janë mjaft të rëndësishme, kështu që mësuesi koordinator duhet të dëgjojë me vëmendje dhe të kuptojë pikëpamjet e të gjithë palëve në mënyrë që të jetë në gjendje të komunikojë efektivisht me të gjithë.

Psh. nëse drejtuesit hedhin poshtë një kërkesë të bërë nga qeveria e nxënësve, mësuesi koordinator do të duhet t'i japë qeverisë së nxënësve një sqarim të qartë mbi arsyet dhe të sigurohet se nxënësit e kanë kuptuar. Po ashtu, mësuesi koordinator duhet të sigurohet se stafi i shkollës e kupton krejtësisht këndvështrimin e nxënësve.

Herë pas here mësuesi koordinator duhet të kujtojë kolegët e tij t'i japin leje nxënësve të raportojnë te shokët e tyre të klasës mbi vendimet apo çështjet e diskutuara në mbledhjet e qeverisë.

Vlerësimi

Mësuesi koordinator ka nevojë për kohë për të reflektuar:

- mbi ecurinë e qeverisë nxënësve,
- mbi hapat që duhen ndërmarrë për të rritur reputacionin e saj,
- nëse arrijnë fëmijët të kenë rezultate apo zgjidhje si rrjedhojë e prezantimit të shqetësimeve të tyre,
- nëse qeveria e nxënësve vazhdon të jetë e rëndësishme në mënyrën si drejtohet shkolla,
- nëse stafi i mësuesve ka ndonjë problem apo vështirësi me mbledhjet e klasës.

UDHËZIM HAP PAS HAPI PËR KRIJIMIN E NJË QEVERIE NXËNËSISH EFEKTIVE

Qëllimet:

Të prezantojë udhëzime për krijimin e qeverisë së nxënësve të cilat:

- shpjegojnë procedurat e zgjedhjes
- parandalojnë rreziqe të mundshme
- sigurojnë efektivitetin e qeverisë

Rezultate:

Të biem dakort mbi:

- kohën e mundshme të krijimit të qeverisë së nxënësve
- si do të përqasen nxënësit, prindërit, dhe drejtuesit,
- si do të identifikohen koordinatorët e grupit të punës

Burime

- 3 materiale prezentuese
- 3 materiale shpërndarës
- Përbërja e modelit (nga shtojca 1)

1 Efektiviteti i qeverisë së nxënësve

20 minuta

I gjithë grupi

- Lexoni materialin shpërndarës 1, *Duke u siguruar mbi efektivitetin e qeverisë së nxënësve*

Material prezantues 1

Çfarë e bën një qeveri nxënësish efektive?

- Secili prej pjesëmarrësve me rradhë lexon një pikë dhe jep mendimin e tij përse kjo është përfshirë në listë, duke u pasuar me diskutim të gjerë.
- Shënoni pikat mbi të cilat të gjithë bien dakort në tabakë letre. Këto shënime do të jenë të dobishme për shkrimin e rregullores së qeverisë së nxënësve (një shembull paraqitet në Shtojcën 1).

2 Udhëzim hap pas hapi

20 minuta

Në çift

- Hidhni ide mbi hapat që nevojiten për krijimin e një qeverie nxënësish.

I gjithë grupi

- Shkruajini mendimet në tabakë letre
- I krahasoni ato me materialin prezantues. Kini

parasysh se çdo shkollë është e ndryshme dhe materialet e prezantuara janë vetëm një udhëzim.

Material prezantues 2

Udhëzim hap pas hapi për krijimin e një qeverie nxënësish efektive.

3 Procedura e zgjedhjes

20 minuta

- Duke përdorur materialin shpërndarës 2, *Procedura e zgjedhjes*, punoni mbi pikat e prezantuara duke diskutuar mbi procedurën dhe si mund të adaptohet ajo për t'iu përshtatur shkollës.

Material prezantues 3

Procedura e zgjedhjes

4 Diskutime

30 minuta

Duke reflektuar në tërësi për sesionin, diskutoni dhe mbani shënim mbi:

- kohën e mundshme të krijimit të qeverisë së nxënësve
- si do të përqasen nxënësit, prindërit, dhe drejtuesit,
- si do të identifikohen koordinatorët e grupit të punës dhe a do të jetë i njëjti person me mësuesin koordinator të qeverisë së nxënësve

Material prezantimi 1

Çfarë e bën një qeveri nxënësish efektive?

- Mbledhje të rregullta të paktën një herë në dy javë
- Një qeveri me numër të menaxhueshëm – 15 deri në 20 anëtarë maksimumi,
- Me balancë gjinore dhe raciale ndërmjet anëtarëve,
- Këshilla klase që mbledhen rregullisht për të diskutuar dhe trajtuar çështjet,
- Zgjedhje demokratike për të paktën dy përfaqësues në qeverinë e nxënësve nga çdo klasë,
- Komunikim të mirë midis përfaqësuesve të klasës në qeveri dhe nxënësve të tjerë të klasës, nëpërmjet raportimit menjëherë pas mbledhjeve të qeverisë së nxënësve,
- Trainim për anëtarët e qeverisë së nxënësve,
- Zgjedhja e një komiteti ekzekutiv,
- Anëtarë të cilët respektojnë dhe dëgjojnë njëri tjetrin,
- Nxënësit e kuptojnë përse ndonjëherë ka kufizime në arritjet që mund të ketë qeveria e tyre,
- Një mësues koordinator mbështetës dhe efektiv,
- Staf mësuesish mbështetës që nuk krijon pengesa për të takuar drejtorin.

Material prezantimi 2

Udhëzim hap pas hapi për krijimin e një qeverie nxënësish efektive.

- Tregojuni nxënësve se mësuesit duan të dinë atë që mendojnë nxënësit për jetën e tyre të përditshme në shkollë,
- Krijoni këshillin e klasës në çdo klasë,
- Drejtoria, stafi i mësuesve, qeveria e nxënësve, dhe prindërit japin idetë e tyre për:
 - pritjet e tyre nga qeveria e nxënësve, qëllimi dhe roli i saj
 - si do të përshtatet me shkollën,
 - si do të kontribuojë në zhvillimin e planit të shkollës
- Vendosni një mësues koordinator i cili gëzon besimin e stafit dhe nxënësve,
- Krijoni një grup pune, përfshirë edhe nxënës, që të merret me gjërat praktike si psh. organizimin e zgjedhjeve, kohën dhe vendin e takimeve, etj.
- Adaptoni një kushtetutë të thjeshtë,
- Vendosni një kohë për promovimin e qeverisë,
- Zhvilloni zgjedhjet në çdo klasë në ditën e rënë dakort më parë,
- Zhvilloni training me anëtarët e qeverisë së nxënësve mbi aftësitë drejtuese,
- Organizohet mbledhja e parë e qeverisë dhe zgjedhja e komitetit ekzekutiv.

Material prezantimi 3

Procedura e zgjedhjeve hap pas hapi

- Shpegojuni nxënësve çfarë kuptohet me zgjedhje demokratike,
- Grupi i punës planifikon procedurën,
- Të gjitha klasat diskutojnë mbi përfaqësimin e mirë,
- Fëmijët emërohen dhe kandidojnë për zgjedhje,
- Kandidatët vendosin mbi premtimet e tyre zgjedhore,
- Zhvillohet procedura e votimit,
- Shpallen rezultatet
- Mbahet mbledhja e parë e qeverisë.

Çështje për t'u adresuar nga grupi i punës:

- Numri i përfaqësuesve për t'u zgjedhur në çdo klasë,
- Balancimi racial dhe gjinor i kandidatëve dhe anëtarëve të qeverisë së nxënësve.
- Ku do të spallen emrat e kandidatëve
- Përcaktimi i formave të emërimit si dhe i fletëve të votimit
- Koha e zhvillimit të zgjedhjeve
- Si dhe kur do të numërohen votat
- Si dhe kur do të shpallen rezultatet

MATERIAL SHPËRNDARËS 1

Të sigurohemi për një qeveri nxënësish efektive

Suksesi i qeverisë së nxënësve varet nga një komunikim i mirë i cili:

- inkurajon të gjithë nxënësit të kenë interes mbi aktivitetet e qeverisë,
- informon stafin e mësuesve dhe nxënësit mbi projektet e qeverisë së nxënësve.

1 Çfarë e bën një qeveri nxënësish efektive?

- Mbledhje të rregullta të paktën një herë në dy javë
- Një numër i menaxhueshëm – 15 deri në 20 anëtarë maksimumi
- Balance gjinore dhe raciale ndërmjet anëtarëve
- Këshilla klase që mbledhen rregullisht për të diskutuar dhe trajtuar çështjet
- Zgjedhje demokratike për të paktën dy përfaqësues në qeveri nga çdo klasë
- Komunikim të mirë midis përfaqësuesve dhe klasës, me raportim menjëherë pas mbledhjeve të qeverisë së nxënësve
- Trainim për anëtarët e qeverisë së nxënësve
- Anëtarë të cilët respektojnë dhe dëgjojnë njëri – tjetrin
- Nxënësit i kuptojnë limitet në arritjet që mund të ketë qeveria e tyre
- Një mësues koordinator mbështetës dhe efektiv
- Staf mësuesish mbështetës që nuk krijon pengesa për të takuar drejtorin

2 Ndhurma për komunikim të mirë

- Një tabelë shënimesh shkolle vendosur në një vend qendror në shkollë

- Njoftime të përbashkëta
- Gazeta e qeverisë së nxënësve
- Kutia e sugjerimeve
- Një tabelë shënimesh në çdo klasë

3 Përfshirja e nxënësve të klasave fillore

Një anëtar i qeverisë së nxënësve mund të flasë me nxënësit e fillores mbi aktivitetet e qeverisë së nxënësve. Grupe prej dy apo tre nxënësish të këtyre klasave mund të marrin pjesë me radhë në mbledhjet e qeverisë së nxënësve me qëllim që të shprehin shqetësimet e klasave të tyre.

4 Shmangia e rreziqeve të zakonshme

Mungesë mbështetjeje nga ana e stafit të shkollës

- Sigurohuni që të gjithë të jenë përfshirë në procesin vendimarrës të hapave që ju do të ndërmerrni, si dhe mënyrën e kohën që do t'ju duhet.
- Sigurohuni që krijimi i qeverisë së nxënësve të jetë në fokusin e të gjithë shkollës.

Mungesë entuziazmi nga ana e nxënësve

- Jini të ndershëm me qeverinë dhe sigurohuni se ata e kuptojnë që në fillim se të arrihen ndryshime të dukshme në shkollë duhet angazhimi i të gjitha palëve të interesuara, dhe një gjë e tillë nuk do të jetë e lehtë.
- Jepni sqarime të përshtatshme dhe mbështetje mbi çështjet që kanë shkuar për trajtim të drejtoria apo stafi.
- Inkurajoni qeverinë të ndërmarrë projekte të vogla të arritshme por edhe ambicioze.

MATERIAL SHPËRNDARËS 2

Procedura e zgjedhjeve

Mësuesit duhet t'u shpjegojnë nxënësve çfarë kuptohet me zgjedhje demokratike, duke u treguar se edhe qeveria e nxënësve do të zgjidhet në të njëjtën mënyrë sikurse zgjidhen anëtarët e parlamentit. Kjo i ndihmon ata të kuptojnë si funksionon demokracia në vend.

1 Grupi i punës

Zgjedhjet demokratike janë një koncept i ri për nxënësit, kështu që një procedurë e thjeshtë do të ishte gjëja më e mirë. Si grup pune mund të funksionojë Qeveria e mëparshme, e cila e gëzon këtë status deri në zgjedhjet e reja. Qeveria e vjetër e nxënësve do të luajë funksionin e një komiteti zgjedhor duke trajtuar në mënyrë specifike procedurën e zgjedhjeve duke qenë krejtësisht të pavarur. Por gjithsesi mësuesi koordinator duhet të jetë i gatshëm të këshillojë grupin e punës mbi procesin e zgjedhjeve.

2 Vendosja e procedurave të zgjedhjeve

Pasi të ketë vendosur procedurën e zgjedhjeve, grupi i punës duhet të marrë në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- sa përfaqësues do të zgjidhen nga çdo klasë
- çfare mund të bëhet për të siguruar një balancë raciale midis anëtarëve të qeverisë,
- nëse duhet të ketë numër të barabartë djemsh dhe vajzash pjesëmarrës në qeveri, dhe si do të arrihet një gjë e tillë,
- si do të shfaqen emrat e kandidatëve për çdo klasë në mënyrë që nxënësit të bëjnë zgjedhjen e tyre (psh një listë në dërrasë),
- kur do të mbahen zgjedhjet

Grupi i punës është gjithashtu përgjegjës për:

- si dhe kur do të numërohen votat,
- si dhe kur do të shpallen rezultatet,
- nëse do të përdoren forma standart votimi, apo fletë emë rore dhe si do të jetë skica e tyre (një shembull i fletëve të votimit është paraqitur në Shtojcën 2),
- kush do të jetë i pranishëm kur të numërohen votat,

Anëtarësim i balancuar:

Nuk do të ishte e përshtatshme të kishim një qeveri nxënësish e cila nuk reflekton grupet etnike midis nxënësve, apo që ka disbalancë të ndjeshme midis djemve dhe vajzave. Pasi njihen rezultatet përfundimtare, nëse qeveria nuk përfshin një balancë etnike, atëherë kjo mund të zgjidhet duke miratuar shtimin e anëtarëve të tjerë të cilët përfaqësojnë këto grupe etnike.

3 Përgatitje për të votuar

Me vendosjen e ditës së votimit, mësuesit kujdestarë duhet të flasin me nxënësit e tyre mbi mënyrën si ata duhet të vendosin për kë të votojnë. Ata duhet t'i pyesin nxënësit të përshkruajnë cilësitë që do të duhej të kishte një përfaqësues i denjë dhe i besueshëm. Nxënësit nuk duhen inkurajuar të votojnë për shokun e tyre më të ngushtë, por të mendojnë mbi cilësitë e kandidatëve. Mësuesit mund të flasin me nxënësit për domethënien e fjalëve të tilla si i drejtë, i besueshëm, asnjans, dëgjues, përfaqësim, etj. Mund të përdoret një diskutim në rreth, duke përdorur një fjalë e cila fillon me: "Unë do të doja që përfaqësuesi i klasës të ishte..."

- Nxënësit propozojnë një emër për të cilin mendojnë se është kandidati më i mirë,

- Çdo kandidat i propozuar duhet të mbështetet nga të tjerë,
- Kandidatët e propozuar duhet t'i tregojnë klasës arsyen përse duhet të zgjidhen dhe çfarë do të bëjnë ata për të siguruar se mendimet e gjithësecilit do të pasqyrohen drejtësisht,
- Kaloni nëpër procesin e votimit të rënë dakort më parë, pasi të siguroheni se të gjithë nxënësit janë të qartë se çfarë do të bëjnë, dhe si të mbajnë sekret fletën e votimit përpara futjes së saj në kutinë e votimit.
- Numërohen votat dhe shpallen rezultatet. Nxënësve u duhet treguar se cilët fëmijë

morën numrin më të madh të votave, duke u zgjedhur kështu të jenë anëtarë të qeverisë së nxënësve.

Menjëherë mbas trainimit të anëtarëve të zgjedhur, mbahet dhe takimi i parë i qeverisë.

4 Format

Kopje shembuj të formave në vazhdim jepen në Shtojcën 2:

- forma e emërimit
- fleta e votimit
- fleta e numërimit të votave
- fleta e rezultateve të zgjedhjes.



MATERIAL SHPËRNDARËS 3

Udhëzim hap pas hapi për krijimin e një qeverie nxënësish

1 Mbledhja e ideve

Qeveria e nxënësve duhet të vlerësohet dhe të mbështetet nga kushdo. Mësuesit, drejtuesit e shkollës, prindërit dhe nxënësit, të gjithë duhet të kuptojnë arsyet për pasjen e një qeverie nxënësish si dhe përfitimet për nxënësit dhe stafin. Ide mbi funksionimin e qeverisë së nxënësve duhet të mblidhen gjatë mbledhjes së drejtuesve, të stafit, diskutimeve në klasë e takimet me prindër. Identifikoni pritjet, qëllimet dhe rolin e qeverisë së nxënësve brenda shkollës dhe si mund të kontribuojë ajo në zhvillimin e planit shkollor (materiali për *Sesionin e mësuesve 10, Plan veprimi për qeverinë e nxënësve*, përfshin një shembull të një rregulloreje të qeverisë së nxënësve).

2 Përfshirja e nxënësve

Tregojuni nxënësve se mësuesit duan të dinë mendimin e tyre mbi çështje që kanë të bëjnë me nxënësit në jetën e tyre të përditshme në shkollë. Shpjegojuni se ka shumë pak mundësi për të folur për to. Prezantojini me idenë e qeverisë së nxënësve dhe tregojuni se shkolla po planifikon të ketë një të tillë.

3 Caktimi i një mësuesi koordinator

Zgjedhja e mësuesit koordinator është vendimtare për qeverinë e nxënësve. Mësuesi koordinator duhet të ketë një status në shkollë. Është jetësore për nxënësit të kenë besim te mësuesi koordinator dhe, nëse është e mundur, do të ishte ideale që nxënësit të lejohen të japin fjalën e tyre në këtë zgjedhje. Ky rol shpesh merret nga drejtuesi i departamentit.

4 Grupi i punës

Mësuesi koordinator duhet të krijojë një grup pune, i cili të përfshin nxënësit pjesëmarrës në qeverinë eemëprashme, të zgjedhur nga shokët e tyre, për të identifikuar çështjet e mëposhtme, të cilat më pak kërkojnë patjetër dhe vëmendjen e qeverisë së re të zgjedhur:

- role dhe pozicione të mundshme të qeverisë dhe përgjegjësitë e tyre,
- ku, dhe sa shpesh, do të mblidhet qeveria e nxënësve,
- cila do të jetë madhësia e qeverisë dhe a do të ketë nevojë për nëndarje,
- si të arrijmë një balancë të përshtatshme gjinie dhe raciale,
- si dhe kur do të zhvillohen zgjedhjet,
- nëse qeveria e nxënësve do të ketë një fond fillestar; nëse po sa duhet të jetë ai dhe si do të sigurohet,
- a do të merret qeveria e nxënësve me ngritje fondesh, dhe sa përputhet kjo me rregulloren,
- si do të përcaktohen kufinj të një pjesëmarrjeje të përshtatshme në çështjet e shkollës,
- si do të angazhohen në qeveri nxënësit e fillores.

5 Adaptimi i një rregulloreje

Këto vendime do të formojnë bazat e një rregulloreje të thjeshtë për qeverinë e nxënësve.

6 Promovimi i qeverisë së nxënësve

Koha për promovimin e qeverisë mund të vendoset sapo grupi i punës të ketë përfunduar me konsultimin e të gjithëve si dhe me adaptimin e rregullores.

7 Zgjedhjet

Zgjedhjet zhvillohen në çdo klasë në ditën e paracaktuar. Çdo klasë zgjedh një përfaqësues për në qeverinë e nxënësve; zakonisht 10 - 15 është një numër i përshtatshëm për të punuar.

Më të vegjlit flasin me mësuesit e tyre se si të marrin pjesë, mundësisht nëpërmjet ndonjë vizatimi për të vendosur mbi ndjekjen e takimeve të qeverisë me rradhë, apo nëse duan të kenë qeverinë e tyre në klasa fillore.

8 Takimi i parë i qeverisë

Në mbledhjen e parë diskutohet mbi rolin e qeverisë dhe përcaktohen funksionet. Mund të merren vendime finale mbi procedurat, si psh: ku do të mbahen procesverbalet, çfarë forme do të marrë programi apo dhe të sqarohen paqartësi midis nxënësve.

Anëtarët e qeverisë mund të sjellin çështje nga klasa e tyre në mbledhjen pasardhëse.

Qëllimet:

Të prezantojë konceptin e mbledhjes së klasës duke:

- shpjeguar si funksionon në klasë,
- dhënë udhëzime mbi organizimin e saj në mënyrë të sukseshme.

Rezultate:

- Mësuesit kujdestarë të gatshëm të zbatojnë funksionimin e mbledhjes së klasës.

Burime

- 1 Material Prezantues
- Materiali prezantues: Strukturat e qeverisë së nxënësve (marrë nga Sesioni 1, Prezantim me qeveritë e nxënësve)
- 1 material shpërndarës

Plani i sesionit

Mbledhja e klasës

1 Sjellja e fëmijëve

15 minuta

- Duke diskutuar vazhdimish mbi sjelljen, gjatë mbledhjes me klasën nxënësit përpigën të bëjnë më të mirën për arritjen e sjelljes më të mirë të mundshme.

Në grup prej tre

- Përfytyroni dy shprehje ideale të cilat reflektojnë sjelljen e fëmijëve. Psh: do të ishte ideale që fëmijët të thonë *'unë doja të luaja vetëm me Andn, por ne e ftuam edhe Jonin të bashkobej me ne, pasi ai ishte vetëm'*

I gjithë grupi

- Shkruani disa prej shprehjeve ideale në tabakë letre dhe diskutoni mbi to.

2 Koncepti i mbledhjes së klasës

10 minuta

Material Prezantues

struktura e qeverisë së nxënësve

- Gjatë mbledhjes me klasën, mund të prezantohen ide dhe të shprehen opinione të cilat përçohen në qeverinë e nxënësve nëpërmjet senatorëve. Mbledhja mund të zhvillohet si një forum në të cilin diskutohen çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me klasën por edhe me shkollën.
- Një mënyrë për organizimin e mbledhjes me klasën është bashkëbisedimi në formë rrethi.

3 Krijimi i këshillit të klasës

20 minuta

Material Prezantues 1

Mbledhje me klasën: çfarë, përse, si, kur?

Në grup prej tre apo katër

- Konsideroni pyetjet e mëposhtme duke iu

referuar materialit prezantues si dhe materialit shpërndarës:

- Cila është mënyra më e mirë për të organizuar ambientin për një mbledhje klase?
- Çfarë marrëveshjesh duhen përdorur në mbledhje, psh kur do të bësh propozime, kur kërkon të flasësh, etj?

4 Programi i një mbledhjeje klase

20 minuta

I gjithë grupi

- Sugjeroni mbi gjërat që fëmijët mund të vendosin në programin e një mbledhjeje dhe shkruajini disa prej tyre në tabakë letre.

Në grupe prej tre ose katër

- Diskutoni se si mund të hartojë senatori i klasës një program me prioritetet e mësipërme, në konsultim me mësuesin kujdestar.

I gjithë grupi

- Një ose dy persona lexojnë me zë të lartë programet e tyre,
- Diskutoni cilat çështje mund të trajtohen në nivel klase dhe cilat mund të kenë nevojë të referohen nëpërmjet përfaqësuesve në mbledhjen e qeverisë së nxënësve.

5 Drejtimi i mbledhjes së klasës

10 minuta

Në çift

- Diskutoni mënyrën më të mirë për të ndihmuar klasat tuaja për të drejtuar mbledhjet.

6 Konkluzione

15 minuta

I gjithë grupi

- Diskutoni mbi influencën pozitive të këtij procesi në sjelljen e fëmijëve në klasë.

Material prezantimi 1

Mbledhje me klasën: çfarë, përse, si, kur?

Çfarë duhet të kuptojmë me mbledhje klase?

- Një forum gjithëpërfshirës, i strukturuar për diskutime dhe vendimmarrje
- Një mjet për fëmijët për të prezantuar çështje dhe shqetësime
- Një mjet për qeverinë e nxënësve për të konsultuar të gjithë nxënësit.

Përse të organizojmë mbledhje me klasën?

- për të ndihmuar fëmijët të zhvillojnë qëndrime përgjegjëse dhe sjellje më të mirë,
- të krijojë një ndjenjë përkatësie, të inkurajojë dëgjimin ndaj të tjerëve dhe të zhvillojë vetë besimin,
- të përmirësojnë marrëdhëniet midis mësuesve dhe nxënësve.

Si funksionojnë mbledhjet me klasën?

- nxënësit udhëheqin mbledhjet,
- klasa bie dakort mbi pamjen e dhomës,
- përdoren procedura të përbashkëta
- senatorët e klasave i transmetojnë çështjet në mbledhjen e qeverisë së nxënësve

Kur zhvillohen mbledhjet e klasës?

- çdo javë, për rreth 20 – 30 minuta gjatë kohës së shkollës

MATERIAL SHPËRNDARËS

Mbledhje me klasën

Të gjithë nxënësit duhet të përfshihen aktivisht në qeverinë e nxënësve nëse ata duhet të pajisen me njohuri dhe aftësi sikurse parashikohen në dispozitat normative apo kurrikulën shkollore. Kjo mund të arrihet më së miri nëpërmjet mbledhjeve me klasën.

1 Çfarë është një mbledhje klase?

- Një mbledhje klase është një forum i strukturuar për diskutime dhe vendimmarrje në të cilin mund të marrin pjesë të gjithë nxënësit.
- Është një mjet për fëmijët ku mund të flasin mbi çështje dhe shqetësime të jetës së tyre të përditshme shkollore,
- Shumë shpejt bëhet një eksperiencë pozitive për nxënësit, duke i aftësuar ata të gjejnë vetë zgjidhje për vështirësitë e përditshme, shpesh nëpërmjet konsensusit,
- U jep të gjithë nxënësve të shkollës një mundësi të përhershme për të ngritur çështje në qeverinë e nxënësve si dhe për t'u konsultuar nga qeveria e nxënësve.

2 Përse të organizojmë mbledhje klase?

- Nxënësit ndërgjegjësohen mbi nevojën për patur qëndrime të përgjegjshme ndaj çështjeve që afektojnë këdo. Nxënësit mësojnë të degjojnë mendimin e njëri-tjetrit si dhe ndihmojnë ata që kanë vështirësi të veçanta. Eksperienca i ndihmon ata të zhvillojnë vetë besimin.
- Procesi ndihmon për të përmirësuar sjelljen në klasë dhe në shkollë, pasi mundëson nxënësit me sjellje pozitive, të cilët në përgjithësi përbëjnë shumicën, të influencojnë qëndrimet e gjithë të tjerëve.

- Është një ndihmë në krijimin e një përvoje pjesëmarrjeje në proceset vendimmarrëse demokratike.
- Nxënësit përgatiten të bëhen anëtarë të dobishëm të qeverisë së nxënësve.
- Me formimin e tyre si të rritur të pavarur, nxënësit do të kenë fituar aftësi dhe njohuri në arsyetimin pro dhe kundra një argumenti, procedurat e negociatave si dhe vetë shprehjes së mendimeve.
- Rritet ndjenja e përkatësisë në një komunitet i cili kujdeset për nxënësit.
- Mbledhja me klasën përmirëson marrëdhëniet mësues – nxënës.

3 Si funksionon mbledhja me klasën?

- Nxënësit i drejtojnë vetë mbledhjet e klasës, të kryesuar zakonisht nga senatori i klasës. Është e nevojshme që senatorët të trainohen mbi mënyrën e drejtimit të një diskutimi. Nxënësit e ciklit fillor do të kenë më shumë nevojë për mbështetje në drejtimin e mbledhjeve, por pa dyshim edhe për ta është e nevojshme një kohë e caktuar ku të diskutojnë çështje të cilat i konsiderojnë të rëndësishme.
- Klasa vendos mbi mënyrën e organizimit të dhomës gjatë mbledhjeve. Mundësitë përfshijnë alternativat e mëposhtme:
 - Të ulur në rreth
 - Bashkimi i të gjitha tavolinave në mënyrë që nxënësit bashkë me mësuesin të ulen rreth tyre
- Klasa bie dakort mbi mënyrën e kërkimit të lejes për të folur, psh. duke ngritur dorën.
- Përpara çdo takimi, anëtarët e klasës shënojnë në një fletë të ngjitur në mur, të gjitha çështjet

që do të donin të diskutonin. Senatori, me mbështetjen e mësuesit kujdestar, e përdorin këtë si bazë për hartimin e programit të mbledhjes.

- Senatori punon me program, duke drejtuar diskutimin mbi çdo pikë të tij.
- Dikush që vullnetarizon, shënon çdo vendim të marrë nga klasa, apo edhe ndonjë gjë që ka nevojë për ndjekje të mëtejshme. Idealisht sekretar duhet të jetë një nxënës i klasës, por për nxënësit më të vegjël këtë mund ta bëjë mësuesi kujdestar.
- Gjatë mbledhjes identifikohen çështje dhe probleme të klasës, të cilat duhen përcjellë në mbledhjet e qeverisë së nxënësve, prandaj duhet dikush të mbajë shënim të gjitha këto çështje.
- Senatori duhet ta mbarojë mbledhje në kohë, dhe ndonjë punë e pambaruar duhet të jetë në krye të programit për mbledhjen e ardhshme.

4 Kur duhen organizuar mbledhjet e klasës?

Çdo javë duhen shpenzuar rreth 20 – 30 minuta nga koha e shkollës për të organizuar mbledhjen e këshillit të klasës. Për këtë mund të përdoret koha e diskutime jashtëshkollore sikurse para-shikohet në dispozita normative, por gjithashtu edhe orët e kujdestarisë. Orari i mbledhjeve të klasës duhet të jetë i koordinuar me atë të mbledhjes së qeverisë së nxënësve.

Disa prej shqetësimeve mund të jenë shumë urgjente për nxënësit, prandaj është e rëndësishme që ata të dinë kur do të jenë në gjendje të ngrenë zërin e tyre. Nëse një sistem i tillë funksionon, nxënësit e dinë kur do të organizohet mbledhja e klasës së tyre. Nuk është e përshtatshme dhe nuk e ndihmon harmoninë në klasë, t'i lësh nxënësit të presin me shqetësimet e tyre për më shumë se një javë.

Qëllimet:

Të prezantojë konceptin e rrethit duke:

- demonstruar mënyrën e përdorimit për t'i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë aftësitë e të dëgjuarit
- demonstruar mënyrën e përdorimit për të rritur vetëvlerësimin të fëmijët
- përfshirë këdo në një varietet aktivitetesh të rrethit.

Rezultate:

Çdokush të ketë fituar përvojë mbi bashkëbisedimin në rreth në mënyrë që:

- të mund të vlerësojnë potencialin vetiak në zhvillimin e aftësive dëgjuese dhe rritjes së vetë vlerësimit
- të mund të bien dakord nëse ky lloj bashkëbisedimi mund të adaptohet si inisiativë e mbarë shkollës,
- disa mësues të vendosin nëse do të donin ta përdornin atë në klasën e tyre.

Burime

- Material prezantues¹
- Material Prezantues, Struktura e qeverisë së nxënësve (materiali prezantues 1 nga sesiioni i mësuesit 1, Prezantim me qnx)
- 3 materiale shpërndarëse
- Një kuti e vogël, që ka brenda një pasqyrë
- Një objekt natyror të këndshëm si psh një gur apo guackë

Sikurse është përmendur dhe në sesionin paraardhës, bashkëbisedimi në rreth është një nga mënyrat mjaft efikase të zhvillimit të një mbledhje klase, apo edhe të çfarëdolloj aktiviteti tjetër jashtëshkollor si tryeza debati, takime, etj

1 Filozofia e rrethit

20 minuta

I gjithë grupi

Materiali prezantues:

Struktura e qnx

- Rishikoni rolin që mund të luajë ideja e rrethit në programin e shkollës si dhe rendësinë në zhvillimin e një qëndrimi shkollor pro qeverisë së nxënësve
- Flisni mbi atë çka njihet mbi bashkëbisedimin në rrethit, nëse është përdorur më pare nga dikush, dhe sa përfitohet prej tij.

Materiali prezantues

të bashkëbisedojmë në rreth: çfarë, përse, si, kur?

- Referojuni materialit, duke diskutuar çështjet me rradhë.

2 Të marrësh pjesë në bisedat në rreth

25 minuta

- Kjo sekuencë ofron mundësinë të marrësh pjesë në aktivitete të ndryshme në rreth. Kjo nuk u jep pjesëmarrësve vetëm një ide të mire mbi mënyrën se si ndihen nxënësit – ajo tregon se zakonisht përfitojnë edhe të rriturit!
- Rrethi është një vend i sigurt ku askush nuk kritikohet apo përqeshet.
- Qarkulloni një objekt tërheqës përgjatë rrethit në një drejtim (mundësisht diçka natyrore si

gur apo guackë, ndonëse për nxënës më të vegjël përdoret një lodër e butë).

- Personi që mban objektin flet dhe gjithë të tjerët dëgjojnë. Në rast se kur kanë radhën nuk u vjen asgjë në mendje, mund ta kalojnë objektin te personi pasardhës. Gjithashtu mund të përsërisin dhe diçka që dikush tjetër e ka përmendur më parë.

- Filloni aktivitetin duke plotësuar fjali të thjeshta. Inkurajoni pjesëmarrësit të bëjnë deklarata domethënëse për veten e tyre – pa pretenduar të jenë fëmijë. Psh:

Unë ndihem I lumtur kur...

Kur jam me shokë më pëlqen të...

Kur të largohem nga kjo shkollë do dua të mbahem mend si...

- Lexoni një fjali të tërë. Psh: *Në shtëpi di të dëgjoj me kujdes atë çka më tregojnë të tjerët për ndodhitë e ditës së tyre.*
- Llojet e fjalive të zgjedhura për nxënësit variojnë në bazë të moshës së tyre. Çdonjëra prej fjalive mund të përdoret për të rriturit. Mësues të klasave të ndryshme mund të sugjerojnë fjali që mund t'i përdorin me nxënësit e tyre, dhe të gjithë të tjerët mund t'i provojnë në klasat e tyre. Psh: *Lodra ime e preferuar është...*

3 Reflektoni mbi përvojën e bisedave në rreth

10 minuta

Në çift

- Diskutoni si u ndjetë

I gjithë grupi

- Reflektoni nëse dhënia e mundësisë për të folur dhe për t'u dëgjuar në këtë mënyrë ndikon në të vetëndierin personal.

- Mendoni nëse dëgjimi i ndjenjave dhe eksperiencave të të tjerëve mund të zhvillojë një sens më të madh kuptimi midis njëri – tjetrit.

4 Më shumë aktivitete të kohës së rrethit

20 minuta

- Zgjidhni aktivitete nga materiali shpërndarës 2, *Veprimtari për kohën e rrethit*. Normalisht vetëm një nga këto veprimtari duhet zhvilluar në një bisedim në rreth.
- Sigurohuni se ka kohë të diskutoni për

aktivitetet qoftë në fund të sesionit, qoftë edhe midis çdo aktiviteti.

5 Si do ta përdorni konceptin e rrethit?

15 minuta

I gjithë grupi

Diskutoni:

- si mund të bëhet koncepti i bisedimit në rrethit një pjesë integrale e praktikës shkollore
- nëse është një strukturë e dobishme për t'u adaptuar për mbledhjet e klasave.

Material prezantimi 1

Të bashkëbisedojmë në rreth: çfarë, përse, si, kur?

Çfarë është biseda në rreth?

- Një mjedis i sigurt ku njerëzit mund të shprehin ndjenjat e tyre, të mësojnë të flasin e të dëgjojnë nëpërmjet shqetësimeve të tyre.
- Bazuar në një rreth pasi nuk ka hierarki.

Cilat janë rregullat e bisedës në rreth?

- vetëm një person flet kur e ka radhën
- të gjithë dëgjojnë kur flet një person
- nuk ka fyerje apo gjykime

Përse shkollat duhet të përdorin me nxënësit bashkëbisedimin në rreth?

- u mëson nxënësve të dëgjojnë me vëmendje
- mësojnë si shprehin ndjenjat e tyre në mënyrën e duhur
- mësojnë si të zgjidhin konfliktet nëpërmjet negocimit
- i ndihmon ata të zhvillojnë një sens të brendshëm vetë vlerësimi duke u afirmuar dhe u dëgjuar.
- Vetë vlerësimi pozitiv i motivon nxënësit për të mësuar

Si është organizuar bashkëbisedimi në rreth?

- fëmijët ulen në një rreth në dyshe apo në karrike ku të gjithë mund ta shohin njëri – tjetrin
- një objek kalohet përqark rrethit për të treguar se kush e ka radhën për të folur
- mund të ndodhë të pasosh apo të përsërisësh atë që është thënë më parë

Kur ndodh biseda në rreth?

- çdo javë në kohën caktuar mbledhjes së klasës apo bisedave të lira

MATERIAL SHPËRNDARËS 1

Bashkëbisedimi në rreth

1 Çfarë është koncepti i rrethit?

Rrethi është një vend i sigurtë ku njerëzit mund të mësojnë të shprehin ndjenjat e tyre, të zhvillojnë aftësinë e të dëgjuarit dhe të diskutojnë shqetësime. Forma e rrethit është e rëndësishme pasi në të nuk ka një pozicion hierarkik. Ndonëse fillimisht ky format u përdor në programe trainimi për të rritur, është zhvilluar gjerësisht në edukimin e fëmijëve dhe mund t'u prezantohet nxënësve në fillimin e viteve të para të shkollës.

2 Përse të përdorim konceptin e rrethit?

Nxënësit kanë nevojë të mësojnë se si t'i shprehin ndjenjat e tyre në mënyrën e duhur, si të dëgjojnë me vëmendje dhe si të negociojnë e të zgjidhin konfliktet. Bashkëbisedimi në rreth u jep atyre mundësinë për të zhvilluar këto aftësi sociale, duke u bërë më të ndërgjegjshëm për veten e tyre në marrëdhënie me të tjerët dhe çfarë nënkupton të jesh pjesë e një komuniteti.

Nxënësit gjithashtu kanë nevojë të rrisin vetë-vlerësimin – një sens të brendshëm të vetë vlerësimit – që nuk është domosdoshmërisht e njëjta gjë me vetë pranimin apo vetë besimin. Nxënësit me vetë vlerësim do t'i përkushtohen mësimi më lehtë. Ata do të ndjejnë se me rritjen e tyre kanë diçka me vlerë për të kontribuar në shoqëri dhe do të zhvillojnë një qëndrim pozitiv ndaj qytetarisë.

Bisedat në rreth bëjnë të mundur që t'u kushohet një vëmendje dhe përkujdesje e veçantë nxënësve më të turpshëm apo atyre më pak të mundur, të cilët kanë pak kërkesa ndaj mësuesit kujdestar e

madje mund ta kalojnë gjithë ditën pa rënë në sy.

3 Cilat janë rregullat e bashkëbisedimit në rreth?

Ka tre rregulla bazë:

1. vetëm një person flet kur e ka radhën,
2. të gjithë dëgjojnë kur flet një person,
3. nuk ka fyerje apo gjykime

4 Si është organizuar bashkëbisedimi në rreth?

Rrethi duhet të jetë i sigurtë dhe aspak kërcënues. Nxënësit ulen në formë rrethore ku të gjithë mund ta shohin njëri – tjetrin. Nxënësit më të vegjël duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme në dysheme ku mund të ulen në tapet, më të rriturit mund të preferojnë të lëvizin bankat në mënyrë që të gjithë të ulen nëpër karrike në formë rrethi. Duke kaluar një gur, ose një objekt të ngjashëm natyror, përqark rrethit i ndihmon të tërë të ndjekin dy rregullat e para të rrethit. Nëse dikush mendon se nuk ka gjë për të thënë, guri mund t'i kalohet personit ngjitur dhe nuk ka asgjë të keqe nëse përsëritet ajo çka dikush tjetër ka thënë më parë.

Mënyrën se si prezantohet rrethi e përcakton mosha e nxënësve. Nxënësve më të vegjël mund t'u prezantohet 'rrethi special' ose 'guri magjik', më të mëdhenjëve mund t'u thuhet se rrethi përdoret nga të rriturit si një metodë profesionale trainimi.

5 Kur duhet të përdoret biseda në rreth?

Bashkëbisedimi në rreth duhet planifikuar të paktën një herë në javë në shkollë gjatë mbledhjes së klasës.

MATERIAL SHPËRNDARËS 2

Veprimtari për bashkëbisedim në rreth*

1 Personi special

- Kaloni përqark një kuti me kapak e brenda së cilës ndodhet një pasqyrë të vogël.
- Përpara se të filloni, tregojini të gjithëve se kutia përmban imazhin e një “personi shumë të veçantë”.
- Tregojuni atyre se ata nuk duhet të tregojnë se kush është deri sa ta ketë parë gjithësecili.

Vazhdimi

- secili bën një vizatim të fytyrës së vet në qendër të një cope letre dhe përqark saj në rrethë të vegjël shkruan mbi aspekte të ndryshme të vetvetes. Psh: *E preferuara ime...*, *Unë mund të...*, *Unë jam si...*, *Njerëzit e mi më të dashur...*, etj. **SHOQERO ME SKICE**

2 Dhuratë e veçantë

- Kaloni objektin përqark rrethit dhe kërkonin që çdo person ta ‘shndërrojë’ atë në një ‘dhuratë të veçantë’ për personin e ulur ngjitur.
- Inkurajoni fëmijët të mendojnë për gjërat që dinë mbi atë person dhe të mendojnë diçka që i pëlqen.

Vazhdimi

- Vizatoni të dyja dhuratat, atë që japin dhe atë që marrin.
- Shkruani se si u ndjenë kur morën dhuratën dhe përse mendojnë se e morën atë dhuratë. Gjithashtu përse ia bënë atë dhuratë të veçantë personit ngjitur.

3 Ajo që më pëlqen

- Kaloni me radhë përqark rrethit për të plotësuar fjali të ndryshme duke e nisur me: *Ajo që më pëlqen për...* Psh *Ajo që më pëlqen për*

shkollën është..., Ajo që më pëlqen kur jam me shokë është..., Ajo që më pëlqen në shtëpi është...

Vazhdimi

- Shkrim dhe vizatim pasi i ndihmon nxënësit të reflektojnë për gjërat e mira të jetës së tyre të përditshme.

4 Ajo që ndiej

- Kaloni me radhë përqark rrethit për të plotësuar fjali të ndryshme duke e nisur me: *Unë ndiej ... kur...* Për shembull: *Unë ndiej ... kur shoh dikë që lëndohet, Unë ndiej... kur dikush më kërkon të luaj në kopësht.*

Vazhdimi

- Ndërkohë që nxënësit mësohen të punojnë në këtë mënyrë, ata mund të inkurajohen të merren me çështje që lindin nga ndjenjat e forta, si të ndjerit të dhunshëm apo të inatosur, dhe kjo mund të çojë në punë konkrete ndaj çështjeve si fyerjet, sharjet.

5 Nëse do të isha

- Kaloni përqark një objekt të përshtatshëm dhe kërkojini çdo nxënësi të përfundojë fjalinë: *Do të doja të isha (zog, kafshë apo lule) sepse...*

Vazhdimi

- Vizatoni gjallesën që ata kanë zgjedhur dhe shkruani se si ndihen po të jenë të tillë. Kjo u krijon nxënësve një mundësi për të shprehur ndjenjat që ata nuk do donin t'i njihnin hapur si të tyret.
- Mësuesi duhet të pranojë çfarëdo që të ketë shkruar nxënësi pa e interpretuar atë.

6 Kohë speciale

Kjo veprimtari duhet të prezantohet pasi nxënësit të jenë familjarizuar me konceptin e rrethit dhe të kenë kuptuar rregullat bazë.

- Përpara se të filloni, flisni mbi mundësitë për të menduar e thënë diçka të mirë për një njeri edhe pse ai nuk është shoku më i mirë. Mund të jetë për punën e tyre, për flokët, etj, apo për mirësinë e cilësi të tjera personale.
- Dikush ulet në qendër të rrethit (zakonisht vendoset duke zgjedhur një emër rastësisht nga një kuti).
- Secili person nga rrethi me radhë thotë diçka pohuese ndaj personit në mes, i cili nuk lejohet të përgjigjet verbalisht.
- Mësuesi duhet të shkruajë gjithçka thuhet, në mënyrë që t'i jepet nxënësit në qendër si një kujtim i mirë i gjërave që janë thënë për të nga shokët.
- Në plotësim të këtij sesi, nxënësit mund të kenë mundësinë të prekin “personin special” në mënyrë miratuese, psh duke shtrënguar duart, duke i hedhur krahun në qafë, një ledhatim në kokë etj.
- Duke e bërë këtë në grupe prej tre apo katër

mundëson ata që nuk duan të jenë pjesë të qëndrojnë në vendin e tyre në rreth pa e tërhequr vëmendjen mbi veten e tyre. Sigurisht është thelbësore të pyesim personin special nëse i pëlqen të preket nga shokët. Shumica e nxënësve kënaqen me këtë veprimtari. U jep atyre përvojën e marrjes së një kontakti fizik pozitiv nga shokët e tyre, kur shpesh ndodh që të marrin kontakte negative duke u shtyrë, qëlluar etj. Gjithsesi, mësuesit që nuk ndihen rehat me këtë ide, mund të mos e provojnë.

Vazhdimi

Shumë mundësi, përfshirë:

- Nxënësve u kërkohet të reflektojnë mbi ato gjëra që i bëjnë të lumtur kur kryhen nga të tjerët, si dhe gjërat që i turpërojnë apo i vënë në siklet.
- Bëni një vizatim mbi një incident për të ilustruar: *Një herë kur u ndjeva vërtet keq me veten time* dhe *Një herë kur u ndjeva vërtetë mirë për veten time*
- Shkruani mbi gjërat që mund të bëjnë ata për t'i bërë të tjerët të ndihen të lumtur.

*Në Shtojcën 3 janë paraqitur veprimtari të tjera të këshillueshme për t'u përdorur nga mësuesit gjatë punës me nxënësit

MATERIAL SHPËRNDARËS 3

Lojra dhe ushtrime në rreth

Këto lojra dhe ushtrime mund të përdoren në fillim të mbledhjeve apo seancave të trainimit për të stimuluar mendimin në një temë të caktuar, për të zhvilluar një atmosferë të veçantë apo për të prezantuar një koncept.

Gjithmonë përfundojini lojrat kur ato janë duke shkuar mirë, në vend që të luani derisa lojtarët të mërziten.

1 Lojra aktive në rreth

Xhonglim me emra

(Për qef, përqëndrim dhe koordinim)

- Të gjithë qëndrojnë në rreth
- Drejtuesi fillon duke thirrur emrin e dikujt dhe i hedh topin personit të thirrur.
- Personi që kap topin, thërret një emër të dytë dhe e pason topin.
- Kjo vazhdon derisa të gjithë të pranishmit në rreth e kanë pritur një herë topin. Çdokush duhet ta mbajë mend kush ua hodhi topin dhe kujt ia hodhën topin.
- Kur topi arrin aty ku u nis, rifillohet duke u thirrur i pari i njëjti emër si në raundin e parë.
- Gradualisht drejtuesi fut më shumë topa në rreth, në mënyrë të tillë që ka shumë hedhje dhe pritje në të njëjtën kohë.
- Loja përfundon kur të gjithë topat janë në dyshe.
- Është shumë qejf kur gjatë lojës të gjithë këndojnë një këngë.

Materialet e nevojshme: Sa më shumë topa tenisi (apo të ngjashëm) që të kemi.

Të bëhemi lëmsh

- Të gjithë qëndrojnë në rreth
- Afrohen në mes dhe kapin duart e njëri-tjetrit

(jo të personit që kanë ngjitur) duke krijuar kështu një lëmsh të madh.

- Më pas grupi duhet të çlirohet nëpërmjet rrotullimeve, futjeve nga poshtë, kapërcimeve apo mënyrave të tjera, por pa i shkëputur duart nga njëri – tjetri. Në fund duhet të krijohet një rreth i bashkuar.

2 Lojra të ulur në rreth

Prezantoni partnerin tuaj

(për të zhvilluar aftësi kujtese dhe dëgjimi)

- Të gjithë ndahen në çifte, dhe i tregojnë partnerit për veten e tyre.
- Pas një kohe të caktuar, personi në çift që ka dëgjuar i tregon grupit gjithçka mban mend mbi partnerin e vet.

Prezantimi i një fotografie

(mund të provokojë mendim)

- Secili zgjedh një figurë që i pëlqen nga ndonjë revistë.
- Më pas pyetini të gjithë përse zgjodhën atë figurë

Materialet e nevojshme: Figura të ndryshme revistash.

3 Lojra bashkëpunuese

Loja e çelësit

(për përqëndrim dhe bashkëpunim)

- Të ulur në rreth lojtarët krijojnë një histori mbi një thesar – çfarë thesari është, ku ndodhet, kush e ruan – për shembull pirati dhe xhevahiret e tij.
- Më pas lojtarët sugjerojnë disa “pengesa” që mund të vendosen brenda rrethit, psh, karrike të kthyera mbrapsht, copa gazeatsh të bëra shuk, etj.

- Një karrike vendoset në mes të rrethit për rojen dhe thesari (një tufë çelësash) nën karrike.
- Zgjidhet roja, i mbyllet sytë me një shami, dhe ulet në karrike.
- Zgjidhet një kërkues thesari i cili duhet të kapërcejë pengesat për të tërhequr thesarin dhe të kthehet në karriken e vet pa u kapur.
- Pjesa tjetër e grupit duhet të qëndrojë e heshtur.
- Nëse roja dëgjon ndonjë gjë, ai duhet të tregojë me gisht andej nga vjen zhurma dhe të thotë “Ndal”. Nëse gishti është në drejtim të kërkuesit atëherë ai ngrin, dhe duhet të kthehet në vendin e vet.

Materialet e nevojshme: një tufë çelësash, një shami dhe objekte të zakonshme.

Rrathë bashkëqëndrorë

- Lojtarët ulen në dy rrathë bashkëqëndrorë, në rrethin e brendshëm me fytyrë nga jashtë, dhe në rrethin e jashtëm me fytyrë nga brenda.
- Çdo person duhet të ketë dikë nga rrethi tjetër si partner.
- Vendosni një temë dhe lini një kohë të caktuar për diskutim.
- Kërkojini njërit prej rretheve të zhvendoset me një numër rastësor vendesh në një drejtim, në mënyrë që tashmë të kenë përballë një person tjetër.
- Vendosni një temë të re, ose mbani të njëjtën nëse ju duket e përshtatshme.
- Diskutimi më pas mund të ndahet me gjithë grupin.

4 Lojra afirmuese reflektuese ose individuale.

A mund të jem ti?

(Për të zhvilluar ndjeshmërinë, komunikimin dhe lojën me role)

- Loja luhet në rreth
- Drejtuesi identifikon një ndjenjë të

përshtatshme për zbulim, psh shqetësim.

- Fëmijët shkruajnë një fjali që fillon me *Unë jam i shqetësuar që...*
- Shkrimet vendosen në një kuti në qendër.
- Fëmijët me radhë tërheqin një letër nga kutia, e lexojnë me zë të lartë dhe e zgjerojnë fjalinë sikur ta kishin shkruar ata vetë.

Materialet e nevojshme: Stilolapsa dhe letër.

Një dëshirë për ty

(Ndihmon një fëmijë me marrëdhënie të varfra të fillojë të ndihmojë për dëshirat dhe nevojat e të tjerëve)

- Fëmijët çiftohen me dikë që nuk është shoku i tyre i ngushtë.
- Ata vizatojnë ose shkruajnë një dëshirë për këtë person, duke menduar për diçka që e duan me të vërtetë, që mund të moj jetë diçka materiale; psh: Do doja të isha mbretëreshë për një ditë.
- Më pas këto lexohen, shkëmbehen dhe diskutohen.

Materialet e nevojshme: Stilolapsa dhe letër.

Karrikja e nxehtë

(Nxënësit shpesh nxjerrin gjëra që e ndihmojnë mësuesin të zbulojë nëse ata kanë ndonjë problem)

- Vendosini nxënësit në rreth dhe jepuni të mbajnë diçka speciale, si psh një kristal magjik.
- Me rradhë kërkojini secilit prej tyre të përfundojë fjalinë: Aje që më pëlqen për veten time është..
- Në raundin e dytë mund të pyetën për atë që nuk u pëlqen.

Materialet e nevojshme: Diçka speciale për të mbajtur.

Qëllimet:

Të diskutojë njohuritë dhe aftësitë për të cilat kanë nevojë nxënësit për të marrë pjesë në qeverinë e nxënësve në mënyrë që pjesëmarrësit të :

- kuptojnë arsyet për trainimin e nxënësve,
- të dijnë për çfarë trainimi kanë nevojë nxënësit në mënyrë që të drejtojnë në mënyrë të sukseshme mbledhjen e klasës dhe qeverinë e nxënësve

Rezultate:

Të përgatitemi për të trajnuar nxënësit duke:

- qartësuar si mund të përdorin mësuesit programin e trainimit të nxënësve në klasën e tyre,
- vendosur kur dhe si do të zhvillohet trainimi

Burime

- 1 material prezantues
- 1 material shpërndarës
- Libri “E gjetëm zgjidhjen... është qeveria e nxënësve”

1 Fëmijët si partnerë*10 minuta*

- Qeveritë e nxënësve ekzistojnë që fëmijët të jenë partnerë në vetë edukimin e tyre dhe të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje

Në çift

- Hidhni ide mbi njohuritë dhe aftësitë që u duhen fëmijëve për të drejtuar qeverinë e nxënësve dhe shkuajini në tabakë letre.

I gjithë grupi:

- Vështroni të gjithë tabakët e letrës dhe krahasoni me materialin prezantues

Materiali prezantues*Njohuritë dhe aftësitë për të cilat kanë nevojë fëmijët***2 Prezantim me materialet e trainimit të nxënësve***15 minuta*

- Materialet për trainimin e nxënësve gjenden në librin: “e gjetëm zgjidhjen ... është qeveria e nxënësve”.
- Të gjithë nxënësit e ciklit të lartë do të përfshihen në krijimin e një qeverie dhe do të kenë nevojë të praktikojnë drejtimin e një diskutimi klase.
- Trainimi mbi kapitujt 1 – 5 mbulon:
 - Çfarë është një qeveri nxënësish dhe përse e duam ne një të tillë?
 - Zgjedhjet demokratike dhe përfaqësuesit e klasave,
 - Përfitimet nga qeveria e nxënësve

3 Trainim i anëtarëve të zgjedhur të qeverisë së nxënësve*10 minuta*

- Nxënësit që janë zgjedhur të përfaqësojnë klasën e tyre si anëtarë të qeverisë duhet të dinë si të drejtojnë efektivisht një qeveri nxënësish, kush e udhëheq atë, dhe si të krijojnë programe e të mbajnë shënime. Për këtë mund të mbështetemi në kapitujt:
 - Kush do të doje të ishte?
 - Edhe ne bëjmë takime
 - Muri i mundësive dhe Lule mos më Prek

4 Të dëgjuarit, aftësitë negociuese dhe afirmimi i të tjerëve*10 minuta*

- Aftësitë komunikuese dhe ndërmjetësuese përfshihen në kapitullin 5 “Edhe ne bëjmë takime”, por mësuesi mund të zgjedhë t'i trajtojë keto pika në një sesion të veçantë.
- Përsa i përket afirmimit të të tjerëve na vjen në ndihmë kapitulli 7 “Si të përfshijmë të tjerët”.

5 Strukturimi i diskutimeve**Materiali prezantues:*****Një plan diskutimi***

- Duke e përdorur materialin prezantues si një udhëzues, kërkoni një vullnetar për të drejtuar një diskutim të shkurtër mbi materialet e trainimit të nxënësve, duke cuar grupin drejt vendimit se kur dhe si do të zhvillohet trainimi.

- Në hartimin e propozimeve duhen marrë në konsideratë pikat e mëposhtme:
 - A do të përfitojnë nga trainimi të gjithë nxënësit e ciklit të lartë?
 - A do t'u jepet trainimi vetëm nxënësve të zgjedhur në qeveri?
 - Kudh do ta japë trainimin?
 - Çfarë kohe nga programi arsimor i duhet kushtuar trainimit?
- Nëse arrihet në një propozim, shënojeni në tabak letre.
- Vlerësoni sa mire u drejtua diskutimi me komente konstruktive mbi pikat e mëposhtme:
 - Çfarë bëri mire ky person në rolin e tij si drejtues?
 - Çfarë mund të kishte bërë më mirë apo ndryshe?
 - Çfarë arriti diskutimi?
 - A ishte i dobishëm dhe praktik?



Material prezantimi 1

Si funksionon shkolla:

- struktura e sistemit arsimor
- kush e menaxhon shkollën tonë

Si funksionon qeveria e nxënësve:

- çfarë është një qeveri nxënësish dhe përse e duam ne një të tillë
- çfarë kuptojmë me terma si “negocim” dhe “autoritet”

Aftësitë komunikuese:

- të paturit besim te vetja për të shprehur ide, marrë vendime dhe përtë folur në mbledhje

Aftësi drejtuese:

- të drejtosh mbledhje, të udhëheqësh një diskutim
- të mësosh të shkruash programe dhe të mbash shënime

Si të drejtosh një organizatë:

- të raportosh mbrapsht në mbledhjet e klasës dhe të shkruash raporte
- t'i tregosh të gjithëve në shkollë për qeverinë dhe çfarë po bën ajo
- krijimi i grupeve të interesit dhe ftimi i të tjerëve për t'u bashkuar
- sigurimi se të gjithë anëtarët e qeverisë së nxënësve marrin pjesë aktive në aktivitete.

MATERIAL SHPËRNDARËS

Programi i trainimit për nxënësit

Programi i trainimit të nxënësve është menduar si një skemë pune e cila mbulon edukimin personal, social, dhe qytetar për të gjitha klasat e ciklit të lartë të shkollës 9 vjecare, duke përdorur orë të kujdestarisë apo dhe orë të caktuara për veprimtari ekstrakurrikulare.

Të gjithë mësuesit duhet të nisin duke u folur nxënësve të tyre mbi idenë e të paturit një qeveri nxënësish dhe përse mendojnë ata se është e rëndësishme.

4 Struktura e programit të trainimit

Formati i sesioneve më të shumta bazohet në strukturën e një ore:

- prezantim për 15 minuta
- aktivitete për të gjithë klasën, ndarje në grupe apo punë individuale për rreth 30 – 35 minuta
- rishikim dhe konsolidim për 10 – 15 minuta

Këto ndarje kohore janë thjesht një udhëzim; koha për diskutim apo për punë në grup duhet të jetë fleksibël.

Trainimi mbi aftësitë drejtuese dhe ndërmjetësuese është thelbësor për përfaqësuesit e zgjedhur. Ky sesion u ofron nxënësve një model për drejtimin e qeverisë së tyre të cilën ata mund ta provojnë menjëherë. Me fillimin e këtij drejtimi, nxënësit mund të inkurajohen të vlerësojnë këto procedura dhe të mendojnë si të bëjnë vetë përmirësime.

Gjatë përgatitjes së sesioneve të trainimit mësuesit inkurajohen të përdorin:

- Kopje nga libri “E gjetëm zgjidhjen ... është qeveria e nxënësve” të ndarë në fletë pune
- Lojra për t’u fotokopjuar dhe përgatitur përpara sesioneve
- Materiale shpjeguese për t’u fotokopjuar për nxënësit

Është një ide e mirë t’u jepet nxënësve një dosje të qeverisë ku të mbajnë të gjitha materialet që mbledhin si anëtarë të qeverisë së nxënësve.

Qëllimet:

Të prezantojë konceptin e rregullave të sjelljes duke shpjeguar mënyrën se si:

- çdo fëmijë i shkollës mund të konsultohet nëpërmjet mbledhjes me klasën
- qeveria e nxënësve mund të krijojë një rregullore sjelljeje për të gjithë shkollën.

Rezultate:

Të ketë prezantuar konceptin e rregullave të sjelljes duke inkurajuar këdo të:

- reflektojë mbi sjelljen në vendin e vet të punës
- vlerësojë implikimet e këtij procesi në miratimin e një liste rregullash klase me nxënësit.

Burime

- 1 material prezantues
- 1 material shpërndarës
- një objekt natyral të këndshëm, si një gur apo guackë

1 Çfarë është rregullorja e sjelljes

15 minuta

I gjithë grupi

- Diskutoni mbi mënyrën se si klasa të ndryshme bien dakort për rregullat e sjelljes.

Material prezantues**rregullat e sjelljes**

- Diskutoni pikat një nga një, duke iu referuar materialit shpërndarës

2 Zhvillimi i një rregulloreje

45 minuta

- Ky ushtrim nuk duhet menduar si lojë me role, por si një proces real gjatë të cilit nxënësit reflektojnë mbi sjelljen në vendin e tyre të mësimi.
- Zgjidhni një temë mbi të cilën të miratoni një rregullore. Për shembull, një rregull sjelljeje lidhur me hapësirat ku qëndrojnë nxënësit dhe kohën që ata kalojnë sëbashku gjatë një dite shkolle.

Gjatë bashkëbisedimit në rreth:

- të gjithë me radhë duhet të plotësojnë fjalitë:
 - *Ajo që më pëlqen në vendin ku mësoj është ...*
 - *Ajo që do të doja të ndryshoja është ...*

Në grupe prej katër

- Diskutoni pyetjet e mëposhtme, duke u dhënë kohë grupeve të shprehin mendime dhe ide të cilat duhen hedhur në tabakë letre.

- Si do të doja të ishte vendi i mësimi? (psh. Me ngjyra, i kujdesshëm, i lumtur, etj)
- Çfarë e pengon atë të jetë i tillë?
- Çfarë bëjnë ndonjëherë të tjerët për të më mërzhitur? (pa emra)
- Çfarë bëj unë ndonjëherë që mund të mërzhisë të tjerët?

I gjithë grupi

- Duke përdorur si bazë informacionin e mbledhur, diskutoni dhe miratoni një listë “rregullash”.
- Çdonjeri në grup duhet të jetë dakort me çdo rregull, dhe nëse është e nevojshme diskutimi duhet të vazhdojë derisa të gjithë të mbeten të kënaqur.

Gjatë përdorimit të këtij procesi me nxënësit:

- Secila klasë adapton rregulloren e saj.
- Qeveria e nxënësve krijon një rregullore për gjithë shkollën duke përmbledhur rregullat e të gjitha klasave.
- Nxënësit dhe mësuesit bien dakort dhe adaptojnë rregulloren, duke e vendosur atë në mur së bashku me rregulloren e klasës.
- Nxënësit mund të reflektojnë mbi rregulloren e klasës duke e krahasuar me atë të shkollës, dhe mund të bëjnë ndryshimet e nevojshme, nëse psh kanë harruar diçka.

(Mësuesit mund të kenë kaluar përgjatë të njëjtit proces në lidhje me rregulloren e tyre të sjelljes për dhomën e mësuesve).

Material prezantimi 1

Rregullat e sjelljes

Çfarë është një rregullore e sjelljes për gjithë shkollën?

- Një konsensus për atë që konsiderohet si sjellje e pranueshme dhe pozitive.

Përse duhet të përfshijmë fëmijët në miratimin e rregullores?

- Fëmijët binden më lehtë ndaj rregullave që i kanë vendosur vetë.
- Nxist aftësitë pozitive të fëmijëve për drejtim
- Ndhmon fëmijët të ndërgjegjësohen moralisht

Si krijohet një rregullore e sjelljes për të gjithë shkollën?

- Çdo fëmije i jepet një mundësi për të kontribuar nëpërmjet bashkëbisedimit në rreth, mbledhjeve të klasës dhe qeverisë së nxënësve.

Kur duhen përgatitur rregullat e sjelljes?

- Gjatë mbledhjeve të zgjatura të klasës në çdo klasë të shkollës.

MATERIAL SHPËRNDARËS

Regullat e sjelljes

1 Çfarë është një rregullore e sjelljes për gjithë shkollën?

Një rregullore sjelljeje për gjithë shkollën është një mënyrë për të kërkuar dhe për të arritur konsensus mbi atë që konsiderohet si sjellje e pranueshme dhe pozitive në shkollë, bazuar në rregullat apo marrëveshjet e arritura në shumë klasa. Zakonisht ka sukses në promovimin e kësaj sjelljeje.

Rregullorja nuk përfshin detaje ndëshkimi, por është një dokument lehtësisht i arritshëm me bazë të gjerë i cili përforcon çfarëdolloj sistemi sanksionesh që ekziston në shkollë.

2 Përse të kemi një rregullore për gjithë shkollën?

Përfshirja e fëmijëve në modelimin e kulturës së tyre në shkollë, i sfidon ata të mbajnë mbi vete përgjegjësinë për ta bërë shkollën një vend më miqësor e më të rregullt. Fëmijët i zbatojnë më lehtësisht rregullat e vëna nga vetë ata pasi ndjejnë pronësinë mbi to.

3 Kur është koha e përshtatshme për të shkruar rregullat e sjelljes?

Bashkëbisedimi në rreth gjatë mbledhjes së klasës është momenti më i mirë për të punuar mbi rregullat e sjelljes. I gjithë procesi kërkon rreth një orë për t'u përfunduar në çdo klasë, prandaj do të nevojitet një sesion më i gjatë se zakonisht.

4 Si zhvillohet rregullorja e sjelljes?

Çdo fëmijë ka mundësinë të kontribuojë në marrëveshjen finale nëpërmjet bashkëbisedimit

në rreth në mbledhjen e klasës apo qeverisë së nxënësve.

- Duke përdorur objektin special, filloni me dy raunde në rreth ku secili me rradhë duhet të përfundojë fjalitë:
 - *Ajo që më pëlqen për klasën time është...*
 - *Diçka që do të doja ta ndryshoja është...*
- Ndajini fëmijët në grupe prej katër për të diskutuar pyetjet e mëposhtme, duke lejuar kohë midis tyre për mendime dhe ide të cilat duhen mbledhur në tabakë letre në mënyrë që t'i shohë gjithkush:
 - Çfarë lloj vendi do të doja të ishte klasa ime? (psh me ngjyra, të kujdesshëm, të lumtur, etj.)
 - Çfarë e ndalon atë të jetë i tillë?
 - Çfarë bëjnë ndonjëherë të tjerët në klasën time për të më mërziur? (pa emra)
 - Çfarë bëj unë ndonjëherë në klasën time që mund të mërzisë të tjerët?
- Kur punojmë me fëmijët më të vegjël, ky proces duhet të përshtatet në diskutim më të shkurtër e më joformal.
- Duke përdorur si bazë informacionin e mbledhur, diskutoni dhe bini dakort mbi një grup rregullash. Çdokush duhet të jetë dakort, dhe nëse është e nevojshme diskutimi duhet të vazhdojë derisa gjithësecili të jetë i kënaqur me rezultatin e tij.
- Kjo listë rregullash përbën rregulloren e miratur të sjelljes në klasë.
- Çdo klasë shpenzon një kohë të caktuar për të diskutuar për mjediset e tjera të shkollës ku ndodhin gjëra që i mërzisin ata, si psh në oborr, në tualet apo në korridore.
- Komentet e mbledhura edhe mbi këto tema, i dërgohen qeverisë së nxënësve.

5 Si përshtatet një rregullore e sjelljes për gjithë shkollën?

Rregullat e vendosura nga çdo klasë dërgohen në qeverinë e nxënësve për t'u diskutuar me gjithë gjërat e tjera. Qeveria e nxënësve i përdor të gjitha ato për të arritur në një përmbledhje që do të shërbejë si rregullorja e shkollës. Shpesh, rregullat që vijnë nga çdo klasë janë të ngjashme, prandaj anëtarët e qeverisë së nxënësve nuk duhet të kenë ndonjë vështirësi në përmbledhjen e tyre duke listuar kështu një grup rregullash që mbulon të gjitha pikat.

Çdo klasë duhet të ketë të njëjtën mundësi për ta shikuar dhe miratuar rregulloren e shkollës përpara se ajo të aprovohet formalisht.

Në këtë fazë, stafi i shkollës duhet ta diskutojë atë në mbledhjen e tij dhe nëse është e nevojshme të sugjerojë shtesa. Një mundësi për ta diskutuar duhet t'u jepet edhe prindërve e drejtuesve.

Fëmijët e kuptojnë procesin konsultues e demokratik në të cilin kalon miratimi i kësaj rregulloreje, pasi ata tashmë janë njohur dhe drejtuar në një process reflektimi, diskutimi e vendimi në grup mbi sjelljen që pritet në shkollë.

Promovimi i rregullores

Me përfundimin e rregullores së sjelljes dhe

miratimin e saj, ajo duhet të promovohet aktivisht në gjithë shkollën dhe komunitetin. Ja disa mënyra:

- mund të shtypet e të firmoset nga gjithë nxënësit në shkollë
- kryetari i qeverisë së nxënësve mund ta lexojë me zë të lartë përpara gjithë shkollës
- prindërve mund t'u dërgohen kopje në shtëpi
- duhet të jetë baza e rregullores së përgjithshme të shkollës ose të përfshihet në të,
- çdo klasë duhet të ketë një kopje të varur në mur krahas rregullores së klasës.

Vënia e saj në praktikë

Në një fare mënyrë rregullorja zbatohet nga vetë procesi i zhvillimit të saj, dhe sepse ajo mund të shihet nga të gjithë fëmijët në çdo moment që ata ndodhen në klasë. Por ndonjëherë është e pashmangshme që ajo të mos zbatohet. Kur kjo ndodh, duhet të sillet në vëmendjen e nxënësve gjatë bashkëbisedimit në rreth në mënyrë që sjellja të diskutohet nën dritën e rregullores së shkollës.

Këto diskutime sigurojnë një strukturë të sigurt brenda së cilës fëmijët me qëndrime pozitive, që zakonisht përbëjnë shumicën, mund të sfidojnë autoritetin e grupeve anti sociale, të cilët ndonëse të vegjël, mund të jenë të jenë të ndikueshëm.

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE NËPËRMJET NDËRMJETËSIMIT MES BASHKËMOSHATARËVE

Qëllimet:

Të prezantojë konceptin e ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve duke:

- treguar si mund të përdoret bashkëbisedimi në rreth për të mësuar aftësi ndërmjetësimi
- kuptuar procesin ndërmjetësues nëpërmjet veprimtarive pjesëmarrëse
- përcaktimin e principeve kyçe të ndërmjetësimit.

Rezultate:

Të kemi vlerësuar procesin e ndërmjetësimit duke :

- praktikuar ndërmjetësuesin nëpërmjet lojës me role
- reflektuar mbi futjen e ndërmjetësimit si praktikën në klasë.

Burime

- 3 Materiale prezantuese
- 1 material prezantues: Të ndërmjetësojmë ("E gjetëm zgjidhjen... është qeveria e nxënësve, Kapitulli 5, fq 63)
- 1 material shpërndarës
- materialin shpërndarës, Unë u ndjeva... kur ti... sepse ("E gjetëm zgjidhjen... është qeveria e nxënësve, Kapitulli 5, fq 64-65)

I gjithë grupi

Mësuesit mund të kuptojnë më së miri se ata vetë i zgjidhin konfliktet nëpërmjet ndërmjetësimit. Qëllimi i këtij sesioni është të kalohet nga mësuesi gjygtar në fëmijën ndërmjetësues.

1 Prezantim me konceptin e ndërmjetësimit

25 minuta

- Hidhni ide mbi mënyrat e trajtimit të konfliktit për momentin dhe sa të sukseshme apo jo janë ato duke i shkruar në tabakë letre.
- Është normale të besosh se dikush duhet patjetër të veprojë si gjygtar në një moment të caktuar.

Material prezantues 1

Negocimi i konfliktit

- Kur mësuesit veprojnë si ndërmedjtësues dhe jo si gjygtarë, fëmijët mësojnë të ndërmjetësojnë për njëri – tjetrin.

Material prezantues 2

Të mësojmë ndërmjetësimin nëpërmjet bashkëbisedimit në rreth

- Bashkëbisedimi në rreth është një mundësi e mirë për t'u mësuar fëmijëve aftësi ndërmedjtësuese. Fëmijë të veçantë mund të trajnohen për t'u bërë ndërmjetësues të njohur në shkollë.

Material prezantues 3

Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve

- Diskutoni një nga një pikat në projektor, duke iu referuar edhe materialit shpërndarës.

2 Praktika e ndërmjetësimit

45 minuta

- Në këtë pjesë të sesionit pjesëmarrësit praktikojnë ndërmjetësimin, nëpërmjet lojës me role në grupe të vogla duke u bazuar sa më shumë në përvojën e tyre.

Material prezantues 4

Le të ndërmjetësojmë ("E gjetëm zgjidhjen... është qeveria e nxënësve, Kapitulli 5, fq 63)

- Dy pjesëmarrës lexojnë me zë të lartë dialogun në materialin shpërndarës, *Unë u ndjeva... kur ti... sepse ("E gjetëm zgjidhjen... është qeveria e nxënësve, Kapitulli 5, fq 64-65)*

Në grup prej katër

- Dy pjesëmarrës sillen si fëmijë të cilët janë zënë gjatë kohës së pushimit dhe dëshirojnë që ndërmjetësuesi t'i ndihmojë për të zgjidhur problemin. Përpara se të filloni, ata kanë një minutë kohë për të diskutuar jashtë rolit, se çfarë ndodhi me saktësi në oborrin e shkollës.
- Një person luan rolin e mësuesit i cili ndërmjetëson. Ndërmjetësuesi di vetëm atë çka i është thënë gjatë lojës me role.
- Një person luan rolin e vëzhguesit. Gjatë procesit, vëzhguesi duhet të shënojë nëse ndërmjetësi e luan rolin e tij në përputhje me principet. Materiali prezantues mbi rolin e ndërmjetësit mund të shfaqet në mur gjatë gjithë kohës.
- Pjesëmarrësit mund të krijojnë skenaret e tyre, duke u dhënë vetes emra të rremë, por duke përdorur sa më shumë përvojën e tyre.

Nëse preferoni, mund të përdorni shembujt e mëposhtëm:

Zana po ankohet pasi ajo nuk u lejua të bashkobej në një lojë gjatë pushimit dhe Miri po mbron të drejtën e saj për ta përjashtuar Zanën.

Driti u qëllua në fytyrë me një top futbolli që po gjuante Laura dhe pretendon se ajo ia plasi të qesurit kur pa se ç'ndodhi.

- Secili në grup duhet të lejohet që për 5 minuta të veprojë si ndërmjetës, duke zgjedhur të njëjtin skenar ose të bazohet në përvoja të ndryshme.

- Pas çdo radhe, grupi duhet të shpenzojë 5 minuta të tjera për diskutim. Vëzhguesi duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë se si u ndienë debatuesit nga të qëniet të dëgjuar e të kuptuar nga ndërmjetësi dhe procesi i ndërmjetësimit.

3 Diskutime

20 minuta


I gjithë grupi

- Sa ndryshe ishte procesi (ose jo) nga mënyra se si trajtohet zakonisht konflikti në shkollë.
- Hapësirat dhe strukturat që janë vendosur për të mundësuar ndërmjetësimin si pjesë e praktikës së shkollës.


Material prezantimi 1

Negocimi i konfliktit


Të rriturit në rolin
e gjyqtarit



Të rriturit
si ndërmjetës




Fëmija ndjërmetës



Material prezantimi 2

Të mësojmë ndërmjetësimin nëpërmjet kohës së rrethit në gjithë klasën



Të gjithë po mësojnë si të ndërmjetësojnë

Material prezantimi 3

Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve

Çfarë është ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve?

- Njerëzit zgjedhin ta gjejnë vetë zgjidhjen për konfliktet e tyre, me ndihmën e një bashkëmoshatare.

Si funksionon ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve?

- Zbatohen rregullat e bashkëbisedimit në rreth (nuk ka fyerje, secili ka radhën e vet për të folur e për t'u dëgjuar)
- Çdokush fokusohet në një problem specifik, jo zënka të dikurshme apo ankesa të përgjithshme.

Si sillen njerëzit?

- Ulen ballë për ballë dhe flasin me njëri – tjetrin, jo për njëri – tjetrin.
- Shprehen se si u ndienë nga situata.
- Janë të gatshëm të ndryshojnë në të ardhmen.

Cili është roli i ndërmjetësit?

- Ka konsideratë pozitive për secilin person.
- Siguron që procesi udhëhiqet nga rregullat dhe njerëzit sillen gjithashtu sipas rregullave.
- Tregon se ka dëgjuar ç'ka thënë secili person duke përsëritur.
- Pyet se çfarë do donin ata të ndodhte në të ardhmen.
- Respekton një limit kohor të miratuar.
- Është i qartë për çfarë mund të ndodhë më tej nëse ata nuk bien dakort.

MATERIAL SHPËRNDARËS

Ndërmjetësimi mes bashkëmoshatarëve

1 Koncepti i ndërmjetësimit mes bashkëmoshatarëve

Ndërmjetësimi është një aftësi jetësore e cila bazohet në dëgjimin aktiv. Nxënësit janë të aftë të mësojnë të dëgjojnë dhe të sillen si ndërmjetës për moshatarët e tyre kur ka konflikte. Ndërmjetësimi mundëson dy ose më shumë njerëz që kanë probleme të identifikojnë marrëveshje apo zgjidhje për veten e tyre; përforcon aftësinë e njerëzve të të gjitha moshave të formojnë dhe të ruajnë marrëdhënie kuptimplote dhe të vlefshme.

Procesi vullnetar u ofron të përfshirëve në konflikt një mundësi për të folur në mirëbesim mbi problemin nga këndvështrimet e tyre.

Ndërmjetësi dëgjon çdo gjë që thonë ata pa u ndikuar dhe pa gjykuar. Ata duhet të kuptojnë se që të dyja palët duhet të bien dakort të ndryshojnë sjelljen e tyre.

Shpesh probelemt lindin si rrjedhojë e një komunikim jo të mirë. Nëse një nxënësi i jepet mbështetja e një ndërmjetësi për të folur drejtpërdrejt mbi çështjen, shpesh ajo mund të zgjidhet. Ndërmjetësimi mes moshatarëve krijon një strukturë brenda së cilës nxënësit ndihen të sigurtë kur negociojnë dhe zgjidhin konfliktin. Ndërmjetësimi mes moshatarëve ul shanset që incidente të vogla të kthehen në serioze të cilat mund të çojnë edhe në përjashtime.

Kur shkollat prezantojnë ndërmjetësimin bashkëmoshatar, mësuesit nuk kanë më nevojë të sillen si gjygtarë apo paqe vënës – psh për

zënkë në oborr – pasi nxënësit mund të merren vetë me problemet. Mësuesit nuk kanë pse të thirren, vetëm në rast se dikush është lënduar fizikisht dhe ata që janë përfshirë kanë nevojë për ndihmën e të rriturve.

2 Të zgjedhësh një ndërmjetës

Qeveria e nxënësve mund të vendosë të ofrojë shërbim ndërmjetësimi dhe të zgjedhë një apo më shumë nga anëtarët e saj për t'u bërë ndërmjetësit e shkollës. Gjithashtu klasa mund të zgjedhë ndërmjetësit e saj. Nxënësit që do të njihen si ndërmjetës në shkollë apo në klasë duhet të trainohen në mënyrë që të fitojnë aftësitë që u duhen. Ndërsa ata fillojnë të vëzhgojnë dhe të ndërmjetësojnë, nxënësit e tjerë mund të mësojnë aftësi ndërmjetësimi prej tyre.

Gjëja më e rëndësishme për gjithësecilin është që t'i besojë ndërmjetësit i cili është i drejtë dhe asnjansës. Për këtë arsye, do të ishte mirë që ata që janë pjesë e zënkës të zgjedhin vetë një person si ndërmjetës, për të cilin të dy ndihen të kënaqur, të cilin ata e dinë se do t'i dëgjojë mirë dhe se e kupton procesin e ndërmjetësimit. Kjo bëhet e mundur atëherë kur të gjithë nxënësit kanë mësuar për ndërmjetësimin.

3 Si mësohet ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi mund të mësohet gjatë bashkëbisedimeve në rreth kur mësuesi kujdestar mund të modelojë për nxënësit procesin e ndërmjetësimit.

Kur dy ose më shumë nxënës kanë një zënkë, mësuesi i pyet nëse ata kanë dëshirë ta diskutojnë

gjatë kohës së rrethit. Zakonisht fëmijëve u pëlqen që problemet e tyre të merren kaq seriozisht.

Me gjithë klasën të ulur në një rreth, apo gjatë mbledhjes së qeverisë së nxënësve të gjithë kanë mundësinë të dëgjojnë këndvështrimet e të gjitha palëve të përfshira.. Mësuesi i pyet për ide se si mund të përmirësohet situata në të ardhmen. Zakonisht fëmijët në klasë janë shumë të vëmendshëm, duke e bërë më të lehtë diskutimin me shokët e tyre mbi problemet që kanë. Ata shpesh kanë ide shumë të mira se si të ndihmojnë.

Ndonjëherë është e qartë se problemet kanë ardhur për shkak të kushteve të veçanta fizike, si psh oborri i mbushur plot, kështu që kushdo përfiton nga diskutimi i këtij problemi duke menduar për zgjidhje kolektive. Në këtë mënyrë nxënësit mësojnë për ndërmjetësimin duke e praktikuar atë. Shume prej tyre bëhen shpejt ekspertë duke u sjellë si ndërmjetës për moshatarët e tyre, edhe pa prezencën apo ndërhyrjen e mësuesit.

Mësuesit mund t'i njohin fëmijët e fillores me këto përqasje nëpërmjet mënyrës se si ata dëgjojnë problemet e tyre, dhe t'i inkurajojnë ata të flasin me njëri – tjetrin dhe të negociojnë. Sa më të vegjël të jenë fëmijët kur mësojnë për ndërmjetësimin, aq më të zotë bëhen ata kur rriten në negocimin e çështjeve të vështira.

4 Principet e ndërmjetësimit

Principet e mëposhtme janë gjithmonë të rëndësishme kur mësuesi modelon procesin e ndërmjetësimit gjatë punës me qeverinë e nxënësve apo dhe gjatë një mbledhje me klasën:

- Njerëzit duhet të inkurajohen për të gjetur vetë zgjidhjet për konfliktet, dhe jo t'u zgjidhet problemi nga ndërmjetësi.
- Zbatohen rregullat e bisedave në rreth (jo

fyerje, jo paragjykime, secili flet me radhë dhe ka të drejtë të dëgjohet)

- Të gjithë duhet të pranojnë dhe të vlerësojnë njëri – tjetrin
- Ata që janë në konflikt duhet të ulen përballë e të flasin me njëri – tjetrin.
- Ndërmjetësi duhet t'i inkurajojë që ata të tregojnë si u ndienë nga situata e krijuar.
- Ndërmjetësi bie dakort që gjithçka të trajtohet në mirëbesim; nëse dikush është dëmtuar fizikisht kërkohet ndihma e të rriturve.
- Ndërmjetësi u kërkon të përfshirëve të fokusohen në gjendjen aktuale, dhe jo të përmendin zënka të tjera apo ankesa të përgjithshme; nuk duhen përdorur fjalët “gjithmonë” apo “kurrë”.
- Ndërmjetësi tregon se ka dëgjuar çdo fjalë që është thënë duke u përsëritur të pranishmëve fjalët e tyre.
- Të gjithë duhet të jenë të qartë për çfarë mund të ndodhë më pas nëse ata nuk arrijnë në një marrëveshje (psh do flitet me mësuesin kujdestar, ose çështja do t'i kalojë për diskutim qeverisë së nxënësve, etj.)
- Kur problemit i jepet një zgjidhje, është mirë t'i tregohet edhe klasës, e cila mund të jetë në dijeni për zënkat që ndodhin.

5 Zgjedhja e formatit

Formati për ndërmjetësimin mund të variojë, duke marrë gjithmonë në konsiderate principet.

Numri minimal i personave të angazhuar në një proces të tillë është tre – dy njerëz me një konflikt për të zgjidhur dhe një ndërmjetës. Mund të ndodhë që në zënkë të jenë përfshirë më shumë se dy persona, rast në të cilin do të ishte mirë që dy ndërmjetës të punonin sëbashku.

Ndonjëherë debatuesit duan të kenë “mbështetës” të cilët janë në dijeni dhe mund t'i ndihmojnë për argumentat e tyre. Në këtë rast

formati mund të jetë dy njerëz në konflikt me njëri – tjetrin, dy mbështetës dhe një ndërmjetës i cili është gjithmonë asnjës. Shpesh ndodh që mbështetësit të marrin përsipër edhe rol ndërmjetësi.

6 Koha për ndërmjetësim

Nxënësit duhet ta dinë ku dhe kur kanë mundësi

të takojnë ndërmjetësit. Nëse ndërmjetësit janë anëtarë të qeverisë së nxënësve, ata mund të jenë të gatshëm në orë të caktuara gjatë ditëve të shkollës (zakonisht gjatë pushimit të madh). Nëse ndërmjetësimi është pjesë integrale e praktikës shkollore, mundet që një grupi të vogël prej pesë fëmijësh t'i jepet mundësia të zgjidhë një konflikt edhe duke u shkëputur nga mësimi.

QEVERIA E NXËNËSVE: AKTIVITETE TË TJERA

Koha e nevojshme për diskutim varet nga faza ku ka arritur zhvillimi i qeverisë së nxënësve **1 ½ orë**

Qëllimet:

Një sesion i përbashkët për anëtarët e qeverisë së nxënësve dhe mësuesit për të:

- marrë në konsideratë disa nga aktivitetet e tjera që mund të organizojnë së bashku.

Rezultate:

- të sugjerohen disa aktivitete specifike që do të ishin të përshtatshme për qeverinë e nxënësve

Burime

- 1 material prezantues
- 1 material shpërndarës

*I gjithë grupi***Material Prezantues****Aktivitete të qeverisë së nxënësve**

Ky sesion është një diskutim i përgjithshëm i pikave të listuar në materialin prezantues, duke përdorur materialin shpërndarës për informacion mbështetës. Pas çdo sesiioni, çdo veprim që miratohet duhet mbajtur shënim në tabakë letre.

1 Si mund të mbështesin nxënësit njëri – tjetrin*15 minuta*

- Grupet e patronazhit dhe zyrat e këshillimit
- Ndonjë ide tjetër

2 Si mund të ndihmojë qeveria e nxënësve në përmirësimin e mjedisit të shkollës*15 minuta*

- Cilat mjedise të shkollës shkaktojnë probleme?
- A mund të bëjnë qeveritë e nxënësve sugjerime për përmirësime?

3 Si mund të kontribuojnë qeveritë e nxënësve në komunitetin lokal?*15 minuta*

- Çfarë shqetësimesh kanë nxënësit dhe stafi

për komitetin dhe mjedisin lokal?

- Çfarë mund të bëjnë qeveritë e nxënësve?

4 Duan qeveritë e nxënësve të ngrenë fonde?*15 minuta*

- Për çfarë do të shpenzonte para qeveria e nxënësve?
- Si mund të ngrejë fonde?
- A mundet qeveria e nxënësve të menaxhojë fondet e veta?

5 Si do të përfshihen prindërit në qeverinë e nxënësve?*15 minuta*

- Si përfshihen aktualisht prindërit në aktivitetet e shkollës?
- Si do të informohen prindërit mbi aktivitetet e qeverisë së nxënësve?
- A do të krijojnë lidhje nxënësit me prindër të veçantë dhe me komitetin e përgjithshëm të prindërve?

6 Përmbledhje dhe plani i veprimit*15 minuta*

Mbani shënim:

- Planin e miratuar
- Kush do të ndër marrë hapat e parë
- Kur do të fillojnë

Material prezantimi 1

Aktivitete të qeverisë së nxënësve

Sjellja e nxënësve përmirësohet kur ata mbështeten dhe inkurajohen nëpërmjet aktiviteteve të tilla si:

- Grupet e patronazhit apo engjëjt mbrojtës të cilët ndihmojnë nxënës të caktuar që kanë probleme
- Grupet e këshillimit ku kushdo mund të gjejë ndihmë

Mjedisi i shkollës përmirësohet kur nxënësit:

- Punojnë mbi idetë e tyre personale për të sjellë ndryshime pozitive
- Negociojnë me stafin dhe drejtuesit për t'i realizuar ndryshimet

Komuniteti lokal përmirësohet kur qeveritë e nxënësve angazhohen si qytetarë aktive dhe marrin përsipër çështje të tilla si:

- Trafiku jashtë shkollës dhe kryqëzime të sigurta
- Përdorimi dhe kujdesi për hapësirat lokale

Nëpërmjet ngritjes së fondeve, qeveritë e nxënësve mund të:

- Blejnë pajisje të veçanta për shkollën
- Mbështesin ata që janë në nevojë
- Mësojnë mbi buxhetimin dhe menaxhimin e parave

Qeveritë e nxënësve dhe prindërit mund të punojnë së bashku për të:

- Mbështetur aktivitetet e shkollës
- Mësuar aftësi të veçanta

MATERIAL SHPËRNDARËS

Aktivitete të qeverisë së nxënësve: disa shembuj

1 Si mund të mbështesin nxënësit njëri – tjetrin?

Të gjithë nxënësit kanë nevojë për mbështetje dhe kurajo për të ndryshuar sjelljet anti sociale, me një drejtim pozitiv nga moshatarët e tyre.

Me adaptimin nga ana e shkollës të një rregulloreje mbi sjelljen, të gjithë fëmijët e kuptojnë se si duhet të sillen. Qeveria e nxënësve, bashkëbisedimet në rreth dhe ndërmjetësimi bashkëmoshatar, i mundësojnë fëmijët të ush-trojnë një influencë pozitive ndaj moshatarëve të tyre për të vëzhguar rregulloren dhe për t'u sjellë mirë.

Grupet e patronazhit

Nxënësit dalin vullnetarë për të qenë pjesë e një grupi të tillë, për të ndihmuar shokët e tyre në rast të ndonjë sjelljeje jo të mire. Kjo mënyrë u bën të qartë nxënësve që sillen keq, se nuk dënohen ata, por është sjellja e tyre që është e papranueshme. Kur sugjerohet një grup patronazhi, klasa duhet të diskutojë se çfarë mund të bëjë ky grup në rastin specifik të dhënë. Ky grup mund të jetë i gatshëm që gjatë kohës së pushimit të ndihmojë një nxënës që ka një shqetësim, apo mund edhe të vijë rrotull dhe herë pas here të kujtojë se nuk duhen përdorur grushtat kur zihemi, por që duhet të bisedojmë për të gjetur një zgjidhje.

Grupet e këshillimit

Një numër shkollash ka përshtatur disa hapësira ku nxënësit që kanë dalë vullnetarë ose janë zgejdur në grupin e patronazhit janë të gatshëm (me rradhë) gjatë pushimit të madh të dëgjojnë

problemet që mund të kenë nxënësit e tjerë. Ata duhet të jenë të drejtë dhe në gjendje të dëgjojnë të dyja palët pa favorizuar ndonjërin prej tyre. Mund të ketë një metodë identifikimi të tyre gjatë pushimit të madh, psh një shkollë përdor fasho me ngjyrë të vendosura në njërin krah. Kjo do të thotë se ata nuk janë të ngulur në një vend; ata luajnë me të tjerët e lëvizin nëpër shkollë, por në rast se dikush do të flasë me ta mund t'i gjejë lehtësisht.

2 Si mund të ndihmojnë qeveritë e nxënësve për të përmirësuar mjedisin e shkollës

Qeveria e nxënësve u jep nxënësve një mundësi ku ata mund të shprehin si ndihen për ambientin fizik që i rrethon dhe mbi rutinën e përditshme shkollë. Ata mund të kenë shqetësime për sjelljen e mësuesve, tualetet apo vendet e lojës, gjëra për të cilat mësuesit nuk dinë gjë.

Nxënësit shpesh janë në gjendje të sugjerojnë zgjidhje të ndjeshme ndaj problemeve nëse stafi i shkollës tregon dëshirë dhe vullnet për të bashkëpunuar në vënien e tyre në praktikë. Vazhdimisht shkollat kuptojnë se disa rregullime apo ndryshime të lehta p.sh. për orarin e pushimit apo gjendjen e tualeteve, mund ta bëjnë shumë më të lumtur jetën e fëmijëve në shkollë.

Qeveritë e nxënësve të cilat janë këmbëngulëse në çuarjen përpara të ideve të menduara mirë, kuptojnë realisht kur ato kanë sukses në përmbushjen e disa ndryshimeve duke negociuar me stafin dhe drejtuesit e shkollës.

3 Nxënësit si qytetarë aktivë të komunitetit lokal

Me adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve të ndryshme nga ana e qeverisë së nxënësve, nxënësit fillojnë të mendojnë për shqetësime më të gjera në lidhje me komunitetin e tyre. Ata mund të vendosin t'i shkruajnë bashkisë së tyre mbi probleme të tilla si shpejtësia dhe trafiku i makinave, nevoja për rrugë kalimi të sigurta; probleme që lidhen me mjedisin, etj.

Nëse një përfaqësues klase ngre një çështje të komunitetit në qeverinë e nxënësve, mësuesi koordinator mund t'i ndihmojë të zbulojnë më shumë, të kontaktojnë grupet vullnetare të zonës, dhe ta vazhdojë me autoritetet përkatëse. Pjesa tjetër e stafit informohet mbi ecurinë nëpërmjet mënyrave të zakonshme si shënimet, raportimi etj.

4 Ngritja e fondeve

Për ngritje fondesh mund të ketë arsye të ndryshme të cilat vijnë si rrjedhojë e identifikimit nga ana e qeverisë së nxënësve e një çështjeje e cila mbështetet shumë prej tyre. Ata mund të radhisin nga nevojat e vetë shkollës, si më shumë pajisje në fushën e lojrave, deri në përgjigje ndaj një thirrjeje kombëtare sidomos në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

Qeveria e nxënësve zakonisht vjen me ide për sasinë e parave që duhen siguruar duke i shkruar biznesmenëve të zonës apo dhe organizmave të tjerë. Qeveria duhet të krijojë në grup pune për të vazhduar më tej.

Është në ndihmë të qeverisë së nxënësve zgjedhja e një financieri i cili do të menaxhojë këto fonde. Në këtë mënyrë fëmijët mësojnë vlerën e parave dhe si të shpenzojnë me zgjuarsia e realizëm.

5 Qeveritë e nxënësve punojnë së bashku me prindërit

Prindërit duhen mbajtur gjithmonë të informuar mbi rolin që luan qeveria e nxënësve në gjithë shkollën. Ndonjëherë qeveria e nxënësve mund t'u kërkojë prindërve të marrin pjesë në mbledhje për t'u dhënë atyre këshilla apo ndihmë në një fushë specifike. Në disa shkolla, nxënësit ftohen të ndjekin mbledhjet e prindërve. Prindërit mund të sigurojnë lidhje midis nxënësve dhe komunitetit më gjerë.

Kur çdokush është i ndërgjegjshëm për komunitetin në të cilin jeton, dhe kur qeveria e nxënësve është strukturë funksionale komunikimi, fëmijët dhe prindërit mund të flasin me njëri – tjetrin për një gamë të gjerë çështjesh.

PLAN VEPRIMI PËR QEVERTË E NXËNËSVE

Qëllimet:

Të reflektojë mbi çështjet e ngritura nga programi i trainimit me qëllim që të:

- Marrë në konsideratë një rregullore të qeverisë së nxënësve
- Hartojë një plan veprimi për krijimin e strukturës së qeverisë së nxënësve në shkollë.

Rezultate:

Të biem dakort mbi:

- Bazat e një rregulloreje të qeverisë së nxënësve
- Një plan veprimi, me qëllime të qarta për hapat e mëtejshëm në zhvillimin e qeverisë së nxënësve

Burime

- 1 material prezantues
- 1 material shpërndarës

1 A është shkolla në një pozicion të tillë për të krijuar një qeveri nxënësish?

10 minuta

I gjithë grupi

- Jepni përgjigje ndaj pyetjeve të mëposhtme dhe shkruajini ato në një tabak letre:
 - Çfarë pikash të forta kemi identifikuar në shkollën tonë që do të na ndihmojnë në krijimin e qeverisë së nxënësve?
 - Cilat janë pikat e dobëta në strukturat tona shkollore që mund të na vështirësojnë krijimin e qeverisë së nxënësve?

2 Përse të kemi një rregullore të qeverisë së nxënësve?

20 minuta

Material Prezantues

Rregullorja e qeverisë së nxënësve: shkaqet dhe qëllimet

- Diskutoni implikimet e mundshme të shkollës për shkrimin e një rregulloreje për qeverinë e nxënësve, duke shënuar në tabakë letre pikat kyçe.

3 Plani i veprimeve

20 minuta

Në grupe prej tre ose katër

- Diskutoni mbi hapat e mëtejshëm të shkollës dhe bini dakort mbi:
 - Hapi i parë i menjëhershëm
 - Një qëllim për t'u arritur në një ose dy muaj
 - Çfarë duhet arritur brenda vitit të parë

I gjithë grupi

- Shkruani në tabakë letre qëllimet që dalin nga çdo grup si bazë e planit zhvillues të qeverisë së nxënësve

4 Hapat e parë

10 minuta

- Vendosni kush do të shkruajë draftin e parë të rregullores së qeverisë së nxënësve dhe kur do të diskutohen përsëri planet mbi qeverinë e nxënësve.

Material prezantimi 1

Rregullorja e qeverisë së nxënësve: shkaqet dhe qëllimet

Qeveria e nxënësve ndihmon për të siguruar se nxënësit kanë:

- një mjedis mësimor të sigurt, të lumtur e të drejtë
- një forum për të ngritur zërin mbi shqetësimet e tyre dhe të punojnë për to
- një mundësi të strukturuar për të fituar aftësi në zgjidhjen e problemeve
- një mundësi për të marrë pjesë aktive në menaxhimin e shkollës
- përvojë të proceseve demokratike

Qeveria e nxënësve duhet t'i inkurajojë nxënësit të zhvillojnë:

- ndjenjë përkatësie mbi rregullat dhe praktikat
- konsensus mbi çështjet e shkollës, si psh sjellja
- përgjegjësi ndaj komunitetit dhe mjedisit shkollor.

Qeveria e nxënësve duhet t'u japë nxënësve përvojë në:

- planifikim, organizim dhe monitorim të projekteve të vogla
- fjalim, dëgjim dhe debatim
- aftësi ndërmjetësuese dhe negociuese
- buxhetim dhe menaxhim fillestar parash

Qeveria e nxënësve duhet t'i përgatisë nxënësit për qytetarinë nëpërmjet:

- mësimin mbi role, të drejta dhe përgjegjësi brenda sistemit shkollor si dhe në komunitet

MATERIAL SHPËRNDARËS

Plan veprimi i qeverisë së nxënësve

1 Principet

Disa ose të gjitha prej principeve të mëposhtme duhet të vendosin bazën e rregullores së qeverisë së nxënësve.

- Shkolla është një komunitet. Qeveria e nxënësve siguron balancim tërësor, duke ndihmuar për një komunitet më harmonioz dhe më të mirë.
- Qeveria e nxënësve u jep mundësi nxënësve me qëndrim pozitiv, që zakonisht përbëjnë shumicën, të ushtrojnë influencë pozitive.
- Duke mundësuar nxënësit të jenë partnerë në vetë edukimin e tyre, qeveria e nxënësve është një burim jetësor në krijimin e një shkolle dinamike në të cilën nxënësit janë një forcë për ndryshim pozitiv në frymën dhe mjedisin e shkollës.
- Qeveria e nxënësve e zgjedhur në mënyrë demokratike i pajis nxënësit me forumin më të mirë ku të zhvillojnë aftësitë dhe kuptimin e tyre mbi qytetarinë aktive.
- Kontributi në qeverinë e nxënësve i lejon nxënësit të rrisin vetëvlerësimin dhe të zhvillohen si individë të vlefshëm të cilët mund të japin kontributin e duhur në shoqëri.
- Qeveria e nxënësve i ndihmon nxënësit të zhvillojnë vetëbesimin, aftësi sociale dhe sjellje të përgjegjshme morale me njëri – tjetrin dhe me mësuesit e tyre.
- Nëpërmjet qeverisë së nxënësve, nxënësit mësojnë të dëgjojnë të tjerët dhe të njohin të drejtën e tyre për të qenë të dëgjuar.

2 Shkaqet dhe qëllimet

Një dokument rregullorje mbi qeverinë e nxënësve duhet të përfshijë disa, ose të gjitha, prej

pikave të mëposhtme:

- **Qeveria e nxënësve ndihmon për të siguruar se nxënësit kanë:**
 - një mjedis mësimor të sigurt, të lumtur e të drejtë
 - një forum për të ngritur zërin mbi shqetësimet e tyre dhe të punojnë për to
 - një mundësi të strukturuar për të fituar aftësi në zgjidhjen e problemeve
 - një mundësi për të marrë pjesë aktive në menaxhimin e shkollës
 - përvojë të proceseve demokratike
- **Qeveria e nxënësve duhet t'i inkurajojë nxënësit të zhvillojnë:**
 - ndjenjë përkatësie mbi rregullat dhe praktikatat
 - përqasje bashkëpunuese për arritjen e konsensusit mbi çështjet e shkollës
 - përgjegjësi dhe përkatësi ndaj komunitetit dhe mjedisit shkollor.
- **Qeveria e nxënësve duhet t'u japë nxënësve përvojë në:**
 - planifikim, organizim dhe monitorim të projekteve të vogla
 - fjalim, dëgjim dhe debatim
 - aftësi ndërmjetësuese dhe negociuese
 - buxhetim dhe menaxhim fillestar parash
- **Qeveria e nxënësve duhet t'i përgatisë nxënësit për qytetarinë nëpërmjet:**
 - mësimi mbi role, të drejta dhe përgjegjësi brenda sistemit shkollor si dhe në komunitet

3 Udhëzime

Udhëzimet e rregullores do të varen nga mënyre e planifikimit dhe organizimit të qeverisë së nxënësve. Rregullorja duhet të jetë e hapur për të gjithë nxënësit dhe qeveria e nxënësve duhet të konsultohet përpara se ajo të aprovohet.

Udhëzimet do të duhet të trajtojnë pikat e mëposhtme:

- **Zgjedhjet**
 - si, kur dhe ku do të zhvillohen zgjedhjet
 - sa kandidatë do të zgjidhen për çdo klasë
- **Qeveria e nxënësve**
 - madhësia e saj
 - anëtarësimi (përfaqësuesit e klasave, mësuesi koordinator, ndojnë anëtar tjetër i ftuar, etj.)
 - përcaktimi i funksioneve në qeveri
 - a ka një buxhet për çështjet e qeverisë së nxënësve dhe kush e menaxhon atë

- **Organizimi i mbledhjeve**

- si do të krijohen programet e si do të mbahen shënimet
- kur dhe ku do të bëhen mbledhjet
- kudo do t'i mbajë shënimet, ku do të ruhen ato dhe si do të qarkullohen
- çfarë strukture është ngritur në rast se njëri nga drejtuesit e shkollës vendos veton për një nga pikat e programit

- **Lidhje midis qeverisë së nxënësve dhe klasës**

- çfarë strukturash funksionojnë brenda klasës
- si do të përfshihen nxënësit më të vegjël
- si lidhet qeveria e nxënësve me klasën
- kur dhe si jepet raportimi në klasë

Këto vendime do të formojnë bazën e një rregulloreje të thjeshtë për qeverinë e nxënësve. (referoju shtojcës 1)

SHTOJCA 1

Model rregulloreje për qeverinë e nxënësve

Objektivat

- Të mundësojë përfshirjen e nxënësve në përmirësimin e jetës në shkollë.
- Të krijojë një klimë positive në shkollë ku nxënësit të punojnë si partnerë me stafin e shkollës.
- Të zhvillojë te nxënësit aftësi të cilat do të jenë të rendësishme për ta gjatë gjithë jetës.
- Të mundësojë përfshirjen e nxënësve në zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve.

Qeveria e nxënësve:

- Çdo klasë zgjedh përfaqësuesin e saj për në qeverinë e nxënësve i cili ndryshe quhet senator.
- Në qeverinë e krijuar mund të shtohen anëtarë të tjerë në rast se përfaqësia e zgjedhur nuk reflekton gjithë komunitetin e shkollës, psh: grupet minoritare apo fëmijët me aftësi të kufizuara.
- Qeveria e nxënësve organizon mbledhje çdo javë.
- Qeveria e nxënësve zgjedh kryetarin e saj, nënkryetarin, sekretarin, financierin dhe funksione të tjera sipas rastit.
- Sekretari mban shënimet e mbledhjeve të qeverisë së nxënësve. Këto shpërndahen në çdo klasë për t'u siguruar se të gjithë nxënësit kanë dijeni mbi veprimtarinë e qeverisë.

Përgjegjësitë e grupit drejtues të qeverisë së nxënësve:

- Në grupin drejtues përfshihen: kryetari, nënkryetari, sekretari dhe financieri.

- Ky grup është përgjegjës për menaxhimin e aktivitetit të qeverisë, psh: planifikimin e mbledhjeve, diskutime me mësuesin coordinator, etj.
- Grupi drejtues duhet të sigurohet se çdo çështje që trajtohet gjatë mbledhjeve të qeverisë së nxënësve është brenda rregullores së shkollës.
- Kryetari dhe nënkryetari janë përgjegjës për drejtimin e mbledhjeve, duke u dhënë të gjithëve një shans të barabartë për të folur. Ata duhet të sigurohen se qeveria e nxënësve gjen zgjidhje praktike për problemet e ngritura.
- Financieri është përgjegjës për mbajtjen e shënimeve të sakta mbi paratë që ka qeveria dhe mënyrën si shpenzohen ato.

Përgjegjësi të senatorëve:

- Pas çdo mbledhjeje të qeverisë së nxënësve, senatorët duhet të raportojnë mbrapsht në klasën e tyre.
- Mbledhja me klasën mund të organizohet çdo javë.
- Çështjet e ngritura në klasë nga nxënës të tjerë duhet të përçohen në mbledhjen e qeverisë së nxënësve nëpërmjet senatorit të klasës, të cilët duhet të përfaqësojnë mendimin e gjithë klasës.
- Nëse senatori përfaqësues mungon pa arsye në mbledhjet e qeverisë së nxënësve tre here radhazi, atëherë klasa ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues tjetër.

SHTOJCA 2

Formate për t'u përdorur gjatë procesit të zgjedhjeve

Formati i propozimit

Klasa _____

Ne dëshirojmë të propozojmë _____ si përfaqësues të klasës sonë në Qeverinë e Nxënësve.

Nënshkruar nga:

Propozuesi _____

Mbështetësi _____

Unë jam dakort të kandidoj për të përfaqësuar klasën time si anëtar në qeverinë e nxënësve.

Nënshkruar nga kandidati: _____

Fleta e Votimit

Klasa _____

Vendosni shenjën X në kutinë pranë emrit të kandidatit që ju do të dëshironit të përfaqësonte klasën tuaj në Qeverinë e Nxënësve:

Emri _____

☐

Emri _____

☐

Emri _____

☐

Emri _____

☐

Emri _____

☐

Fleta e numërimit të votave

Klasa _____

Emri i kandidatit

Votat

Personi përgjegjës _____

Dëshmitari _____

Mësuesi _____

Data _____

Fletë përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve

Klasa

Emri i kandidatit

Votat

Personi përgjegjës _____

Dëshmitari _____

Mësuesi _____

Data _____

SHTOJCA 3

Lojra bashkëpunuese¹

Në lojrat bashkëpunuese dhe jo konkurruese, nuk ka fitues dhe humbës, kështu që askush nuk ndihet i përjashtuar. Ato të argëtojnë dhe krijojnë një ndjenjë bashkimi duke lehtësuar kështu zhvillimin e mjaft veprimtarive në grup. Ato ndihmojnë fëmijët (dhe të rriturit) të përftojnë mjeshtëri apo aftësi shoqërizuese, besim, përqëndrim, komunikim dhe bashkëveprim sikurse lëndët akademike që bëhen në shkollë. Pra, ato ndihmojnë në zhvillimin e personit në tërësi dhe jo vetëm të intelektit të tij. Ato gjithashtu mund të jenë çlodhëse pas orëve të mësimi në klasë.

Jo të gjithë fëmijët duan të marrin pjesë në çdo lojë dhe ata nuk duhet të detyrohen për të kundërtën. Nëse rrinë jashtë një loje, ata shpeshherë duan të marrin pjesë në lojën tjetër të rradhës. Mësuesi/ treneri/ ndihmësi gjithmonë duhet të marrë pjesë që të arrihet maksimumi i efektit, dhe jo thjesht të shpjegojë lojën. Këto lojra duhet të ndihmojnë që të krijojnë një atmosferë miqësore e të këndshme në klasë.

Parada e kafshëve

Loja fillon me vendosjen e gjithsecilit në një rreth me karrige dhe një person qëndron jashtë rrethit - ky është udhëheqësi apo drejtuesi i paradës, i cili fillon të bëjë zhurmën dhe lëvizjet e një kafshe, dhe fillon të ecë përqark rrethit nga jashtë. Kur drejtuesi prek shpinën e njerëzve që rrinë të ulur në karrige rastësisht ata ngrihen dhe bashkohen me paradën duke bërë të njëjtën

zhurmë dhe të njëjtat veprime.

Kur drejtuesi vendos, gjithkush gjen një vend për t'u ulur dhe ulet, por ata mund të lëvizin edhe brenda rrethit derisa të gjejnë një vend të lirë. I fundit që kërkon për karrige fillon raundin apo rradhën tjetër si një drejtues parade duke zgjedhur një kafshë të re.

Fluckat

Kushdo gjen një partner dhe kapet për dore. Përdorni të gjithë hapësirën që keni. Imagjinoni që ju jeni fluska që fluturojnë në qiell, dhe ecni shumë ngadalë dhe lehtë nëpër dhomë. Kur ju përplaseni apo prekni një dyshe tjetër apo çift tjetër, fluska juaj kërcen dhe ju ndërroni apo shkëmbeni partnerët.

*** Nëse e përdorni si lojë prezantuese, inkurajoni njerëzit që të bisedojnë ndërsa ecin përreth.**

Biz

Lojtarët ulen apo rrinë një një rreth dhe numërojnë, përveçse fjala “biz” zëvendësohet me numrin shtatë, çdo numër që përmban shtatë apo ndonjë shumëfish të shtatës. Kështu, shtata është “biz”, katërmbëdhjeta është “biz”, shtatëmbëdhjeta është “biz”, njëzet e njëshi është “biz” dhe shtatëdhjeta është “biz”. Lojtarët numërojnë me shpejtësi sa të jetë e mundur, dhe sa herë që bëhet ndonjë gabim, fillojnë nga e para.

¹Disa prej këtyre lojrave janë marrë prej “Co-operative Games: Activities for a Peaceful World” nga Clive Baulch, Judith Holland, Maggie Freake, Mildred Masheder, “Peace Pledge Union” & etc”.

Makina dhe shoferi

Kërkoji pjesëmarrësve të lëvizin karriget dhe të qëndrojnë kundrejt murit. Ndajini në çifte. I shpjegoni se njëri pjesëmarrës në çift do të jetë makina dhe tjetri do të bëjë shoferin. Makina nuk e di se nga do të shkojë kështu që ato vendosin një rën dorë tek sytë dhe e shtrijnë dorën tjetër para tyre që të shërbejë si bori. Shoferat duhet të rrinë pas makinave dhe t'i vendosin duart e tyre në supet e makinave. Shoferat duhet t'i drejtojnë makinat rreth dhomës dhe të evitojnë përplasjet. Pas disa minutash, kërkojini makinave dhe shoferëve që të ndërrojnë vendet.

(Nëpërmjet kësaj loje fitohet përvojë për besimin dhe drejtimin. Në fund të lojës kërkojini shoferave të shprehin si u ndjenë në rolin e drejtuesit dhe a kishin ndonjë përgjegjësi për makinat? Më pas pyetini makinat se si u ndjenë dhe a kishin besim te drejtuesit e tyre për t'i ruajtur ato?)

Kulla e kontrollit

Gjithkush zgjedh një partner dhe çdo çift vendos se cili do të luajë aeroplanin dhe cili do të bëjë kullën e kontrollit. Krijoni një kalim prej dy rreshtash me karrige dhe vendosni pengesa në këtë itinerar. Aeroplani ka avari në shikim dhe kulla e kontrollit në mënyrë verbale e orienton gjatë kalimit rreth të gjitha pengesave në rrugën e tij për një ulje të suksesshme. Në fund rolet shkëmbehen.

*** Udhëzimet, të dëgjuarit dhe suksesi krijojnë besimin.**

Dragonjtë

Ndahuni në skuadra prej 6-8 vetash dhe gjeni hapësirë për secilin grup. Secila skuadër rreshtohet dhe çdo person kap për beli personin përpara duke krijuar kështu kokën dhe bishtin e dragoit. Këta janë dragonjtë - të rinj dhe me dëshirë për të luajtur - sikurse kukullat, ata gjithmonë kër-

kojnë bishtin e tyre. *Koka* e dragoit duhet të arrijë *bishtin*, por kushdo në 6mes duhet të mënjanojë që të ndodhë kjo dhe të mbrojë *bishtin* duke kërcyer dhe duke u rrotulluar përreth. Kur *koka* arrin që të kapë *bishtin*, ata këmbëjnë vendet.

*** Një lojë energjike moralizuese. Argëtim i madh.**

Elefanti dhe pema e palmës

Fillon me secilin të vendosur në rreth. Një person qëndron në mes dhe tregon me gisht tjetrin në rreth, duke thënë *elefanti* apo *pema e palmës*. Për ta bërë elefantin, personi të cilit i drejtohet gishti bën një hap më përpara, duke kapur duart e tij / të saj në formë rrethore për të bërë një *trung*. Personi në të majtë bën veshin e majtë të elefantit duke i mbajtur dorën e majtë dhe duke prekur majën e kokës më dorën e tyre të majtë. Personi në të djathtë të *trupit të elefantit* kryen të njëjtën gjë me krahun e djathtë për të bërë veshin e djathtë. Për të bërë *pemën e palmës*, personi i treguar me gisht qëndron me krahët e ngritura lart (trungu). Të tjerët në çdo anë mbajnë krahët nga jashtë, duart dukë i rënë për të bërë *gjetet e palmës*.

*** Argëtim dhe përqëndrim.**

Tërmeti

Kërkojini pjesëmarrësve të ndahen në grupe prej tre personash, përveç drejtuesit. Kërkoji dy anëtarëve të çdo grupi të formojnë një “shtëpi” duke parë njëri tjetrin, duke ngritur krahët mbi kokat e tyre dhe duke bashkuar duart. Anëtari i tretë i secilit grup është “banor” dhe qëndron në mes brenda “shtëpisë”. Drejtuesi qëndron jashtë grupëve dhe thotë një prej komandave të mëposhtme:

A. “Banorë” Në këtë rast shtëpitë qëndrojnë në vend dhe banorët duhet të lëvizin për në një shtëpi të re. Drejtuesi përpiket të gjejë një shtëpi

të re dhe personi që është lënë jashtë bëhet drejtuesi i ri.

B. “Shtëpitë” Në këtë rast banorët qëndrojnë në vend dhe shtëpitë lëvizin për të gjetur banorë të rinj. Drejtuesi përpiqet të gjejë dikë që ta fusë në shtëpi të re.

C. “Tërmeti” Në këtë rast të gjitha shtëpitë shkatërrohen dhe gjithkush duhet të ndryshojë. Çifte të reja bëjnë shtëpitë dhe banorët shpejtojnë për t’i zënë ato.

** Argëtim dhe përqëndrim.*

Ballë për ballë

Kërkojini gjithsecilit të qëndrojë dhe të lëvizë karriget kundrejt murit. Ndajni në çifte. Drejtuesi është një person tek që nuk ka partner. Drejtuesi thërret pozicione të tilla si “Ballë për ballë” apo “Shpinë më shpinë” dhe çiftet apo dyshet binden për pozicionin. Pozicionet mund të ndryshojnë si “Këmbë më këmbë”, “Bërryl më bërryl”, “Shpatull më shpatull”, “Gjunjë më gjunjë”, “Kokë më kokë” etj. Drejtuesi gjithashtu thërret “Ndryshim” dhe kushdo duhet të ndryshojë partnerët dhe të ruajë pozicionin e mëparshëm. Në këtë pikë drejtuesi mund të gjejë një partner dhe një person tek mund të bëhet drejtuesi i ri.

** Kërkon ca përqëndrim dhe lëvizje.*

Oborri i fermës

Lojtarët qëndrojnë në një rreth të madh dhe zgjedhin një numër kafshësh. Për një grup prej 20 personash 6 do të jenë mjaftueshëm. Emrat e kafshëve shkruhen në copa letre dhe u ngjiten pjesëmarësve në mënyrë të tillë që ata të mos e dinë çfarë kafshe përfaqësojnë. Më pas lojtarët mbyllin sytë e tyre dhe ecin përreth duke u përpjekur për të gjetur një kafshë tjetër të të njëjtit lloj duke bërë vashdimisht zhurmën e

kafshës, psh, beeeee, beeee apo mjauuuu, mjauuuu etj. Kur dy kafshë të të njëjtës lloj gjejnë njëri tjetrin, ata duhet të bashkojnë duart dhe të vashdojnë kërkimin derisa të kenë gjetur të gjitha kafshët e grupit të tyre dhe t’i kenë mbledhur ato bashkë.

Sallata me fruta

Lojtarët ulen në një rreth me një person në qendër (ai që drejton). Drejtuesi u kërkon tre personave që të thonë emrat e tre frutave të preferuara dhe më pas shkon rreth rrethit duke i dhënë secilit person duke përfshirë vetveten, emrin e njëres prej frutave si shpërblim. (psh. Nëse frutat janë mollë, pjeshkë, portokall, vazhdoet me të njëjtin rend përsëri e përsëri derisa çdokujt i është dhënë emri i njëres prej frutave.). Kur drejtuesi thërret emrin e një fruti, të gjithë personat që janë ai frut duhet të ndërrojnë vendet dhe drejtuesi përpiqet të ulet në njërin prej vendeve të lira. Personi që mbetet në këmbë bëhet drejtuesi i ri. Nëse ai thotë “sallatë frutash”, kushdo e ndryshon vendin.

** Kjo lojë ka shumë humor, ndihmon në thyerjen e barrierave dhe inkurajon lojtarët të mendojnë dhe të veprojnë shpejt.*

Vajtja në Safari

Imagjinoni që po shkoni në Safari dhe ju duhet të merni gjithçka duke filluar që nga një arush i vogël e deri tek një duzinë elefantësh të purpurt. Njëri pas tjetrit lojtarët thonë se çfarë do të pëlqenin të merrnin me vete në Safari, por lojtari pasardhës duhet të përsërisë të gjitha artikujt e emërtuar prej anëtarëve të mëparshëm të grupit. Kështu, personi i fundit duhet të kujtojë çdo artikull të thënë prej tërë grupit.

** Ky ushtrim sigurisht është një mënyrë e mirë për të lehtësuar tensionin pas një ushtrimi të vështirë.*

Unë ulem këtu

Loja fillon me të gjithë pjesëmarrësit të ulur në formë rrethi më një karrige bosh. Personi në të djathtë të karriges bosh lëviz për nga karrigia dhe thotë “Unë ulem këtu!” Kjo çon në një tjetër karrige të lirë dhe personi pranë saj lëviz për nga ajo dhe thotë “Në këtë karrige” Kjo bën që një tjetër karrige të lihet bosh prej personit të dytë dhe i treti që rri ulur pranë saj lëviz për nga ajo dhe thotë “Më shokun/shoqen time....!” (dhe thotë emrin e personit nga ana tjetër e rrethit. Shoku/ shoqja nga ana tjetër ë rrethit lëviz drejt karriges bosh nga personi i tretë duke e lënë bosh karrigen nga ana e dhomës nga ku filloi aktiviteti. Inkurajoni grupin të lëvizë shpejt kështu që loja të zhvillohet nën një ritëm të mirë.

Është e dobishme edhe shkrimi në një tabelë:

UNË ULEM KËTU....

NË KËTË KARRIGE....

ME SHOKUN TIM _____

*** Argëtim dhe gjallëri nëse mbahet një ritëm i mirë.**

Ngrohtë dhe ftohtë

Shpjegoni që në këtë lojë një vullnetar do të lërë dhomën për një minutë ndërsa grupi zgjedh një vend në dhomë për vullnetarin që ta gjejë. Vullnetari do ta gjejë atë duke u orientuar nga përplasjet e pëllëmbëve mbi prehër të gjithsecilit. Nëse vullnetari i afrohet vendit apo “ngrohet” gjithsecili do të godasë më fort. Nëse vullnetari është larg nga vendi apo “s’ia ka haberin” goditjet do të bëhen më të qeta.

Kalimi apo pasimi i topit indian

Uluni në dyshe në një rreth të ngjeshur dhe i shtrini këmbët për nga qendra. Një top vendoset mbi prehrin e një lojtari. Topi duhet vënë në lëvizje përqark rrethit sa më shpejt që të jetë e

mundur pa përdorur duart.

Variacione: Ndryshoni numrin dhe përmasat e topave; ndryshoni drejtimin e topit. Nëse nuk funksionon herën e parë, përpikuni përsëri.

Ishujt – Bretkosat dhe krokodilat

Bretkosat po kalojnë një kohë të bukur në lumë, por është krokodili ai do t’i hajë ato. Kur ai fle ato luajnë të lumtura, por kur zgjohet (psh, muzika ndalon), ato janë të sigurt në mbrojtjen e zambakëve, përfaqësuar nga fletat e letrave. Vendosni disa fletë letrë mbi tokë, për të përfaqësuar mbulesat e zambakëve. Lojtarët *notojnë/* ecin përqark dhomës derisa muzika të ndalojë, kur ato mund të rrinë në *ishull*. Me sinjalin e dhënë, edhe një herë, gjithkush mund të rrijë në *ishull*. Loja vazhdon me një ishull që zhvendoset çdo herë, derisa vetëm një apo dy mbesin, në varësi të numrit të grupit. Askush nuk duhet të lihet jashtë kur është koha për të qëndruar në ishull. Mund të realizohet nëse bashkëpunon gjithsecili. Kjo me të vertetë mund të shndërrohet në një lojë bashkëvepruese duke ngulur këmbë që të shpëtojnë sa më shumë njerëz që të jetë e mundur.

*** Bashkërishtja/ bashkëveprimi. Zgjidhja e problemit.**

Mëngjez xhungle

Gjithkush rri i shtrirë në dyshe. Imagjinoni është natë në xhungël dhe të gjitha kafshët flenë. Me ditëne parë të agimit kafshët lëvizin, zgjohen dhe shtrihen, klithin dhe fillojnë të përshëndesin njëra tjetrën me zërat e tyre. Kafshët fillojnë të lëvizin, të prekin njëra tjetrën, të flasin me britma, më fishkëllima, me hungërima, me lehje etj me njëri tjetrin- e gjitha zhurma zgjon xhunglën.

*** Një lojë prezantuese dhe energjike.**

Le të ndërtojmë një makinë

Ndani në grupe prej 4-7 personash dhe kërko që secili grup të krijojë një makinë duke përdorur veten si pjesë të saj. Do të shikoni që secili person përfshihet plotësisht ose si pjesë makine, ose si operator ose si produkt. Drejtuesi/ mësuesi duhet t'i caktojë për detyrë secilit grup një makinë specifike. Një veprimtari mund të jetë krijimi i një fabrike duke përdorur të gjitha makinat tok.

*** Një lojë për të gjitha aftësitë, që zhvillon përfshirjen dhe vendimmarrjen.**

Pasqyrat

Qëndroni në një rreth. Shikoni drejtuesin. Drejtuesi lëviz ngadalë duke përdorur vetëm duart, më pas pjesët e tjera të trupit dhe të fytyrës. Të tjerët duhet të lëvizin me drejtuesin sikur të ishin pasqyrimi i tij apo i saj. Drejtuesi duhet të theksojë ngadalësinë dhe kompaktësinë e kësaj loje. Ilustroni dallimin midis të ndjekurit dhe të pasqyruarit. Në mënyrë të alternuar, mësuesi duhet të zgjedhë ta bëjë këtë si një ushtrim për dyshe, në çdo rast dyshet apo çiftet duhet të bëhen me rradhë pasqyra dhe reflektimi, d.m.th. drejtuesi dhe ndjekësi.

*** Kjo lojë zhvillon përqëndrimin, vëzhgimin, bashkërinë apo kompaktësinë në grup dhe qetësinë. Është shumë e mirë për nxehjen për dramë dhe përmirësimin e artit të mimikës.**

Malet dhe luginat

Kjo lojë është nga origjina një ushtrim i sqarimit të vlerave, i vë njerëzit në lëvizje dhe i hedh në mendime dhe mund të jetë e mirë kur njerëzit kanë qenë përfshirë në një punë të lodhshme. Gjithkush rri në këmbë. Drejtuesi i fton të lëvizin nga brenda dhomës që ata përfrojnë sipas përgjigjeve të tyre kundrejt pyetjeve të mëposhtme.

Pyetini ato:

- Do të preferonit të ishit Mal apo Luginë?

Ata do të kalojnë nga ana që do të duan të bëhen. Disa nuk zgjedhin, kështu qëndrojnë në dilemë apo në mes. Pyetni ato të secilit krahë apo anë, se pse e zgjedhën atë krahë apo anë. Një kalim i shpejtë është i domosdoshëm.

Më pas kaloni tek pyetjet:

- Jeni më tepër një ishull apo një valë?
- Pikturë apo dritare?
- Fshat apo qytet?
- Tel rrobash apo fill balone?
- Përrua që gurgullon apo liqen i qetë?

Më pas krijoni katër qoshe për katër stinët...

Emri im është ... dhe unë pëlqej ...

Lojtarët rrinë në një rreth dhe secili person mendon diçka që ata pëlqejnë që fillon me të njëjtën gërmë si emri i tyre, psh. "Emri im është Kozeta dhe më pëlqen kakaoja". Duke ecur sipas lëvizjes së akrepave të orës, secili person paraqet personin në të majtë (duke i treguar grupit se çfarë i tha që pëlqentë ai person) dhe më pas veten e vet se çfarë i pëlqen.

*** Lojë e mirë për të njohur njëri-tjetrin.**

Pasoje shtrëngimin

Uluni në një rreth. Bashkujini duart. Një person më ëmbëlsi shtrëngon dorën e një personi në të majtë ose në të djathtë. Ai person e pason shtrëngimin tek personi tjetër. Dhe kështu me rradhë përqark rrethit derisa shtrëngimi i dorës të kthehet tek personi i parë. Disa variacione- drejtuesi duhet ta pasojë shtrëngimin si tek personi në të majtë ashtu edhe tek ai në të djathtë. Vëreni konfuzionin qesharak!

*** E para ndër disa prej lojrave të qeta për tu qetësuar dhe mbajtur frymën normal.**

Kokoshkat ngjitëse

Kushdo gjen një hapësirë dhe ecën rreth dhomës me krahët e shtrirë. Kur ju cekni dikë tjetër, ju ngjisni me të duke u mbajtur për duarsh, tamam si kokoshka të ngjitura. Eventualisht e tërë klasa duhet të ngjisë bashka derisa të gjithë fëmijët të bëhen si një top gjigant kokoshkash të ngjitura.

*** Një lojë tjetër gazmore “Le të njohim njëri-tjetrin”. Fëmijët e vegjël e pëlqejnë këtë lojë.**

Dielli ndriçon mbi të gjithë miqtë e mi që ... (apo era i fryn gjithkujt që ...)

Pjesëmarrësit të gjithë ulen mbi karrige në një rreth, përveç njërit që qëndron në mes dhe jep urdhëra. Personi në mes zgjedh diçka që është e vërtetë për të dhe disa njerëz në grup (ai/ ajo mund të mos e njohë ...) dhe thotë që dielli ndriçon mbi të gjithë miqtë e mi me një cilësi të veçantë (psh. Këpucët kafe, dy vëllezërit që janë grindur atë ditë etj) “Dielli ndriçon mbi të gjithë miqtë e mi që kanë veshur këpucë kafe”. Menjëherë gjithsecili me atë cilësi të veçantë (psh.kepucët kafe) duhet të ngrihet dhe të lëvizë drejt karriges të liruar prej dikujt tjetër me po atë cilësi. Personi në mes përpiket të gjejë një karrige ndërsa të tjerët lëvizin përreth duke lënë dikë tjetër pa karrige. Ai person atëherë lëviz drejt qendrës dhe loja fillon përsëri.

Stuhia e shiut tropikal

Qëndroni në një rreth. Një person vepron si një dirigjent i stuhisë dhe fillon simfoninë e tij duke fërkuar duart e veta, që i imiton personi pranë tij, dhe kështu me radhe personi pranë tyre (zgjidhni se cilën rrugë do të kryeni përpara se të filloni), dhe më pas personi tjetër dhe kështu me radhë, derisa kushdo kryen të njëjtin veprim. Kjo do të thotë një shi i rëndë. Dirigjenti më pas përsërit të gjithë procesin me një veprim tjetër psh. Spërdredh gishtat, duart që godasin prehrin,

prplasje këmbësh- që bën zhurmën e një rënijeje të stuhisë. Sikurse me çdo stuhi të papritur dirigjenti e ul volumin e simfonisë së stuhisë duke shkuar në hapat e mësipërm anasjelltas derisa personi i fundit që fërkon duart është e qetë.

*** Një lojë përfundimtare. Fëmijët e vegjël shpesh janë të tmerruar nga efektet e kësaj loje dhe lihen me një ndjenjë të ëmbël magjie. Nëse ka qetësi, lejojeni një moment ta shijojnë atë.**

Çfarë ndodh nëse...?

Secili prej pjesëmarrësve merr një letër ku në cepin e majtë të saj është shkruar pyetja: “Çfarë ndodh nëse...? dhe u kërkohet ta plotësojnë atë. Psh: “Çfarë ndodh nëse kafshët ikin nga kopshti zoologjik?” Më pas secila letër dorëzohet tek një person në të djathtë i cili tashmë duhet t’i kthejë përgjigje pyetjes që ndodhet në letrën që merr nga shoku. P.sh “ Rojtarët mbesin pa punë.” Në fund letrat shpërndahen në persona të tjerë të cilët lexojnë atë çfarë është shkruar, duke krijuar kështu pyetje dhe përgjigje qesharake.

Kush jam unë?

Printoni emrat e disa personazheve të njohur si Borëbardha, Hirushja, Skënderbeu etj mbi skeda. Bëni skeda të mjaftueshme për të gjithë pjesëmarrësit. Kërkojini të gjithë pjesëmarrësve që të rrinë në këmbë. Më pas ngjitini skedat në shpinën e gjithësecilit pa i lejuar pjesëmarrësit të shikojnë emrin që kanë. Objektivi i ushtrimit është që secili person të gjejë emrin që mban mbi shpinë duke u drejtuar pyetje personave të tjerë për veten e tyre. Ju mund të drejtoni vetëm dy apo tre pyetje secilit person, më pas lëvizni drejt një personi tjetër. Të gjitha pyetjeve duhet t’u jipet përgjigje vetëm me “Po” apo “Jo”. Loja vazhdon deri sa gjithësecili të gjejë se kush është.

*** Argëtim po gjithashtu edhe lojë kërkuese pasi lidhet me njohuritë.**

Bibliografi:

1. “Primary school councils toolkit, Teachers and pupils working together”, Di Clay with Jessica Gold, Published by School Councils UK.
2. Dispozitat Normative për Arsimin Publik, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, 2002
3. Hart, R.A. “Children’s participation, the theory of involving young citizens in community development and environment care”. Taken from Alderson, P. “Young Children’s Rights, exploring believes, principles and practice”, 2001.
4. “E gjetëm zgjidhjen ... është Qeveria e Nxënësve”, Botim i Save the Children në Shqipëri, 2003.



Save the Children

Programi për Shqipërinë

Rruga “Komuna e Parisit”, Lagjia 8, Pallatet 1 Maji,
Vila “Lami”, Tirana - Albania

Tel: +355 4 261 840/929; Fax: +355 4 263 428

E-mail: savealbania@savealbania.org